



# *Stili i Jezusit*

---

**GAYLE D. ERWIN**

---

Me udhëzues studimi

*Stili i  
Jezusit*

GAYLE D. ERWIN

Citimet e përdorura në këtë libër janë marrë nga Botimi i Biblës në shqip prej Shtëpisë Botuese "Lajmi i Mirë", Tiranë 1994 (Shën. i përkthyesit)

Përktheu: Elizabeta Alimhilli

Redaktoi: Edlira Mulla

Shtypur: Vernon Publishing

Tiranë, Shqipëri

## Përmbajtja

Parathënie .....	i
Hyrje .....	v
NJË STIL I VETI .....	1
Jezusi-Po .....	1
Njohja me Jezusin .....	5
KRIJUESI I STILIT .....	19
Numri një .....	19
Një për të gjithë .....	21
Të gjithë për një .....	23
Një ndër të shumtët .....	29
STILI I JEZUSIT .....	33
Ai nuk është i paarritshëm .....	33
Në shërbimin tuaj .....	35
Piramida e pushtetit .....	41
Do doja të shihja një shërbesë .....	49
As më shumë, as më pak .....	55
Fëmija është... ..	63
I dorës së dytë .....	67
I fundit në radhë .....	69
Ka vend në grazhd .....	75
Lamtumirë taktika të forcës .....	81

Mirëdita, unë jam Reverend .....	87
Poshtë në tokë .....	95
Bëmë baba të të ngjaj .....	99
Bariu i mirë nuk e braktis kopenë .....	107
Një e papritur e këndshme .....	109
I plotfuqishmi .....	111
DUKE JETUAR NË STIL .....	115
E ëmbla dhe e hidhura .....	115
Kocka e kyçit të këmbës e lidhur me kockën e këmbës .....	117
Të burgosurit e historisë .....	119
Lidhja që na bashkon .....	125
Në shtëpi me trupin .....	127
Ndarja e dhimbjes .....	133
Fjalët ndjekin njëra tjetrën .....	135
Një stil për të gjithë kohët .....	137
UDHËZUES STUDIMI .....	141

# Parathënie

Shfaqja e parë e botës ndaj Krishtit që në qenien njerëzore - personin - njeriun e quajtur Jezus ... marangozin Çifut, që u bë rabbi (mësues) endacak. Mësimet e Tij ishin largpamëse duke e kapërcyer ortodoksinë fetare dhe pikëpamjen tradicionale mbi Mbretin Mesia dhe mbretërinë e Tij. Sot, ne nuk dëgjojmë se çfarë thotë Jezusi, mbasi jemi gjithmonë në rrezikun e imponimit të një kuptimi të pasaktë në mësimin e Tij largpamës prej asaj që ne mendojmë se tashmë dimë dhe besojmë në kontekstin tonë kulturor dhe teologjik. Traditat tona na dalin përpara.

Përmes këtij libri, Geil Erwin na ndihmon ta shohim, ta ndiejmë dhe ta dëgjojmë Jezusin, si për herë të parë, plotësisht të zhveshur nga paramendimet, prirjet apo paragjykimet. Ai na ndihmon të çlirohemi nga traditat tona dhe nga ai burg dogmatik, që kishte mbërthyer edhe besimtarët bashkëkohës të Jezusit:

Por ai duke u përgjigjur u tha atyre: “Mirë profetizoi Isaia për ju, hipokritë, siç është shkruar: “Ky popull me buzë më nderon, por zemra e tyre rri larg meje. Por kot më bëjnë një kult, duke mësuar doktrina, të cilat janë porosi nga njerëzit”. (Marku 7:6-8)

Disa dijetarë teologë vazhdojnë të këmbëngulin se problemi më delikat për kishën qëndron në faktin se çfarë besojmë ne për Jezus Krishtin. Në një vështrim shumë themelor, ky ka qenë gjithmonë problemi më kritik për kishën dhe si rrjedhojë, edhe për historinë. Në mënyrë të pandryshueshme dhe të pashmangshme sa herë që në qendër të vëmendjes vihet një problem tjetër, ai synon t'i përçajë ata njerëz, për të cilët Krishti është Zoti dhe Shpëtimtari i tyre. Një mënyrë për ta parë këtë është se kur çështjet e tjera lejohen t'i polarizojnë ata për të cilët Krishti është Zot, ajo çështje, çfarëdo që të jetë, është ngritur në një pozicion të një rëndësie më të lartë se sa vetë Krishti. Një dijetar i shquar, të cilin e admiroj dhe

e respektoj thellësisht shprehej kështu: “Çdo gjë që ti e ve në qendër të vëmendjes, e bën idhull.”

Fakti, që Krishti është çështja kritike mbetet i padiskutueshëm. Ai e bëri vetveten çështje kur i ballafaqoi dishepujt në Cezarea Filipi me pyetjen tepër të rëndësishme, përgjigjja e së cilës përbën themelin mbi të cilin Ai ndërton kishën e Tij. “Po ju kush thoni se jam unë?”. Dhe Simon Pjetri duke u përgjigjur i tha: “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë”. Dhe Jezusi duke iu përgjigjur u tha: “I lumtur je ti, o Simon, bir i Jonas, sepse këtë nuk ta zbuloi as mishi as gjaku, por Ati im që është në qiej. (Mateu 16:15-17)

Vetë apostulli Gjon, kur u shkroi letrën e parë gjithë atyre që “besojnë në emër të Birit të Perëndisë” e pati plotësisht të qartë problemin themelor, kur përcaktoi kriterin për të vërtetën: “Nga kjo mund të njihni Frymën e Perëndisë: çdo frymë që rrëfen se Jezus Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia. Dhe çdo frymë që nuk rrëfen se Jezus Krishti ka ardhur mish, nuk është nga Perëndia.” (1 Gjon 4:2-3)

Herezia e parë në kishë nuk mohoi hyjninë e Jezusit, por natyrën e Tij njerëzore. Gnosticizmi, që beson se materia është e keqe, kundërshtoi idenë se Krishti kishte një trup fizik dhe pohoi se Ai vetëm "dukej" si njeri. Në tridhjetëvjeçarin e parë të shekullit tonë kishën e sundoi polemika mbi hyjninë e Krishtit. Të shqetësuar me të drejtë për natyrën hyjnore të Krishtit, evangjelistët dukej sikur e braktisën disi kuptimin mbi natyrën njerëzore të Krishtit. Duke vepruar kështu, për qëllimet e tyre praktike, ata braktisën modelin njerëzor që Perëndia solli në histori për të na e shfaqur neve jo vetëm se si është Perëndia, por njerëzoren siç e synoi Perëndia.

Vetë thelbi i strategjisë hyjnore, zbulesa e plotë e Perëndisë në mish njerëzor, u sakrifikua në një dogmë që në fakt na shkëputi nga aspekti thelbësor i identifikimit të vetë Perëndisë me njeriun. Shkrimtari është plotësisht i bindur se ky fakt është tepër i rëndësishëm sot, në afrimet unguillizuese ndaj botës që nuk beson. Shpesh, në vend që të paraqesim figurën mahnitëse dhe të papërballueshme të njeriut Jezus, ne u bëjmë të njohur njerëzve

një doktrinë. Ne mundohemi më tepër t'i bindim njerëzit të besojnë këtë, apo atë gjë mbi Krishtin, sesa ta njohin Atë, ta pranojnë në jetën e tyre, t'i besojnë Atij dhe ta duan Atë. Ungjilli ynë sot, në vend që të përqëndrohet tek personi frymëzues i Krishtit, i cili përbën tërësinë e besimit apostolik, është kthyer në një dogmë fetare. Apostujt, nuk ditën shumë gjëra për Jezusin, por ata e njohën Atë. Ndërsa ne sot, përipiqemi të mësojmë sa më shumë për Jezusin, por harrojmë të vendosim lidhje të ngushtë me Të.

Problemi më kryesor atëherë është: Jezusi - kush qe Ai, çfarë tha dhe bëri gjatë shtegtimimit të Tij në tokë? Geil Erwin na vë përballë njeriun Jezus, personin e vërtetë që përshkoi me këmbë rrugët me pluhur të Galileës, që jetoi një jetë reale, me situata reale e me njerëz realë dhe që shpalli të vërtetën më të thellë me fjalët më të thjeshta.

Duke patur një përvojë të gjatë pastorale dhe duke nxjerë mësim nga dobësitë dhe dështimet e hershme, shkrimtari i fton lexuesit ta konsiderojnë me ndershmëri ose mbase është më mirë të thuhet t'i rikonsiderojnë mësimet e thjeshta të Jezusit, me të cilat tashmë janë të mirënjohur. Në këtë libër Jezusi i Dhiatës së Re na është paraqitur në mënyrë të tillë që depërton nëpër pikëpamjet tona tradicionale dhe kërkon që ne të braktisim ndryshimet që i kemi shpikur vetë të cilat na lejojnë ne ta shpallim veten dishepuj të Jezusit, ndërkohë që nuk i bindemi Atij plotësisht e me gjithë zemër. Duke lexuar këtë libër, për të cilin u jam thellësisht mirënjohës, unë personalisht e ndesha Jezusin në një mënyrë të re.

Gjatë leximit të këtij libri m'u kujtua thënia me të cilën hapet letra e parë e Gjonit” “Atë që ishte nga fillimi, atë që dëgjuam, atë që pamë me sytë tanë, atë që vështruam dhe që duart tona e prekën lidhur me Fjalën e jetës (dhe jeta u shfaq dhe ne e pamë e dëshmojmë për të, dhe ju shpallim jetën e përjetshme që ishte pranë Atit dhe që na u shfaq neve), atë që pamë dhe dëgjuam, ne po jua shpallim...” (1 Gjon 1:1,3)

RIÇARD C. HALVERSON

Kapelan pranë Senatit të Shteteve të Bashkuara



# Hyrje

Ky libër lindi si pasojë e një krize të kuptuari dhe qëllimi që përjetova në fillim të aktivitetit tim pastoral. Në atë kohë nuk e kuptoja dot se sa largpamëse do të ishin pasojat e asaj krize. Erdhi një moment në jetën time, kur thjesht ndershmeria më detyroi të kombinoja veprimtarinë time pastorale me atë që unë kuptoja se mësonte Bibla duke mos lejuar më, që traditat dhe kufizimet kulturore të udhëhiqnin veprimet e mia. Kjo më zbuloi gjithashtu se ura që lidhte të vërtetën dhe idealen ishte prishur - për ta kaluar, jo vetëm që ve kokën në rrezik, por nuk guxon të mbartësh bagazh tepër prej zakoneve të tua të shkuara.

Kalimi i urës bëhet burim zhgënjimi dhe befas gjendesh në zgrip të honit të thellë të cinizmit. Gjithnjë kam dashur t'i drejtoj Perëndisë një pyetje të veçantë me shpresë se do të marr përgjigjen e plotë: “Përse ke lejuar që kisha jote të marrë këtë formë të kobshme, të përçahet nga fraksione, luftëra dhe herezi?” Unë vetë, edhe pse s’e kam gjetur dot përgjigjen, kam arritur ta kuptoj parimin dhe qëllimin që më ka shpëtuar dhe që, sipas mendimit tim, ka forcë ta çlirojë kishën nga kjo gjendje dhe ta bëjë ashtu siç e projektoi Jezusi.

# Një Stil i Vetë

## Jezusi - Po

Qe vetëm një nga afishet e shumta që pamë të përdorura nga protestuesit e viteve gjashtëdhjetë, që më pati tërhequr më tepër vëmendjen. Në të thuhej vetëm: “Jezusi - Po! Krishtërimi - Jo!”

Mendova me vete: “Përse vallë gjatë gjithë këtyre viteve vërtetësia e Jezusit mbeti natyrshëm tërheqëse, ndërkohë që interpretimet tona për Të kanë rezultuar më pak tërheqëse?” Diku kemi harruar të kuptuarit e atij që e portretizon më saktë. Po cili të jetë ky vallë? A mund të ketë mbetur ndonjë gjë për Të pa u bërë objekt kërkimi dhe shtjellimi? Cila vallë të jetë rrugëzgjdhja? Le ta kërkojmë së bashku!

Personi i Jezus Krishtit ka qenë në qendër të vëmendjes në të gjitha kohërat, gjatë gjithë historisë dhe në të gjitha studimet e bëra (për këtë jam plotësisht i bindur). Megjithatë, ky libër nuk përqëndrohet në paraqitjen e Jezusit si i gjithëdijshëm, i gjithëpushtetshëm dhe i kudopranishëm, as me paracaktimin e fatit, apo paranjohjen prej Perëndisë. Të tilla cilësi, që shpesh i gjejmë të përmendura në teologjitë sistematike dhe në trajtimet që ata i bëjnë natyrës së Jezusit, më duket se e vendosin Jezusin përtej arritjes sime ndonjëherë, - mendoj, pa rrezik. A mund të gjendet

përshkrim më i plotë i pamjes së tij madhështore, se sa ai që është dhënë tek kapitulli i parë i Zbulesës?

Në vend të këtyre përshkrimeve përmbushëse magjepsëse me mundësi të pafundme të kompleksiteteve teologjike, më pëlqen t'ju flas për mishërimin e tij. Më vjen ta marr forcën e Tij gjëmuese e ta ngjesh brenda trupit të Tij njerëzor, që dora jote të mund ta prekë dhe po qe se mendja do të mund t'i rezistojë (pasi e di që shpirti mundet), t'jua bëj të njohur se prekja dhe ngrohtësia që ndieni është vetë Perëndia.

Kur e qara e parë e foshnjës u dëgjua në atë grazhd të Betlehemit dhe nën kujdesin e Marisë dhe të Jozefit erdhi në jetë një fëmijë i brishtë, i rrudhosur dhe i mbuluar me gjak, universi bëri kthesën e tij më të madhe. Për herë të parë, Perëndia dhe Krijuesi, për të cilin vetëm kishim dëgjuar më parë, tani mund të shihej dhe të prekej. I gjithi siç ishte, tani zinte një mish njerëzor ... i arritshëm, i mundshëm për t'u kontaktuar, i dobët. Fatkeqësisht, njerëzimi ende parapëlqen Perëndinë e paparë dhe të largët. Ne kemi vështirësi me Perëndinë që është mish i gjallë. Neve na pëlqen më tepër të kapemi pas parimeve, dogmave dhe ideve njerëzore, sesa ta dëgjojmë atë që na thërret drejt vetes si një njeri.

Por Perëndia i shikon gjërat ndryshe. Jezusi, pikëndarja e kohëve ishte i prekshëm dhe vendosi lidhjet mes nesh dhe Perëndisë. Është me vend të theksohen të dhënat që dëshmojnë për Jezusin, që u end kudo duke prekur njerëzit, madje edhe ata që deri atëherë kishin qenë të paprekshëm. Si për çudi, të dhënat dëshmojnë se ata që u prekën prej tij nuk e kuptuan se kush ishte ai. Çuditërisht, vetë ndjekësit e tij më të afërt, shpesh s'ishin të sigurt.

### ***Mbretëria Kokëposhtë***

Gjon Pagëzori, kushëriri i Jezusit, vetë shfaqti një pasiguri të tillë. Që në fillim të shërbesës së tij u shpreh me këto fjalë për Jezusin: "Ky është Ai!" Më vonë, i shtyrë nga dyshimet e tij, ai si për t'u siguruar pyeti: "A je ti Mesia?"

Çfarë ndodhi ndërkohë? Pse dyshonte ai se kush ishte Jezusi në

të vërtetë? Gjoni, vetë shpjegon se ku bazohej pasiguria e tij. Në deklaratën e tij të parë, ai thekson se s'do të kishte qenë në gjendje ta njihje Jezusin, po të mos kishte qenë Fryma që kishte zbritur dhe kishte mbetur në të. Kjo na tregon se s'kishte asgjë Mesianike në pamjen e Jezusit (diçka shumë e vështirë për t'u besuar, tani që kemi parë portretizimet artistike që i bëhen Jezusit), dhe se veprimet e tij nuk përkojnë me mendësitë dhe parashikimet tona tradicionale mbi Mesinë.

S'është për t'u habitur që Gjoni, i cili predikonte mesazhin e përgatitjes për ardhjen e Birit të Perëndisë së bashku me dishepujt, të cilët e pyesnin parreshtur Jezusin se kur kishte ndërmend ta përmbyste Romën dhe të ngrinte mbretërinë, udhëhiqeshin nga mendësia tradicionale e kohës, përse i përket Mesisë. Në një farë mënyre, pavarësisht nga pritjet e tyre, Jezusi nuk u pajtua me kuptimin popullor, të tyre ose tonin për Mesinë. Pyetja shtrohet: "Në ç'raport qëndrojnë arsyetimet tona me të vërtetën?"

Dishepujt ndesheshin në mënyrë të vazhdueshme me ato që Jezusi përpiqej t'u mësonte për mbretërinë e Perëndisë. Ata mashtronin për të zënë poste apo për privilegje dhe debatonin se kush ishte më i madhi mes tyre. Nuk më vjen turp të them, se unë vetë e çmoj të parit e natyrës së tyre njerëzore, dhe pa dyshim më duket vetja shumë i ndërlikuar për të qëndruar në një përngjasim të tillë trashanik. Në vend të kësaj, kur marr pjesë në mbledhjet e komitetit, filloj të thurr plane se si t'i detyroj të tjerët t'i nënshtrohen vullnetit dhe dëshirës sime, duke i bindur se kjo është dëshira e tyre dhe, në fund të fundit, të fitoj më pas edhe besimin e tyre. Ka raste kur bashkohem me të tjerët në manovra të holla prapaskenash politike në takime të mëdha të kishave, dhe qëndroj rehat i verbër ndaj motivimit tim.

Jezusi u përgjigjej qartë dhe me vendosmëri diskutimeve ambicioze të dishepujve (dhe pa dyshim edhe motiveve të mia):

"Ju e dini që ata që konsiderohen sundues të kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë mbi to pushtetin e tyre; por kjo s'duhet të ndodhë midis jush; madje ai nga ju që do të dojë të bëhet i madh, do të jetë shërbëtori juaj; dhe kushdo nga ju që do të dojë të jetë i pari, do të jetë skllavi i të gjithëve. Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi t'i shërbejë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetave". (Marku 10:42-45)

Ky njeri tha se erdhi më tepër për të shërbyer, sesa që t'i shërbejnë. Siç ka thënë një shkrimtar, ai sundon “një mbretëri kokëposhtë”. Duke e studiuar atë mund të ndeshim aq të papritura, sa edhe vetë dishepujt. Kur Gjon Pagëzori e pyeti: “A je ti Ai?” Jezui iu përgjigj duke i listuar shërbimet dhe shërimet që kishte bërë; veprime këto, disi më pak të bujshme se parashikimet tradicionale mbi Mesinë. Gjoni gjendej akoma në burg i paçliruar. Roma ishte akoma në fuqi. Po, ku qenka pra mbreti Jezus? Diçka s'shkon mirë ose ka qenë krejt një keqkuptim. Jezusi, duke qenë i ndërgjegjshëm për tensionin që ekziston mes realitetit të tij dhe botëkuptimit tonë u përgjigj si më poshtë: “I lumi ai që nuk do të skandalizohet prej meje” (Luka 7:23).

Ky, pra është Jezusi, për të cilin dua t'ju flas, Jezusi që e quajti veten shërbëtor. Nuk e di pse, por gjatë punës sime kërkimore nuk kam arritur t'i zbuloj cilësitë e të shërbyerit që duken kaq qartë dhe janë themelore për atë që kush është Jezusi, edhe pse të trajtuara cektësisht e shkurtimisht. Vetëm di të them se zbatimi dhe ndikimi i tyre tek njerëzit ka forcë të papërshkrueshme, unë vetëm mund t'ju ftoj ju tek kjo.

Më gjerësisht, për këto cilësi do të flasim në kapitullin e ardhshëm.

# Njohja me Jezusin

Le të shtrojmë një pyetje pak me spec! Sikur të ishit në vendin e Perëndisë dhe t'ju duhej ta zbulonit veten tuaj në një planet, cili do ishte veprimi i parë që do të ndërmermit, duke pasur parasysh ndryshimin e madh që ekziston mes jush dhe njerëzve të atij planeti?

S'ka rrugë më ironike dhe më të papërshtatshme se ajo që zgjodhi Perëndia për të paraqitur vetveten. Le të njihemi me disa nga ngjarjet paradoksale që ndodhën kur Jezusi hyri në botën tonë!

## *Lindur në një Stallë*

Ç'vend i papërshtatshëm për të lindur një mbret! Pas një udhëtimi tepër të vështirë për një grua shtatëzënë në muajin e nëntë, stalla do të ishte vendi i fundit, që një bashkëshort i kujdesshëm do zgjidhte për gruan e tij që do të lindte. Skenat e Lindjes që zbukurojnë mjediset tona gjatë festës së Krishtlindjes nuk janë aq të sakta. Asnjëra prej tyre nuk është plotësisht realiste. Ne nuk arrijmë t'i kuptojmë plotësisht kushtet jo higjenike të grazhdit, ku për shkak të ndotjeve të kafshëve s'kishe ku të vije këmbën, e jo më të përfytyroje vendosjen e një fëmije të porsalindur në një govatë ushqimi të ndotur nga jargët e kafshëve.

Madje, ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht shqetësimin e Jozefit, tek sheh gruan e tij të heqë dhimbjet e lindjes dhe ta lindë fëmijën në një mjedis të tillë. Biri i Perëndisë meritonte diçka më të mirë.

Të katër fëmijët e mi lindën në kushte sanitare aq të rrepta, sa dhe mua babain, më penguan të hyja në sallë. Ishte pak e rëndë për mua si baba që infermieret e largonin menjëherë foshnjën nga dhoma e nënës, për shkak se po hyja unë.

Sikur Perëndia të më kishte pyetur mua, që kam edhe njëfarë përvoja në problemet shoqërore, do t'i kisha propozuar, që me një të ngritur të gishtit të urdhëronte të ndërtohej një spital modern shumëkatësh, jashtë mase madhështor dhe vezullues, me një diamant gjigand në majë për të thithur dhe reflektuar rrezet e diellit në të gjithë vendin. Natyrisht, Biri i Perëndisë do të ishte i vetmi që ta përdorte. Dhe pastaj gjithë bota do kishte ardhur ta vizitonte dhe njerëzit do mbeteshin gojëhapur me vendlindjen e Birit të Perëndisë.

Por, ja që Perëndia nuk kërkoi mendimin tim dhe zgjodhi grazhdin si vendin ku do të lindte Biri i tij. Askush nuk do të mahnitej nga kjo lindje dhe sigurisht askush nuk do të kërcënohej prej saj. Shumë madje do të mburreshin për rrethanat e mira, në të cilat kishin lindur. Ndoshta do të na entuziazmojë qyteti ku ai lindi. Apo jo?

*Po ç'vendlindje zgjodhi Perëndia?* Një qytet me emër do bënte që njerëzit ta kujtonin atë dhe pa dyshim do ta përmirësonte imazhin e tij. Po Betlehemi? Nuk kishte as hotele e motele të mjaftueshme, as qendra fetare që ta bënin atë të përshtatshëm e tërheqës për ta vizituar dhe për të nderuar kujtimin e Mbretit. Përkundrazi, Betlehemi s'ishte aspak mjaft i madh që të garantonte lindjen e Birit të Perëndisë. Por ai lindi. Askush nuk mund të kërcënohej nga vendlindja e tij. Por familja mbretërore është familje mbretërore dhe sofistikimi i prejardhjes së vet do të dalë në dritë. Apo jo?

*Po ç'thuhet për prejardhjen e tij?* Ne, sot besojmë në lindjen përmes Frymës. Mbi këtë argument është diskutuar shumë dhe shumica e të krishterëve e ka pranuar. Ndryshe që kur lindi Jezui. Njerëzit e asaj kohe nuk e njihnin lindjen përmes Frymës së Shenjtë. Jezui u rrit mes pëshpëritjeve dhe akuzave si “një bastard” me njollën e turpit si fëmijë i paligjshëm.

Përfytyroni, sikur pa pritur e pa kujtuar, njëra nga vajzat e zgjedhura të grupit rinor të një kishe me emër të dilte se ishte shtatzënë? Pa dyshim, të gjithë do çuditeshin, pasi vetë jeta e saj s'kishte lënë vend për të dyshuar për një veprim të tillë. Më së fundi, duke u mëdyshur, i zënë ngushtë, kryetari i grupit do merrte iniciativën i pari ta pyeste se kush ishte i ati i fëmijës. Për çudinë më të madhe, ajo do përgjigjej: “Fryma e Shenjtë.” Dhe e gjithë kisha do shkulej gazit e do talleshin keq me të.

Sipas jush shokët dhe fqinjët a e pyetën Jezusin se përse nuk i ngjante Jozefit? A mendoni ju se shokët e tij të fëmijërisë nuk e tallën, ndërsa ai mundohej t'i bindte se Fryma e Shenjtë qe ati i tij? A mendoni se Farisenjtë ngurruan t'ia përmendnin këtë fakt?

Në kohët biblike, fëmijët e paligjshëm deri në brezin e dhjetë përjashtoheshin nga pjesëmarrja në ritet e Tempullit të Zotit. Ata privoheshin nga kujdesi prindëror, nga privilegjet e zakonshme dhe të drejtat që gëzonin fëmijët e ligjshëm. Edhe pse Jezusi, në të vërtetë nuk ishte fëmijë i paligjshëm, njerëzit e konsideronin si të tillë. Asnjëri që do të kërkonte të njihej si vetë Perëndia, nuk do të dëshironte të kishte një njollë të tillë në jetën e tij. Kundërshtarët do t'i kishin grushtat me baltë për t'ia përplasur në fytyrë. Shpifjet dhe thashethemet e shumta do t'ia nxinin jetën. Por, do të vinte një ditë kur ajo mori njerëzish, që kishin duruar talljet, përqeshjet e fyerjet e botës, do gjenin tek ai njeriun, lindja e të cilit nuk do t'i frikësonte, njeriun që mund t'i shpëtonte. Sa tejet i dobët u tregua ai ndaj kësaj bote kaq thumbuese. I lindur nga një virgjëreshë! E sikur kjo të mos mjaftonte, nga të parët s'kishte trashëguar ndonjë gjë për t'u krenuar.

### ***Gërmim në të kaluarën e familjes***

Gjenealogjitë s'më kanë tërhequr kurrë dhe nga ç'kam dëgjuar, shumë njerëz mërztiten kur e lexojnë Biblën, ngaqë u duhet të kalojnë përmes emrave të shumtë të pemës gjenealogjike Por ka më tepër të dhëna për familjen e Jezusit sesa një listë me emra. Ashtu siç mund të rezultojnë në prejardhjen e familjes së secilit prej nesh një



a dy persona që do të na bënin të ndiheshim të turpëruar, ashtu edhe Jezusi, po të mos ishte “Zoti me ne”, do të ndihej i zënë ngushtë prej sjelljes së disa parardhësve të tij.

Pastërtia e dëshiruar e racës Çifute u njetos nga Ruthi i Moabitëve dhe Rahabi i Kanaanitëve. Sikur të mos mjaftonte ky turp! Rahabi që një prostitutë. Jakobi, siç e tregon dhe emri i tij, dallohej si mashtrues dhe gënjeshtar. Juda që feminist. Davidi, në fronin e të cilit Jezusi u ul dhe emrin e të cilit mori, bëri tradhti bashkëshortore dhe kreu vrasje, duart e tij të lara me gjak u bënë pengesë që të ndërtonte tempullin. Nga bashkimi i tij me Bath-shebën, për hir të së cilës ai vrau Uriahun, lindi Salomoni, i cili, pavarësisht se që shumë i zgjuar, pati qindra gra dhe konkubina dhe e largoi zemrën nga Perëndia.

Ndërsa ne mund të mburremi me tiparet e trashëguara mbretërore, apo me prejardhjen tonë të shquar, ky Jezus mahnitës e sakrifikon edhe një të drejtë të tillë, me qëllim që të mos ia kemi zili prejardhjen dhe që të mos i lërë shkas skeptikëve të thonë se ai që fryti përfundimtar i një super race.

Jezusi e arriti mesianizmin e tij duke mos gëzuar as privilegjin e një emri të veçantë. Ju mund ta kundërshtoni faktin që emri Jezus nuk është një emër i zakonit dhe pa forcë. Por para se të arrijmë në këto përfundime duhet të kuptojmë prejardhjen e këtij emri.

Si fillim, duhet të theksojmë se, në të vërtetë emri i tij nuk që Jezus, por Jozue, një emër i mirë ky, që do të thotë “Jehovai është shpëtimi”, por një emër shumë i zakonit dhe aspak i përshtatshëm për një mbret.

Emri Jozue vjen nga greqishtja dhe përkthehet Jezus. Pa dyshim që ne e kemi përdorur në këtë mënyrë. Për ta kuptuar më lehtë këtë, le të marrim si shembull emrin Xheims, që në spanjisht mund të përkthehet Jago, por edhe Haime.

Për shkak se emri krejt i zakonshëm Jozue, që nuk dallonte nga emrat e tjerë, dëshmon për një tipar tjetër të natyrës së tij, pasi ai do të thirrej edhe Emanuel - që do të thotë “Zoti me ne.” Ai zgjodhi të identifikohet me njerëzit dhe jo të distancohej prej tyre.

Ç’emër do të propozonim për një mbret, në rast se do të na pyesnin? A s’do na pëlqente të zgjidhnim një emër të veçantë, që

tingëllon bukur, tërheqës dhe spikatës në reklama, apo një emër të njohur skenash Hollivudiane? Por emri Jozue? Vetëm në atë lagje mund të gjendeshin tre veta me të njëjtin emër. A ia vlen të lajmërohet një lindje e tillë me një fillim kaq të pakëndshëm? Nga vetë mënyra se si u organizua ajo, të linte përshtypjen se do të ishte një lajmërim mjaft i rëndomtë.

Ju, përsëri do përpiqeni të kundërshtoni. Ndonjëri prej jush mund të thotë “Pa prisni një herë. Mos kisha unë engjëj përreth të më këndonin, kur linda? Si mund ta quani atëherë lajmërim të rëndomtë?” Kini durim dhe do të mësoni më tej për të.

### *Ardhja e Tij në jetë*

Sikur Perëndia të më kishte pyetur mua më parë, do t’i sugjeroja që të përdorte gjithë aftësinë e Tij për të shpallur këtë lajm. Ndoshta do të ishte më mirë të ngjitej në Hënë, me një mikrofon të shtrenjtë, të lidhur me altoparlantë dy bilion watësh, me anë të të cilëve do t’i transmentonte botës këto fjalë: “Tungjatjeta-a-a-a, Bo-o-o-të. Ju flet Perëndia-a-a!”

Përderisa Perëndia kishte vendosur të zgjidhte një kor, do t’i sugjeroja të ndiqte vargun e urdhëresave dhe së pari të shkonte te Sinedri, ose t’i përdorte energjitë e tij efektivisht, duke e shpallur lajmin e gëzueshëm në një pazar të madh, ku turma të mëdha njerëzish mblidhen sa të hapësh e mbyllësh sytë.

Por çuditërisht, Ai këmbënguli të zgjidhte një vend të shkretë. Si do të kishit vepruar ju, po të ishit pjesëtar i atij kori engjëllor, që qe ngarkuar të lajmëronte lindjen? Pa dyshim që për dyqind vjet me radhë do të ushtroheshit për t’i paraprirë atij prezantimi të lavdishëm. Çdo përgatitje do të bëhej siç duhej dhe në kohën e duhur për koncertin më të madh të gjitha kohëve. Për njëqind vjet me radhë, ndërtuesit do të punonin për të ngritur në qiell skenën, për çastin e madh.

Dhe kur të vinte çasti i madh, engjëlli Gabriel do të lajmëronte: “Ai lindi! Shfaqja filloi, djema është radha juaj!” Perdet e skenës do të ngrihen dhe para jush shfaqet turma e njerëzve - gjashtë barinj?! Çfarë zhgënjimi! “ Si ka mundësi?” pyet dikush, “Kush ishte ngarkuar me shpërndarjen e afisheve?”

Barinjhtë zakonisht banonin në vende jo shumë të populluara dhe pjesën më të madhe të kohës e kalonin me dhentë. Gjithashtu barinjhtë nuk ishin lajmëtarët më të mirë për të sjellë një lajm kaq të rëndësishëm. Në kohën e Jezusit, nuk gëzonin më atë emër të mirë, që kishin pasur në kohën e Davidit. Tani ata ishin të dyshimtë, pasi disa herë ishin rrekur të vinin dorë mbi pronat e të tjerëve. Në qytete sidomos, ata nuk ishin aspak të mirëpritur dhe njerëzit nuk u zinin besë fjalëve të tyre.

A mund të dëgjoni bisedën në një shtëpi të Betlehemit? Barinjhtë, pasi kanë vizituar grazhdin largohen dhe rrugës duke dalë nga qyteti, trokasin në dyert e shtëpive pa rreshtur së thirruri: “Jozueu lindi! Jozueu lindi!”

“Uh! një tjetër Jozue iu shtua lagjes sonë. Edhe kjo na duhej! Po kush që ai që e dha lajmin?”

“O, që hajduti, miku i këtyre anëve.”

“Me të vërtetë e ke?”

Ndërsa mësojmë sa thjesht u lajmërua lindja e Jezusit, na habit fakti se cila kategori njerëzish vlerësohej para syve të shërbëtorit Jezus. Sidoqoftë të kemi pak durim dhe të shohim fytyrën e tij e cila pa dyshim do të na bëjë ta admirojmë, apo jo?

## *Pamja e Tij*

Jezusi nuk që i pashëm. Ndoshta do ta keni të vështirë ta pranoni një gjë të tillë dhe mund të më drejtoheni: “Tani po e teproni paksa! Unë e kam fotografinë e tij në mur dhe s’është aspak i shëmtuar. Përkundrazi, ka një pamje tërheqëse burrërore.” Më falni, por të shohim se si e përshkruan Isaia:

Nuk kishte figurë as bukuri për të tërhequr  
shikimin tonë,

As paraqitje që ne ta dëshironim.

Isaia 53:2

Jezusi që aq i zakonitë nga paraqitja, sa shpesh nuk dallohej mes turmës së njerëzve. Duke qenë fare i zakonitë dhe duke mos u dalluar

nga të tjerët, edhe tre vjet pas ardhjes së tij, ditën që e tradhtoi, Judës iu desh ta puthte që ta identifikonte. E kush e di, mbase tradhtari vetë mund të kishte qenë më i pashëm se i tradhtuari.

Kjo flet shumë për aftësinë që kishte Jezusi për tu afruar me njerëzit. Unë vetë e kam provuar xhelozinë, kur gjendem në prani të burrave të pashëm. Të gjithë mund të ndiheshin të qetë në praninë e tij. Por Jezusi erdhi në një formë që nuk ishte kërcënuese ndaj asnjërit. Pamja e tij në asnjë mënyrë nuk e ndau nga njerëzit e zakonit dhe të varfër, tek të cilët e kishte dërguar Ati i tij. Meqenëse pamja e tij nuk e ndau nga të tjerët, sigurisht që shtëpia do ta ndante, apo jo? Le t'i kthehemi përsëri këtij aspekti të ardhjes së tij në jetë.

A keni menduar ndonjëherë se ç'do të kishit bërë sikur Mesia të kishte lindur në familjen tuaj? Ja, ku do të keni xhevahirin më të çmuar të të gjithë historisë. Çfarë do bënit me të? Çfarë shtëpie do blinit për të? Në ç'qytet do donit të jetonit? Ç'fqinjë do donit të kishit përreth jush? Ç'shoqëri do t'i zgjidhnit? Shpesh të zë belaja me gjërat që kanë vlerë të madhe, pasi nuk di si të veprosh me to. Sigurisht, ju nuk do ta mbanit nëpër xhepa diamantin e Shpresës dhe as nuk do ta varnit me zinxhirë rreth qafës në vende me njerëz.

### ***A mund të dalë diçka e mirë prej Nazaretit?***

Jozefi dhe Maria tani kishin Birin e Perëndisë nën zotërimin e tyre. Çfarë duhej të bënin, tani? Ata e morën atë në Nazaret (pasi shkuan në Egjipt për të shpëtuar kokën). Sigurisht, Nazareti nuk ishte vendi i përshtatshëm për të rritur Birin e Perëndisë. Nga pikëpamja morale dhe fetare, Nazareti kishte nam aq të keq, sa Natanieli, me të drejtë u përgjigj si më poshtë, kur i thanë se e kishin gjetur Jezusin nga Nazareti: “A mund të dalë diçka e mirë nga Nazareti?” (Gjoni 1:47).

Kështu Jezusi vazhdimisht shoqërohej dhe identifikohet me njerëzit e varfër dhe të thjeshtë. E çuditshme! Ati i tij qe shumë i pasur dhe zotëronte bagëti në një mijë kodra. Le të shohim se ç'do të ndodhë tani që ai do nisë t'i prishë ato para.

Pronësia mbi sendet përbën synimin e jetës në shoqërinë Perëndimore sot. Duke shëtitur përmes lagjes Beverli Hills të

Hollivudit në Kaliforni, kam parë dhe më është ngulitur në mendje ekspozimi i pasurisë, shtëpitë e mëdha luksoze, veturat e shtrenjta dhe rojet e sigurimit. Rëndësia e pronarëve spikat fuqishëm.

Po Jezusi nuk zotëroi gjë tjetër përveç trastës që mbante pas shpine. Askujt nuk i binte në sy kjo dhe askush nuk e lakmonte. Këtë e shprehu dhe ai vetë: “Dhelprat i kanë strofkat, dhe zogjtë e qiellit i kanë çerdhet, por Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështesë kokën” (Mateu 8:20).

Po si mendon ai t’i bëjë përshtypje kësaj bote ekonomike pa pasur vetë shtëpi ku të fusë kokën? Ai thjesht e konceptoi pasurinë ndryshe nga ne. Në predikimin që mbajti në Mal, ai u shpreh fare hapur:

“Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin. Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj.” (Mateu 6:19-21)

Jezusi nuk korruptohej nga paratë, pasi ai nuk u vinte shumë rëndësi. Ai që qe në gjendje të paguante taksat me monedhat e gjetura në gojën e një peshku dhe që kthente gurët në bukë, shumë lehtë mund të qe bërë financieri më i madh i të gjitha kohëve.

Në shoqërinë tonë pasuria ndikon dukshëm edhe në marrëdhëniet mes njerëzve. Personalisht, e kam shumë të vështirë të sillem natyrshëm në praninë e atyre njerëzve, që e di se kanë pasuri. Më pëlqen t’u qëndroj pranë dhe mundohem të sillem sa më “këndshëm” me ta (e pse jo, ndoshta ndonjëherë mund t’ju duhet t’u merrni para hua).

Vendimi i Jezusit për të përbuzur të mirat materiale e çliroi atë nga zilia e fshehtë, që mund t’i shfaqej gjatë takimeve dhe bisedave me njerëz më të pasur apo më të varfër se ai. Kështu ai do të ishte më i lirë për t’i përdorur gjithë energjitë dhe ndjeshmërinë e tij për nevojat reale të njerëzve, të cilëve ai u shërbente. Ai ishte i lirë të vepronte plotësisht i shtyrë nga dashuria për njerëzit.

Pali, tek letra e dytë e Korintasve 8:9 shkruante se “Jezus Krishti, i cili, duke qënë i pasur, u bë i varfër për ju, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij.” Jezusi, duke u endur nëpër këtë botë, i pa kompromentuar nga pasuria, zgjodhi rrugën e drejtë që nuk do

ta pengonte të vihej në shërbim të njerëzve. Ai nuk kishte ardhur për të shpenguar sendet. Ai erdhi për të shpëtuar njerëzit. Dhe ai na u përkushtua plotësisht.

*E papritura tjetër është se njeriu që lajmëroi ardhjen e tij që një lajmëtar tepër i çuditshëm. Sikur të më duhej të organizoja një numër kryqëzatash për shërbesën time dhe po të më duhej të dërgoja dikë për parapërgatitjet, do preferoja një ambasador të pashëm, të veshur hijshëm, me një të folur të shtruar, që pa dyshim do të më nderonte. Por, Jezusi si gjithnjë mendoi ndryshe prej meje. Përkundrazi, ai dërgoi një njeri fare të zakonshëm, që fliste me zë të lartë, që vishte rroba krejt të papërshtatshme dhe që ushqej ndryshe nga të tjerët. Si për t'i vënë kapakun gjithë gjërave të tjera bënte dhe veprimin “më jo dinjitoz”, zhyste në ujë të gjithë ata që merrnin guximin të pendoheshin për mëkatet e tyre:*

Gjoni erdhi në shkretëtirë duke pagëzuar dhe duke predikuar një pagëzim pendese për faljen e mëkateve. Por Gjoni ishte i veshur me lesh deveje, mbante një brez lëkure përreth ijëve dhe ushqej me karkaleca dhe me mjaltë të egër. (Marku 1:4,6)

Ai, pra, u thoshte turmave që shkronin të pagëzoheshin prej tij: “Pjellë nepërkash, kush ju ka mësuar t'i arratiseni zemërimin që po vjen?” (Luka 3:7)

Sa pa takt mund të shfaqesh? Po të isha në vendin e Jezusit do kisha frikë se pjesën më të madhe të kohës do ta kaloja duke justifikuar veprimet e lajmëtarit që përgatiti ardhjen time. Sidoqoftë, gjatë gjithë kohës Jezusi zgjodhi njerëzit që mund të na duken më të papërshtatshmit. Ai i pa njerëzit ndryshe nga unë. Për këtë do të bindemi më shumë pasi të kemi parë disa zgjedhje të tjera që bën ai.

## **Ekipi i Tij heterogjen**

Kur zgjidhet një president i ri në Shtetet e Bashkuara, të gjithë janë të interesuar të njohin njerëzit që punojnë me të - personelin dhe këshillin e ministrave që zgjedh. Kështu dhe Biri i Perëndisë zbret në tokë dhe fillon të paraqesë “mbretërinë” që do ta formonte me atë bandë endacake njerëzish.

Unë, personalisht do t'i kisha rekomanduar që, së pari të drejtohej për tek seminari më me emër dhe të zgjidhte së paku tre profesorë me dije të thella mbi teologjinë dhe degëzimet e saj. Pastaj të shkonte në Hollivud dhe të zgjidhte ca njerëz me fuqi frymëzuese, që kishin aftësi për të tërhequr vëmendjen e turmave dhe për të dhënë shpjegimet përkatëse për fjalët e tij. Më pas të drejtohej për në Woll Strit dhe të zgjidhte ca milionerë (gjithmonë ia vlen të kesh disa prej tyre në grup). Dhe së fundi, patjetër duhej të shkonte në Masëll Biç për të zgjedhur nja gjashtë roje sigurimi, që kundërshtarët e tij fetarë të mos mund ta gozhdonin në kryq.

Por edhe kësaj radhe Jezusi nuk më pyeti mua. Doni ta dini se ç'bëri? Ai u end rrugëve dhe skelave, zgjodhi ekipin më të çuditshëm në botë që mund të dërgohej në misionin e rëndësishëm për të ndryshuar botën. Sikur të ecnit pranë tyre që prej 20 metrash do të ndienit patjetër kutërbimin e peshkut. Në ekipin e tij ishte gjithashtu një zelotas dhe një tagrambledhës (kjo është sikur të kesh brenda të njëjtit grup një revolucionar zezak dhe një anëtar të Ku Kluks Klanit). Disa prej tyre flisnin me një theks shumë të vështirë për t'u kuptuar, që vështirë të plotësonin nevojat komunikuese të grupit. Vazhdimisht, Jezusi gjendej mes llumit të shoqërisë, të përbërë prej vagabondëve e hileqarëve deri tek imoralët.

Unë s'do kisha mundur ta mbaja në punë më tepër se dy javë Pjetër peshkatarin. Jeta e tij dëshmonte se ai fliste gabim tamam aty kur nuk duhej dhe karakteri i rrëmbyer që e karakterizonte ia përgjysmonte vlerën. Por Jezusi jo vetëm që e mbajti në ekipin e tij, por edhe i dha një vend të rëndësishëm. S'kishte si të mos ndodhte kështu, pasi Jezusi i sheh njerëzit krejt ndryshe nga unë dhe kërkon me durim përsosjen e tyre.

Përbërja heterogjene e ekipit të tij më jep zemër, pasi kur mendoj se ai mund t'ia dilte mbanë me atë lloj kategorie njerëzish, pa dyshim që ai mund ta bëjë edhe me mua...por edhe me ju. Ai nuk përdorte kriterin e përzgjedhjes si ne. Një dëshirë dhe thirrje ndaj të lodhurve dhe të dërrmuarve nga jeta, s'kishte si t'i mblidhte njerëzit më të aftë dhe të zgjuar. E prapë ai vazhdon t'ia drejtojë thirrjen e tij kësaj kategorie njerëzish:

Shikoni në fakt thirrjen tuaj, vëllezër, sepse ndër ju ka jo shumë të ditur sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë

fisnikë, por Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, që asnjë në mish të mos mburret përpara tij.

(1 Korintasve 1:26-27,29)

Dashuria dhe konsiderata e tij për këtë kategori njerëzish i kapërcen kufijtë e logjikës sime, por ato përputhen plotësisht me natyrën e tij. I vetmi mjet për të mos rrezikur emrin e tij të mirë mbetej mënyra e shpejtë dhe e mahnitshme për t'i shpëtuar vdekjes. Por kam frikë se vdekja do të ishte goditja që do të shkaktonte zhgënjimin përfundimtar. Le të shohim se ç'ndodhi më vonë.

### ***Mënyra se si vdiq***

Të gjithë e pranojmë se Jezusi pati një vdekje famëkeqe, edhe pse unë nuk e kuptoj mirë ndjenjën e turpërimit që ai mund të ketë provuar në atë rast. Përshkrimet e dhëna në Bibël mbi vdekjen e tij, nganjëherë më dukeshin të paqarta: “Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbin...” (1 Korintasve 1:18). Kryqi, për mua nuk ka qenë kurrë një marrëzi. E shihja kryqin kudo. Ai zbukuronte plot hijeshi kambanoret e larta. I larë me argjend dhe i gdhendur në dru të lëmuar zbukuronte mjediset e brendshme të kishave dhe të institucioneve të tjera fetare. Ai varej në stolitë me vlerë që zbukurojnë qafat elegante të vajzave dhe grave, hijeshonte jakat e xhaketave dhe dallohej mes zbukurimeve përrallore të kishave të mëdha. Për të flitej e këndohej shumë. Njerëzit mbartnin kryqe të rënda si ndëshkim për veten apo për shfaqje të bujshme. Kryqi e mbushte botën time dhe kurrë nuk mund ta mendoja si një marrëzi. Si mund të ishte i tillë?

Më vonë e kuptova se nuk e kisha patur të qartë konceptin mbi kryqin, arsyeja kryesore ndoshta që, se njerëzit sot nuk kryqëzohen. Sikur Jezusi të kishte ardhur në ditët tona, ne do ta kishim trajtuar më njerëzisht. Do ta kishim ekzekutuar në karrige elektrike, do ta kishim varur, do ta mbytnim në dhomën e gazit ose do ta nxirrnim para skuadrës së pushkatimit, ose së paku do t'i injektonim një dozë vdekjeprurëse droge.



Përfytyroni rezultatet e një ekzekutimi të tillë modern. Unë tani do gjendesha në rrugë, duke i mbërthyer nga fyti kalimtarët e duke u uluritur në fytyrë: “A e dini se miku im më i dashur sot vdiq për ju në karrigen elektrike? Po ta besoni këtë, të merrni mbi supë karrigen tuaj elektrike dhe t’i bini pas, do të gjeni shpëtimin.” Sigurisht edhe himnet tona të lavdishme do të këndoheshin ndryshe. A mund të na përfytyroni duke kënduar: “Në karrigen elektrike, në karrigen elektrike, ku për herë të parë pashë dritën”? Apo : “Ka vend për ju në dhomën e gazit”? Apo: “Merrni skuadrën e pushkatimit dhe më ndiqni”?

Sikur kjo të ndodhte, do të bëheshim qesharakë në sytë e botës. Do të na turpëronte fakti që shpresa jonë kishte patur një vdekje të turpshme, edhe pse e dinim se ai ishte ringjallur. Një vdekje e tillë do ta zhvlerësonte imazhin që kemi për kryqin. Le ta shpjegojmë me fjalë të tjera shkrimin e mëposhtëm dhe të shohim se si tingëllon ai.

“Sepse Judenjtë kërkojnë një shenjë dhe Grekët kërkojnë dituri, por ne predikojmë Krishtin të ekzekutuar në karrige elektrike, skandal për Judenjtë dhe marrëzi për Grekët...” (1 Korintasve 1:22-23, duke kërkuar ndjesë).

“Sepse e vendosa të mos di tjetër gjë ndër ju, veç Jezus Krishtit edhe atë të ekzekutuar në karrigen elektrike.” (1 Korintasve 2:2, duke kërkuar ndjesë).

Po të më duhej të vendosja për vdekjen time do të zgjidhja më mirë një vdekje heroike, që do nderohej më pas me medalje trimërie, sesa vdekjen prej një krimineli të zakonit. “Kupa e vuajtjeve” që piu Jezusi ia kalonte vdekjes së thjeshtë. Vdekja e tij qe një dënim poshtërues ngaqë ai mori mbi vete mëkatet, krimet, barbarizmat e mbarë krijesës.

Tani le të kthehemi prapa të shohim se ç’kemi zbuluar.

## *Zgjedhja e lirë*

Kur sjell ndër mend faktet mbi jetën e Jezusit - i lindur në grazhd, me prindër të dyshimtë, prejardhja e tij e njollosur, emri i tij më se i zakonshëm, lajmërimi tepër modest i lindjes, pamja e tij fare e

zakonshme, fqinjësia e keqe, varfëria, bashkëpunëtorët e tij të rëndomtë dhe vdekja e tij e turpshme- menjëherë e shoh këtë mënyrë si të papërshtatshme për t'u futur në metodat dhe veprimet që do të përdorja unë për “të fituar botën”.

Mënyra se si Jezusi erdhi dhe u afrua me ne nuk qe aspak kërcënuese apo manipuluese. Në çdo hap të jetës së tij ai u udhëhoq nga butësia dhe toleranca. Ai s'kishte asgjë në botë, por gjithçka në Atin dhe në Frymë.

Me mënyrën se si na u afrua, ai deshi të sigurohej se edhe ne do t'i përgjigjeshim me ndershmëri. Ai nuk përdori asnjë mjet imponimi apo mashtrimi që mund të na detyronte të merrnim vendime jo të sinqerta. Kjo është dëshmi e një dashurie të vërtetë. Duke ia kushtuar veten të tjerëve, duke u vënë në shërbim të të gjithëve ai na donte sa më të sinqertë dhe realistë, gjithmonë të gatshëm për të marrë vendime me gjithë zemër.

Në ditën e Falënderimeve të vitit 1956, dridhesha më shumë nga frika dhe ngacmimi i ndjenjave, sesa nga të ftohtët therrës të Memfisit në Tenesi, ndërsa në dorë mbaja të shtrënguar fort unazëndhe i kërkoja Ada Fej Braunit të bëhej bashkëshortja ime. Për fat të mirë ajo pranoi. Mund të kisha vepruar edhe ndryshe. Në një rën dorë mund të kisha mbajtur unazën dhe në tjetrën një pistoletë për ta detyruar që të martohej me mua, duke i thënë se kjo do të ishte për të mirën e saj. Po të kishte ndodhur kështu do të më duhej që çdo ushqim që do të më servirte t'ia hidhja më parë qenit, për t'u bindur që s'ishte i helmuar. Dashuria e vërtetë bazohet në vendime të sinqerta.

Për fat të keq, në jetë ka shumë pak vendime të pastra. Shumica e zgjedhjeve që bëjmë ndikohen nga kushtet dhe kërkesat e jashtme. Por kur flasim për vendimin më të rëndësishëm në jetë, vendimin tonë për Perëndinë, Jezusi kërkon nga ne sinqeritet dhe mënyra se si na është afruar e bën të mundur një vendim të tillë. Ne jemi të lirë ta pranojmë ose ta refuzojmë. Perëndia e respekton personalitetin tonë, si dhe lirinë për të zgjedhur. Kjo është dashuri.

# Krijuesi i Stilit

## Numri Një

Po të na duhej ta analizonim Biblën në mënyrë objektive dhe t'i radhisnim ngjarjet dhe personat sipas rëndësisë, pa dyshim Jezusi do të ishte figura qëndrore. Këtë e vërtetojnë më së miri vetë fjalët e Jezusit: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje. Po të më kishit njohur, do të kishit njohur edhe Atin tim; qysh tani e njihni dhe e keni parë”. (Gjoni 14:6-7).

Fryma e Shenjtë e ndihmoi Palin ta përjetonte Jezusin ashtu siç e përshkruan atë në letrën që i drejton Kolosianëve:

Ai është shëmbëllesa i Perëndisë së padukshëm, i parëlinduri i çdo krijese, sepse në të u krijuan të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato mbi dhe, gjërat që duken dhe ato që nuk duken: frone, zotërime, principata dhe pushtete; të gjitha gjërat janë krijuar me anë të tij dhe në lidhje me të. Ai është përpara çdo gjëje dhe të gjitha gjërat qëndrojnë në të. Ai vetë është kreu i trupit, pra i kishës; ai është fillimi, i parëlinduri nga të vdekurit, përderisa të ketë parësinë mbi çdo gjë, sepse Atit i pëlqeu që në të banojë me gjithë plotësinë, dhe, duke bërë paqen me anë të gjakut të kryqit të tij, duke fituar pas, me anë të tij, të gjitha gjërat, si ato që janë mbi dhe dhe ato që janë në qiejt.

(Kolosianëve 1:15-20)

Meqenëse Jezusi është shëmbëllesa e dukshme e Atit në formë trupore dhe meqenëse tek ai gjejmë një thesar të pashtershëm diturie dhe zgjuarsie, ne mund të themi:

Po të dua ta njoh Perëndinë, do ta njoh përmes Jezusit.  
 Po të dua të marr dije, ato do t'i gjej tek Jezusi.  
 Po të dua të kem urtësi, atë mund ta marr nga Jezusi.  
 Perëndia është i gjallë tek unë sepse Jezusi jeton brenda meje.  
 Po të dua t'a studioj Perëndinë, duhet të studioj Jezusin.  
 Në qoftë se Fryma e Shenjtë vepron në jetën time, ai do të më flasë për Jezusin.

Personaliteti, jeta dhe fjalët e tij duhet të jenë shembull për ne dhe ne duhet t'i përvetësojmë me gjithë energjitë tona. Epërsia e tij duhet të spikasë në çdo gjë. Sidoqoftë s'mund ta mohoj se gjëra të tjera kanë zënë vend më të rëndësishëm në jetën time. Unë e kam përqëndruar vëmendjen më tepër në ato gjëra që sipas meje, sjellin siguri në jetë, p.sh: të fitoj sa më shumë para, të marr tituj nderi, të realizoj kështu ambiciet e mia personale. Ndoshta kjo ndodh për shkak të një përfytyrimi të gabuar mbi natyrën e vërtetë të Jezusit. Miopia ime shpirtërore shpesh synon ta shtrembërojë përfytyrimin tim. Shpesh arrij në përfundime të tilla të gabuara se çdo gjë "e suksesshme" apo "fitimprurëse" që bëhet në emër të Jezusit është e drejtë pasi kam ndjekur rrugën e tij, dhe për rrjedhojë mban mbi vete bekimin e tij. Mendjeshkurtësia ime arrin deri aty sa të pranoj si të frymëzuara nga vetë Perëndia të gjitha ato sisteme veprimi botërore "të suksesshme" vetëm ngaqë veprimtarinë e tyre e fshehin pas emrit të Jezusit apo nën formën e një kishe.

Për të kuptuar dobësinë time nuk është e nevojshme të njoh shkakun dhe të gjej zgjidhjen. Cila do ishte rruga për ta korrigjuar këtë pikëpamje të gabuar? Mos ndoshta duhet ta jetoj me të vërtetë natyrën e Jezusit? Për të marrë përgjigjen e drejtë le t'i drejtohem i njëjës prej urdhëresave që Jezusi ua dha dishepujve të tij duke theksuar që ta zbatonin pikë për pikë.

## Një Për të Gjithë

Jezusi u dha shumë urdhëresa dishepujve të tij dhe të gjithë atyre që i ranë pas, por të gjitha këto urdhëresa mund të konsiderohen thjesht nëntituj të asaj urdhërese tepër të rëndësishme që ai na la: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu dhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin”. (Gjoni 13:34,35)

Duke lexuar këto fjalë menjëherë më tërhoqën vëmendjen dy gjëra. Së pari, Jezusi kërkoi që tipari dallues i pasuesve të tij të ishte dashuria për njëri-tjetrin. Ai s’do t’ia dijë për njohuritë e mia mbi Shkrimet e Shenjta, për mënyrën e të veshurit apo për qindjen e mbulimit të trupit, as për ritet fetare që kryej çdo javë apo për anëtarësinë time në një organizatë të caktuar. Për të s’ka rëndësi gjatësia e flokëve të mi apo stolitë e tjera. Madje as tradicionalizmi im. Sipas tij vetëm dashuria ime për të tjerët më vulos ashtu siç duhet.

Një gjykim i tillë zgjon brenda meje njëfarë proteste. Duket sikur Krishti mohon domosdoshmërinë e dijes, domosdoshmërinë e një jetese të shenjtë apo të një paraqitjeje të hijshme. Për më tepër, ai as që e përmend se cila është rruga e drejtë e përvojës dhe praktikës shpirtërore që duhet ndjekur në këtë kontekst. Po bindja, shpëtimi, shenjtërimi, pagëzimi, jetesa e shenjtë, e dhjeta e kishës? A s’janë të gjitha këto etiketa që do të më identifikonin menjëherë? Sipas

nesh këto janë të rëndësishme, por ja që Jezusi nuk beson në to. Mos vallë këtë herë ai po na ofron një Ungjill të ri, të thjeshtëzuar, pa pikë vlere? Zor se ndodh kështu. Shpejt arrij ta kuptoj se pa praninë dhe fuqinë e Jezusit në qenien time s'jam veçse një njeri egoist dhe aspak i dashur (me përjashtime të dukshme por jo të qëndrueshme) pa praninë dhe fuqinë e Krishtit brenda meje.

Së dyti vëmendja jonë duhet të përqëndrohet në urdhëresën që Jezusi jep për të dashur njëri-tjetrin ashtu “siç ju kam dashur unë”. Pa dyshim që pas kësaj urdhërese fshihet diçka! Mos vallë kjo do të thotë se vetëm po të kryqëzohemi si ai ne do të mund të tregojmë atë dashuri që e karakterizonte atë? Po e them hapur se kjo rrugëzgjdhje s'më tërheq dhe s'më duket aspak praktike. Kush do ta predikonte Ungjillin sikur të gjithë të krishterët të kryqëzonin veten? Nga kjo mund të lindte një rit i ri fetar interesant. Por, le të tregohemi më të duruar dhe të mos arrijmë në përfundime të nxituara. Edhe Jezusi s'qe kryqëzuar ende kur ua dha këtë urdhëresë të rëndësishme dishepujve të tij, e megjithatë ata e kuptuan se ç'desh t'u thoshte. Madje as Pjetri s'e pyeti: “Ç'doni të thoni me fjalën dashuri?” Pa dyshim që sjellja dhe veprimet e Jezusit deri në atë kohë, jo vetëm që i kishin bindur dishepujt për dashurinë e madhe që ushqente për ta, por u lanë edhe një model të gjallë e praktik.

Në kulturën tonë, kur duam t'i bëjmë të ditur dikujt se e duam i themi thjesht: “Të dua”. Por Jezusi nuk vepronte kështu, së paku në Shkrimet e Shenjta nuk thuhet gjë për këtë. S'më besohet që ai t'i ketë reshtuar dishepujt e tij dhe të gjithëve me radhë t'u ketë thënë: “Pjetër, unë të dua ty. Jakob, unë të dua ty. Gjon, unë të dua ty. Juda, unë të...” Mënyra sesi Jezusi u shërbeu dishepujve e bëri më se të qartë dashurinë e tij. Askush më parë s'kishte treguar për ta një dashuri aq të plotë e të sinqertë. Kaq e rëndësishme është kjo urdhëresë dhe ky shembull i tij, saqë po ta kuptoni mirë, do të zbuloni se ky është filli që do të endë Dhiatën e Re.

## Të Gjithë për Një

Njëra nga temat e trajtuara më qartë në Dhiatën e Re është tema e dashurisë. Vetë Jezusi e thekson rëndësinë e saj:

Dhe një nga ata, mësues i ligjit, e pyeti për ta vënë në provë, duke thënë: “Mësues, cili është urdhërimi më i madh i ligjit?”. Dhe Jezusi i tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde”. Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët”. (Mateu 22:35-40)

Me fjalë të tjera, “Ja se për çfarë bën fjalë Bibla”. E pabesueshme! Kaq me forcë spikat në këta paragrafë dashuria për Perëndinë dhe për të afërmit, saqë mua më trondit shumë fakti që kjo deklaratë dashurie mungon në thëniet e mëdha doktrinare të grupimeve fetare, mungon në teologjitë e mëdha, mungon në deklaratat e besimit, dhe ç’është më e keqja, ajo mungon në jetën tonë të përditshme.

Por prapë kjo natyra shërbyese e Jezusit a i përmbush të gjitha elementet e dashurisë së tij? Dhe ç’gjëra mund të bëjë dashuria?

Apostulli Pal, në letrën drejtuar Korintasve 13 bën një deklaratë klasike mbi dashurinë. Këtu ai thekson se gjuhët hyjnore apo ato njerëzore, profecia apo dituria, besimi dhe filantropia s'kanë asnjë vlerë në qoftë se nuk motivohen nga dashuria. Kjo deklaratë na godet në pikën më të dobët. Mundësia për të folur i jepet më lehtë oratorit, i cili është i aftë të na mallëngjëjë, ose atyre njerëzve që, duke folur me gjuhën e engjëjve mund të përndezin turma të tëra njerëzish, por ja që Pali ngrihet kundër këtyre oratorëve “dinamikë”, kur atyre u mungon dashuria. Herë pas here, profetë të vetëshpallur shfaqen nëpër rrugë për të na njohur me periudha dhe ngjarje të caktuara, ose për të na sjellë fjalën e fundit nga vetë Perëndia. Të etur për dije, ne i mirëpresim ata, edhe pse Pali i shumëzoi me zero përpjekjet e tyre kur ato nuk motivohen nga dashuria.

Unë vetë jap mësim në një universitet, ku dijes i jepet rëndësi e dorës së parë. Dijet janë e vetmja gjë që jemi në gjendje të vlerësojmë dhe e vetmja gjë që, në fund të fundit shpërblehet me nota e diplomë. Njerëzit me kulturë dhe me tituj shkencorë janë krenaria e institutit tonë dhe instituteve të tjera, por, ja që Pali e barazon inteligjencën e tyre me mendjeshkurtësi kur kjo nuk motivohet nga dashuria.

Besimi dhe mësimi mbi besimin në qarqet kristiane sot është kthyer në një biznes të madh. Sikur papritur të shfaqej një profesionist që do të deklaronte se ishte në gjendje të zhvendoste Majën e Vezuvit nga Italia në Zvicër dhe më pas ta realizonte këtë, s'do mbetesh mjet informativ i atij vendi pa e ndjekur me interes. Sigurisht, ai do bëhej njeriu më i kërkuar i kohës dhe ftesat për të folur para auditorëve më të mëdhenj do të ishin të panumërta. S'ka dyshim që besimi i konkretizuar jep shumë rezultat, por ja që Pali e barazon me paganizëm kur ky besim nuk motivohet nga dashuria.

Njerëzit vlerësojnë shpirtin vetëmohues të një filantropi, sidomos të një filantropi që tregohet aq bujar, sa arrin të mbajë mbi vete damkën e një skllavi edhe pse kjo nuk i përket atij por dikujt tjetër. Por, çuditërisht, ai mund të jetë nxitur nga ndonjë motiv tjetër dhe jo nga dashuria. Kjo bën që ai ta humbasë vlerën e tij. Shpesh ndodh që shumë akte bamirësie të bëhen për të ushtruar ndikim ose për përfitime financiare personale.



Nga njëra anë s'mund të mohojmë vlerën e oratorisë, besimit, diturisë, por nga ana tjetër duhet të pranojmë se dashuria është arritja më e madhe. Ndodh nganjëherë që edhe aktet dashamirëse dhe bamirëse sjellin pasoja shkatërrimtare kur nuk motivohen nga dashuria.

Pali vazhdon më tej duke na dhënë një listë të tërë tiparesh dhe përcaktimesh të fuqishme mbi atë që çfarë është dhe çfarë bën dashuria:

Dashuria është e durueshme  
Dashuria është plot mirësi  
Dashuria s'njeh kurrë smirë  
Dashuria nuk ve në dukje  
Dashuria nuk krekoset  
Dashuria nuk sillet në mënyrë të pahijshme  
Dashuria nuk kërkon të sajat  
Dashuria nuk pezmatohet  
Dashuria nuk dyshon për keq  
Dashuria gëzohet për të vërtetën  
Dashuria gjithmonë mbron  
Dashuria gjithmonë beson  
Dashuria gjithmonë shpreson  
Dashuria këmbëngul gjithmonë  
Dashuria kurrë nuk dështon

Të shërbyerit, për nga natyra e tij i përmbush këto veprime dhe cilësi. Shikoni sa e rëndësishme është në letrën e Gjonit thirrja për dashuri:

Nga kjo e kemi njohur dashurinë: ai e dha jetën e vet për ne; dhe ne duhet ta japim jetën tonë për vëllezërit. Dhe nëse njëri ka të mirat e kësaj bote dhe sheh të vëllanë që është në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë? Djema të rinj, të mos duam me fjalë, as me gjuhë, por me vepra dhe në të vërtetë. (1 Gjonit 3:16-18)

Vetëm kur u ndesha me faktin se marrëdhëniet tona me Perëndinë dhe efektiviteti i veprimeve tona në jetë përcaktohen nga aftësia që kemi për të dashur njëri-tjetrin, fillova ta kuptoj se Dhiata e Re jepte këshilla tepër të çmuara mbi mënyrën se si duhet ta trajtojmë “njëri-tjetrin”. Ja disa shembuj tepër inkurajues:

Ëmbëlsisht të dhembshur njëri me tjetrin  
 Ndershmërisht të pëlqyer nga njëri tjetri  
 Të një mendjeje njëri me tjetrin  
 Duke mos gjykuar njëri-tjetrin  
 Në paqe dhe mirëkuptim me njëri-tjetrin  
 Duke pranuar njëri-tjetrin  
 Duke u këshilluar me njëri-tjetrin  
 Duke u përshëndetur me një puthje të shenjtë  
 Duke u kujdesur për njëri-tjetrin  
 Duke i shërbyer njëri-tjetrit  
 Të duruar me njëri-tjetrin  
 Të dashur, e të dhembshur me njëri-tjetrin  
 Duke falur njëri-tjetrin  
 Duke iu nënshtruar njëri-tjetrit  
 Duke qenë të çiltër me njëri-tjetrin  
 Duke ngushëlluar njëri-tjetrin  
 Duke ndërtuar njëri-tjetrin  
 Pa paragjykime për njëri-tjetrin  
 Në pritje të njëri-tjetrit  
 Duke u lutur për njëri-tjetrin  
 Duke dashur njëri-tjetrin (shumë herë)

Kështu, edhe njëherë, të shërbyerit i përmbush këto urdhëresa për nga vetë natyra, nga vetë përkufizimi i tij. Vite më parë, ndërsa asistoj në një shërbesë në mëngjesin e Ditës së Pashkëve, dëgjova një predikues të thoshte se Bibla përqëndrohet kryesisht në atë ç’ka duhet të besojmë dhe flet pak për mënyrën se si duhet të lidhemi me njerëzit. Kjo s’është aspak e vërtetë. Ka ardhur koha që ne ta përmbledhim atë mori mësimesh të Biblës dhe të përpunojmë një teologji mbi marrëdhëniet mes njerëzve. Kjo teologji do të na ndihmonte për t’u bërë qytetarë të denjë të mbretërisë së Perëndisë.

Kuptimi i drejtë i këtyre marrëdhënieve do të na lejonte t'i shihnim më qartë e ashtu si duhet parimet e Shkrimit të Shenjtë. Kjo do të parandalonte gjithashtu, të qenit abuzues me Shkrimet e Shenjta për përfitime vetiake.

Çdo vit, në ato orë mësimi, ku i njohim studentët me parimet e edukimit të krishterë, u kërkoi studentëve të mi të shkruanin diçka për mësuesin që u kishte lënë më tepër mbresa në jetën e tyre dhe që i kishte nxitur më tepër të studionin. Pa përjashtim, në fletët e tyre ishin emrat e atyre mësuesve që i kishin dashur ata më shumë dhe që ua kishin shprehur haptazi atë dashuri. Kompetencat shkencore dhe stërhollimi i metodave mësimore zinin vendin e dytë, pas dashurisë. E megjithatë s'kam dëgjuar ndonjë institucion arsimor që ta zgjedhë stafin pedagogjik në bazë të aftësisë që kanë njerëzit për të qenë të dashur, duke përfshirë institutet e studimit biblik.

Nevoja për t'u karakterizuar nga dashuria dhe aftësia për të dashur ashtu siç donte Jezusi është e pafund dhe gjithnjë në rritje. Për fat të mirë do të jetë e qartë se natyra shërbyese e Jezusit i sqaron të gjitha paqartësitë që mund të kemi mbi dashurinë.

## Një Ndër të Shumtët

Kuptimi i vërtetë i lutjes së madhërishtme të Jezusit, të dokumentuar në kapitullin e 17 të Ungjillit sipas Gjonit, ku ai i drejtohet Atit për nxënësit e tij, mund të dalë i qartë vetëm në kontekst me urdhëresën e tij parësore për të dashur njëri-tjetrin. Kjo urdhëresë kaq e rëndësishme, të cilën Jezusi e thekson në kapitullin e 13 na mëson se marrëdhëniet tona me Perëndinë përcaktohen nga marrëdhëniet tona me njëri-tjetrin. Prandaj në këtë lutje ai sqaron se nga ana ungjillzuese në marrëdhëniet midis njerëzve lidhën ngushtë me aftësinë që kam për të dashur vëllain dhe të afërmin tim.

Aq shumë rëndësi i kushton Jezusi kësaj, sa që në lutjen e tij pesë herë përsërit të njëjtën gjë, një përsëritje kjo që spikat menjëherë. Ai i lutet Atit që nxënësit e tij, edhe pse ishin shumë, duhej të vepronin si një trup i vetëm. Sa e thjeshtë është kjo lutje e tij dhe sa kuptimplotë në të njëjtën kohë! Ai lutet që ne të jemi një e të pandarë, siç qe ai me Atin e tij. Duhet ta pranoj se, edhe pse kam besuar gjithnjë në Trininë e Shenjtë, kurrë s'e kam kuptuar atë. E kam tepër të vështirë ta kuptoj se si tre persona të veçantë mund të formojnë Perëndinë e vetëm e të pandarë pa qenë të organizuar në një komitet, një komitet prej tre vetash, ku ndoshta në marrjen e vendimit për dërgimin e Jezusit në tokë, dy votuan kundër një të vetmi.

E megjithatë, uniteti i tyre ishte i tillë, saqë Jezusi mundi të thoshte “Kush më ka parë mua, ka parë Atin.” Në ç’unitet duhet të jemi ne, që të mund të themi: “Në qoftë se doni të dini se ç’i krishterë jam unë, analizoni një të krishterë tjetër...dhe po ta keni parë atë, dijeni se më keni parë mua”? Që të arrijmë këtë duhet që, së pari të ndryshojmë dhe të përmirësojmë marrëdhëniet me njëri-tjetrin brenda dhe përtej kufizimeve sektare.

Shprehja tjetër, të cilën ai e lidh me lutjen që bën për bashkim ka një domethënie të thellë për ungjillizim. Ai i lutej Atit: “Le të jenë të përsosur në unitet, *që bota të njohë që ti më ke dërguar* dhe që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua.” (Gjoni 17:23-e bërë me shkronja të pjerrëta prej autorit). Shumicën e përpjekjeve të mia si ungjilltar i kam përqëndruar në zgjerimin dhe thellimin e metodave gjithnjë e më krijuese, që Ungjilli t’i kapërcejë pengesat që ndesh në botë. Për këtë kam arritur të vij në sisteme më të mira shitjeje për fitimin personal të shpirtave, të organizoj më mirë programet për auditore, të zgjedh oratorë të mirë, të shfrytëzoj më mirë mjetet e informacionit. Por, ja që burimi i forcës për të fituar botën qëndroka diku tjetër, tek aftësia që kemi për të dashur njëri-tjetrin dhe për të realizuar atë unitet për të cilin Jezusi i lutet Atit. E si mund të na zërë besë bota pa parë më parë frytet që sjell lidhja jonë me Jezusin? Derisa të shfaqen rezultatet frytdhënëse të këtij uniteti, Krishtërimi është thjesht një sistem filozofik për t’u diskutuar, por jo për t’u jetuar. Sigurisht që tani jemi bindur se egoizmi dhe vetëkënaqësia janë burim përçarjeje, ndërsa dashuria dhe të shërbyerit janë themeli i bashkimit dhe unitetit. Kur midis nesh do të shfaqet dashuria e vërtetë, njerëzit do të vijnë vetë tek ne dhe “do kërkojnë të hyjnë me forcë në mbretërinë e Perëndisë.”

Në urdhëresën e tij tek kap. 13 i Gjoni dhe në lutjen tek kap. 17 i Gjoni, Jezusi i nxjerr pasuesit e tij që t’i gjykonte bota; “gjithë njerëzimi duhet ta dijë se ju jeni nxënësit e mi “ dhe “ t’i bëj të ditur botës se ju më dërguat”. Këtu përsëri mendja ime proteston. Kjo më duket një padrejtësi. Pjesën më të madhe të jetës e kam kaluar me mendimin se “Askush s’mund të më gjykojë; pasi përveç Perëndisë asnjë s’e njuh zemrën time”. Kjo mund të jetë e vërtetë, por ja që Perëndia e ka autorizuar botën të kontrollojë frytet tona të shpëtimit dhe të rritjes shpirtërore.

Në kopshtin e shtëpisë sime ndodhet një pemë. Kur bleva shtëpinë më thanë se ishte pjeshkë. Nga trangu dhe nga gjethet mund ta dallojmë lehtë se është pjeshkë. Por ja që gjatë gjithë këtyre viteve s'ka dhënë asnjë frut. Kështu një ditë vendosa t'i afrohesha asaj peme dhe ta prisja me sëpatë që të mos i rëndonte më tokës. Papritur dëgjova që ajo filloi të më lutej: "Mos më pre, të lutem! T'i s'mund të më gjykosh vetëm nga pamja e jashtme. Është e vërtetë që thellë në zemrën time unë jam pjeshkë. "Të tilla lutjeve s'duhet t'ua vëmë veshin. Ato janë shfajësime të kota. Ajo pemë që krijuar dhe mbjellë për të dhënë fruta e jo zemra pjeshkësh!

Pyetja që duhet t'i drejtoj vetes është: A jam pjesë e përmbushjes së lutjes së Jezusit? A jam unë një derë në mbretërinë e tij apo një dryn për ta kyçur derën e kësaj mbretërie, që të mos hyjë asnjë që nuk di fjalëkalimin, natyrisht "fjalëkalimin tim".

Ja, ku ndeshem edhe njëherë me nevojën për t'i dashur dhe për t'u shërbyer të tjerëve - së pari për t'u identifikuar si i krishterë dhe së dyti për të fituar botën me efektivitet. Ç'thotë fakti? Për t'u karakterizuar nga ajo dashuri që urdhëroi Jezusi dhe për të realizuar atë unitet për të cilin ai bënte fjalë, unë duhet të bindem më parë se ai është shëmbëllesa e gjallë e Atit dhe shembull frymëzimi për mua. Në qoftë se do të mbushem me Frymën e Shenjtë, duhet ta dëgjoj kur më flet për Jezusin dhe të udhëhiqem prej Frymës që të bëhem si Jezusi.

# Stili i Jezusit

## Ai Nuk Është i Paarritshëm

Asnjë teologji nuk është e rrezikshme ose me pasoja para se të vendosim ta zbatojmë në jetët tona. I tillë është rasti me këtë studim të Jezusit. Jeta jonë do të ishte me të vërtetë monotone dhe pa kuptim deri në atë çast para se të vendosnim të jetonim sipas shembullit të mësuesit tonë. Në këtë çast bëhet realitet edhe premtimi që na bën Jezusi: “Dhe të gjithë do t’ju urrejnë për shkak të emrit tim” (Mateu 10:22). Ky është një premtim i pa dëgjuar dhe sigurisht jo i këndshëm në krahasim me premtimet që bëjnë zakonisht njerëzit.

Nga leximi i pjesës së parë të librit zbulojmë se, shumica e cilësive të natyrës së Jezusit synojnë kryesisht të zbulojnë qëllimet dhe karakterin e vërtetë të Atit; ato s’janë urdhëresa të drejtpërdrejta që duhet t’i zbatojmë. Kështu për shëmbull, unë nuk mund të lindja në një grazhd nga prindër të dyshimtë, s’mund të kisha një emër dosido dhe lindja ime s’mund të lajmërohej nga engjëjt. Fakti që u rrita në varfëri dhe mes një fqinjësie të keqe nuk jep ndonjë domethënie çliruese për ju. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shenjat e tjera dalluese të Jezusit, si për ekipin e tij heterogjen dhe vdekjen e tij të turpshme.

Edhe pse për ne, këto janë thjesht tregues të natyrës së Jezuit, që s’mund të imitohen, s’duhet të harrojmë se karakteri i tij i shprehur tek udhëzimet mbi “Më të madhin e mbretërisë” dhe tek Filipianët 2:5-11 është plotësisht i arritshëm prej nesh.

Kush është më i madhi në mbretërinë e qiejve?

"Ai nga ju që do të dojë të bëhet i madh do të jetë shërbëtori juaj, dhe kushdo nga ju që dëshiron të jetë i pari duhet të jetë skllavi i të gjithëve."

"Ju e dini se ata që konsiderohen sundues të kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë mbi to pushtetin e tyre; por kjo s'duhet të ndodhë midis jush."

"Në qoftë se unë, Zoti dhe Mësuesi, ju kam larë këmbët, edhe ju duhet t'i lani këmbët njëri-tjetrit. Unë në fakt ju kam dhënë shembullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij."

"Kush, pra, do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve."

"I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse e tyre është mbretëria e Perëndisë."

"Më i madhi ndër ju le të jetë si më i vogli dhe ai që drejton si ai që shërben."

"Nëse dikush do të jetë i pari, le të bëhet i fundit i të gjithëve."

"Sepse ai që është më i vogli nga ju të gjithë, ai është më i madhi."

Marku 10:43-44; 10:42-43; Gjoni 13:1-16;

Mateu 18:4; Marku 10:14; Luka 22:26;

Marku 9:35; Luka 9:48



## Në Shërbimin Tuaj

*Nëse dikush do të jetë i pari le të bëhet shërbëtor i të gjithëve*

Kur nisi t'u shpjegonte dishepujve se ç'do të thoshte të jesh më i madhi i një mbretërie, Jezusi në fakt u foli për natyrën e tij, pasi ai vetë ishte dhe është më i madhi i mbretërisë. Tashmë dishepujt nuk e kishin të vështirë të kuptonin se ç'donte të thoshte ai, pasi ata i kishin parë të gjitha veprimet e tij shërbyese.

Ai, pra na mëson se kushdo që dëshiron të jetë më i madhi, duhet të bëhet shërbëtor i të gjithëve. Kjo është plotësisht në kundërshtim me prirjet e mia natyrore. Kultura dhe formimi im më mëson se, po të ndjek në jetë parimet morale të krishtera, Perëndia do të më shpërblejë duke më siguruar mirëqenie, mbarësi dhe një pozitë shoqërore gjithmonë më të lartë, ndoshta një ditë mund të më emërojë edhe president. Çuditërisht mase kur shoh se sa larg pikëpamjeve të mia ambicioze është natyra e vërtetë e Jezusit.

Si do të reagonte familja ime, sikur një ditë të bukur të kthehesha në shtëpi dhe t'u tregoja me mburrje se më kishin emëruar skllav? Sigurisht, ky lajm nuk do t'i ngazëllente aspak dhe as unë vetë nuk do të mburreja për një gjë të tillë. Ndoshta asgjë që ka të bëjë me natyrën e Jezusit dhe të jetuarit e saj prej meje nuk ia vlen të reklamohet.

Për t'i bërë bisht të shërbyerit unë përpiqem të gjej një klientelë “të këndshme”, së cilës mund t'i shërbej me kënaqësi. Por edhe këto përpjekje të miat dështojnë, pasi Shkrimet e Shenjta s'më lejojnë t'i shmangem kuptimit të drejtë të të shërbyerit. Jezusi tha: “...të bëhesh shërbëtor i të gjithëve.”

Të shërbesh do të thotë të ndihmosh me të gjitha forcat që t'ua bësh jetën më të mirë të tjerëve dhe t'i lejosh ata të gjejnë plotësisht vetveten.

Interesi i parë i shërbëtorit nuk është vetvetja, por të tjerët. Të kuptohemi drejt, nuk e kam fjalën për skllavërinë. Vënia në shërbim të të tjerëve është një zgjedhje e vullnetshme që ne bëjmë për t'u shërbyer të tjerëve. Nuk është rezultati i një veprimi të detyruar, apo një formë më e zbutur e këtij të fundit, siç është manipulimi.

### *Hapi sytë mirë*

Askujt nuk do t'i pëlqente të bëhej vegël në duart e të tjerëve, goftë edhe "vegël e vetë Jezusit". Por ne mund të bëhemi shumë lehtë vegël në duart e të tjerëve po qe se nuk do të kuptojmë dinamikën e manipulimit dhe mënyrën se si natyra e Jezusit e parandalon atë.

Manipulimi përshkon edhe marrëdhëniet tona me njëri - tjetrin. Duke përdorur dinakërinë apo forcën shpesh arrijmë t'u imponojmë të tjerëve vullnetin tonë, dhe kur ata bëhen pre e dinakërisë sonë, ne, jo vetëm që nuk i respektojmë, por shpesh i përbuzim. Kur nuk arrijmë t'i manipulojmë, "me indinjatë të ligjshme" u mësojmë se duhet të na shërbejnë me zell e me dëshirë.

Ka patur raste kur njerëz të ndryshëm më kanë kërkuar t'u bëj favore, që e dija se ishin në dëm të tyre dhe kur unë me mirësjellje nuk pranoja, të indinjuar më thonin: "Po unë të dija të krishterë ty! Kam menduar se të krishterët janë të gatshëm për të ndihmuar të tjerët!" Kësaj i thonë të të akuzojnë kur je i pafajshëm. Por ka raste kur ndihesh i detyruar të veprosh jashtë vullnetit tënd, i shtyrë nga ndjenja e turpfit ose nga frika se mos prishesh me persona të rëndësishëm, ose kur unë kam frikë që të mos e bëj atë atëherë jam manipuluar.

Kur e ndiej se kanë arritur të më manipulojnë, e ndiej veten shumë keq. Më vret fakti që jam kthyer në vegël në duart e të tjerëve dhe që dinjiteti im është çenuar rëndë. Ndoshta forma më e hidhur e manipulimit që kam provuar ka qenë kur njerëzit vendosin të bëhen të krishterë po t'u premtosh diçka si shkëmbim. Atëherë, puna arrin deri aty sa filloj të dyshoj se mos veprimi im bëhet shkas që këta njerëz të mos hyjnë në mbretërinë e Perëndisë.

Nganjëherë detyrohemi t'i nënshtrohemi vullnetit të disa

njerëzve, qofshin këta edhe prindërit tanë, për të mos humbur dashurinë e tyre apo nganjëherë edhe për shkak të varësisë financiare. Ka raste kur prindërit shtiren si të sëmurë me qëllim që fëmijët t'u binden. lista mund të shtohet.

Jezusi pati disa raste klasike kur njerëzit u munduan ta manipulonin. Disa nga Farisenjtë dhe Herodianët u dërguan posaçërisht për ta zënë në fjalë:

Këta erdhën dhe i thanë: “Mësues, ne e dimë se ti je i vërtetë pa pyetur për njeri, sepse nuk merr parasysh dukjen e njerëzve, por u mëson udhën e Perëndisë sipas së vërtetës. A është e ligjshme t'i paguhet taksa Çezarit apo jo? Duhet t'ia paguajmë apo jo? Por ai, duke njohur hipokrizinë e tyre, u tha atyre: “Përse më tundoni?”. (Marku 12:13-15)

Mjeti kryesor për të luftuar manipulimin është përlësia; ta njohim realisht veten dhe ta pranojmë siç jemi. Jezusi e njohte veten dhe kjo i jepte siguri dhe forcë për të mos u gënjyer nga lajkat e tyre. Ndryshe do veproja unë. Mua, do të më bëhej qejfi që, më në fund njerëzit do të m'i nxirrnin në pah vlerat dhe do të filloja të mbahesha më të madh. S'ka asgjë të keqe të pranosh gjëra të vërteta, por përlësia u pret rrugën lajkave dhe gënjeshtreve.

Jezusi e kundërshtoi me forcë manipulimin siç tregohet më poshtë:

Atëherë erdhën farisenjtë dhe nisën të diskutojnë me të, duke i kërkuar një shenjë nga qielli për ta vënë në provë. Por ai, duke psherëtirë në frymë, tha: “Përse ky brez kërkon një shenjë? Në të vërtetë po ju them se këtij brezi nuk do t'i jepet asnjë shenjë”. Atëherë i la, hipi përsëri në barkë dhe kaloi në bregun tjetër. (Marku 8:11-13)

Jezusi e dinte që Farisenjtë ndodheshin atje për qëllime keqdashëse dhe jo për t'u ndihmuar. Shpesh ata e shfaqnin hapur armiqësinë e tyre, në këto raste Jezusi i përlulur dinte edhe të zemërohej (gjë normale për natyrën e tij njerëzore). Dhe kur e shihte se debati me ta ishte i pafrytshëm, ai tërhiqej i pari.

Edhe kjo është një mënyrë për t'iu shmangur manipulimit. Në shumë raste Jezusi tërhiqej i pari. Për këtë dëshmon vetë Gjoni: "Por Jezusi, duke ditur se po vinin ta kapnin për ta bërë mbret, u tërhoq përsëri në mal, fill i vetëm." (Gjoni 6:15).

Karakteristikë e veçantë e manipulimit është se ai na pengon të zgjedhim lirisht. Ai na detyron të veprojmë brenda kornizave apo sipas modeleve që na kanë caktuar të tjerët. Asnjëri nga ata që u rrekën të manipulonin Jezusin nuk mori prej tij përgjigjen që priste, sepse përgjigjet e Jezusit shprehnin ndjenjat e tij të vërteta. Nganjëherë ai u shmangej, por, sidoqoftë, në çdo rast Jezusi mbrojti të drejtën e zgjedhjes dhe veprimit të lirë.

Skllavëria e detyruar dhe të shërbyerit e vullnetshëm janë dy koncepte krejt të ndryshme. Kur Jezusi tha se Ai zgjodhi të flijohej sipas vullnetit të tij të lirë, sepse askush nuk mund t'ia hiqte, Jezusi na njohu me konceptin bazë mbi dashurinë. Dashuria të nxit gjithmonë të bësh veprime të drejta dhe t'u shërbesh të tjerëve, por asnjëherë nuk të detyron. Dashuria është një zgjedhje e lirë. Dashuria e vërtetë s'mund të jetë rezultat i një vendimi apo dekreti dhe as i ndonjë detyrimi apo manipulimi. Çdo përpjekje për t'i penguar njerëzit që të marrin vendime të lira dhunon personalitetin e tyre. Kur e ndiej se më është cënuar liria e zgjedhjes, e di se më është mohuar dashuria dhe se nuk jam plotësisht i lirë për t'u shërbyer të tjerëve.

Atëherë me përlulesi them: "Ndoshta gabohem, porse në këtë rast e ndiej veten të detyruar dhe të manipuluar, dhe në këto rrethana nuk jam në gjendje të zgjedh dhe të veproj i shtyrë nga dashuria, prandaj e ndiej që rrugëzgjidhja më e drejtë është t'i shmangem kësaj situatë, deri sa ta ndiej veten të lirë për të bërë zgjedhjen që më duket e duhur."

Në ato raste kur zbulojmë se kërkesa që na bëhet synon të na manipulojë, veprimi më i drejtë është ta kundërshtojmë menjëherë. Kërkesat për të gjetur arsye shpesh bëhen pjesë e veprimeve manipuluese. Për t'i përballuar këto situata duhet të kuptojmë se nuk ka aq shumë rëndësi përgjigjja, por aftësia për të jetuar me ndershmëri, me qëllim që në të ardhmen të jemi në gjendje të bëjmë zgjedhje të drejta dhe të marrim vendime të frymëzuara nga dashuria për të tjerët.

Shpesh ndodh që, kur e kundërshtojmë atë që orvatet të na manipulojë si kundërpërgjigje ai bën skandal. Kjo, gjithashtu bën pjesë në manipulim dhe në çmimin që duhet të paguajmë për të ruajtur parimet tona morale. Përpiquni të mos lejoni që skandali

t'ju mashtrojë, pasi kjo mund të ndikojë pozitivisht në shërimin e manipuluesit.

Manipulimi është një sëmundje dhe manipuluesi është një njeri që vuan nga kjo sëmundje. Po qe se do t'i lemë shteg manipuluesit, ne i acarojmë më shumë plagët e kësaj sëmundjeje. Por, në qoftë se do ta luftojmë atë, pavarësisht nga vështirësitë dhe telashtet që mund të na dalin më pas, ne do ndihmojmë në shërimin e të sëmurit dhe për rrjedhojë, do të ruajmë edhe shëndetin tonë.

Nganjëherë ata që mundohen të jetojnë si Jezusi rrezikohen të bien në grackën e vetëmanipulimit. Ne i shohim nevojat e botës dhe e kuptojmë se bota ka nevojë për ne, por ne jemi kaq pak në numër. Atëherë nuk jemi në gjendje të qetësohemi. Kur shohim morinë e njerëzve që shtrijnë duart drejt nesh për ndihmë dhe ne mundohemi me të gjitha forcat që t'i ndihmojmë, por befas e kuptojmë se i kemi harxhuar të gjitha burimet tona, atëherë të zhgënjyer vendosim të tërhiqemi nga stili i Jezusit njëherë e përgjithmonë.

Edhe kësaj radhe, përlësia na jep rrugëzgjdhjen e duhur. Ajo na ndihmon të kuptojmë se ne s'jemi Zoti vetë dhe nuk zotërojmë fuqinë e tij. Pra ne nuk mund të përpiqemi të bëhemi Ai dhe me gjithë kufizimet tona, mund të provojmë të zgjidhim problemet e botës, por kur e ndiejmë se s'kemi më forca mund të tërhiqemi dhe të çlodhemi për njëfarë kohe. Jezusi vazhdimisht i merrte nxënësit e tij për pushime në vende të ndryshme. Edhe pse qe Perëndia vetë, ai i shmangej manipulimit të jetës së tij. Gjithë fuqinë që kishte e përdorte për marrjen e vendimeve të nxitura nga dashuria për njerëzit. Ai na bën thirrje të marrim vendime të vullnetshme që t'u shërbejnë të gjithëve.

# Piramida e Pushtetit

*Sundimtarët e kombeve ushtrojnë sundimin e tyre mbi njerëzit...*

*Por kjo s' duhet të ndodhë me ju.*

Kur analizojmë këtë urdhëresë ne çuditemi se sa larg saj janë kishat dhe sistemet tona fetare. Por pavarësisht nga ky fakt, vazhdojmë të pretendojmë se strukturat që kemi ndërtuar janë biblike dhe të pranuar nga vetë Perëndia.

Parimi për t'u bërë shërbëtor i të gjithëve shkakton trazira të mëdha në aparatet komanduese dhe në ato sisteme ku vepron hierarkia. Sot, çuditërisht shumë nga strukturat fetare paraqiten si kopje të gjalla të listave të organizimit të ndërmarrjeve të mëdha të biznesit, ku sistemi i “drejtimit” ka formën e piramidës. Në mbretërinë e Perëndisë ndodh krejt e kundërta. Piramida e pushtetit është e kthyer përmbys, me bazë lart dhe kulm poshtë; pra vendi i drejtuesve nuk është në bazën por në kulmin e piramidës.

Kur flet për përlësinë dhe nënshtrimin, Jezusi gjithmonë u drejtohet udhëheqësve dhe njerëzve që synojnë të jenë të mëdhenj në mbretëri, u mëson atyre se për të qenë të parët duhet t'u nënshtrohen atyre që kanë poshtë vetes dhe jo atyre që kanë mbi krye. Tek Mateu 20:16, Jezusi shprehet hapur: “Kështu të fundit

do të jenë të parët dhe të parët të fundit, sepse shumë janë të thirrur, por pak janë të zgjedhur”.

Koncepti i Jezusit mbi nënshtrimin e më të mëdhenjve ndaj më të vegjëlve shënonte një rritje të natyrshme të mënyrës se si i vlerësonte ai njerëzit. Ai u shërbente me dëshirë dishepujve të tij pasi ua njihte vlerat. Ne veprojmë krejt ndryshe. Në vend që t’u shërbejmë më të vegjëlve ne ushtrojmë autoritetin tonë mbi ta. Kjo ndodh pasi ne nuk i njohim vlerat e tyre dhe nuk i shohim njerëzit ashtu siç i shihnte Jezusi.

Ata që udhëheqin në mbretërinë e Perëndisë, duhet të mos harrojnë se çdo i krishterë ka marrëdhënie të veçantë dhe të drejtpërdrejtë me Krishtin, i cili është kreu i kishës. Ndryshe nga sistemet botërore, qëllimi i të cilëve është ushtrimi i kontrollit, drejtuesit në mbretërinë e Perëndisë kanë për detyrë të përsosin shenjtoret për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit për të arritur unitetin e besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, për të arritur në njeriun e përsosur, që nuk do të lëkundet nga vështirësitë që mund të hasë. (Shiko Efesianët 4:11-16)

Jezusi ruajti për udhëheqësit shpirtërorë të kohës mesazhin e tij më të fuqishëm. Ai ndjeu dhimbje të thellë për popullin që ishte si kopeja pa bari. Ai nuk i detyronte masat që t’i nënshtroheshin udhëheqësve të tyre, përkundrazi, ai ushtroi presion të vazhdueshëm mbi udhëheqësit, që ata të bëheshin skllëvër të masave.

### ***"Këtu jam përgjegjës unë"***

Shprehje të tilla dëgjojmë shpesh sot nga ata që janë në krye. Ata kërkojnë që ndjekësit e tyre, masat, të tregohen të ndershëm dhe të çiltër me ta, t’u binden, t’i mbështesin dhe t’u nënshtrohen. Megjithatë nëse ndjekësit janë të lirë për të qenë të ndershëm e të sinqertë me tanë të gjitha këto rrugë, e tërë përgjegjësia është e drejtuesit.

Së pari, këta udhëheqës, ashtu si Jezusi duhet të marrin nismën e shërbëtorit që t’u zbulojnë jetën e tyre të tjerëve. Për fat të keq, vetëm një numër shumë i vogël predikuesish dhe udhëheqësish fetarë njihen në thellësi prej njerëzve, të cilëve u shërbejnë. Për shkak të trainimit që kanë marrë dhe librave që kanë lexuar, shumë shërbyes mendojnë se duhet të mbajnë distancë profesionale me njerëzit dhe kështu e vënë veten mbi të tjerët.

Ky qëndrim ka pasoja tepër të dëmshme e shkatërrimtare. Ai që ndodhet në “majë” të piramidës së pushtetit papritur mund të gjendet jashtë realitetit. Vartësit e tij fillojnë të mos tregohen plotësisht të ndershëm. Ata nuk e njohin personin “në majë” me gjithçka ndodh, por i japin vetëm informacionin e domosdoshëm për të ruajtur vendin e punës. I vetmi mjet që mund t’i sigurojë drejtuesit ndershmërinë dhe besimin e vartësve të tij është të jetë i thjeshtë, të lerë mënjane pushtetin dhe autoritetin dhe të afrohet e shkrihet me ta si një shërbëtor. Ai që është në krye duhet të jetë i pari që do të ndërmarrë një veprim të tillë. Vartësit e tij s’mund të marrin një nismë të tillë, vetëm revolucioni nis nga poshtë. Natyra e Jezusit njeh si të mundshëm vetëm përruljen dhe nënshtrimin nga lart-poshtë në mbretërinë njerëzore.

Njëherë lexova një artikull që fliste për një njeri, i cili i ishte nënshtruar plotësisht eprorit të tij. Eprori, për t’ia bërë më të qartë vartësit të tij konceptin e të shërbyerit e urdhëroi t’i punonte kopshtin e shtëpisë. Ky është një shtrembërim i stilit të Jezusit. Për t’u mësuar të tjerëve parimin e të shërbyerit duhet që ti, i pari t’u shërbesh të tjerëve. Po t’i referoheshim rastit të mësipërm, do të thoshim që drejtuesi, i pari, duhej të punonte kopshtin e një tjetri për t’i dhënë shembullin e mirë vartësit të tij.

Kush udhëheq të tjerët sipas stilit të Jezusit nuk përdor forma të detyrimit apo pozitën institucionale për të fituar autoritetin e duhur. Ai mund të sigurojë besimin dhe mbështetjen e njerëzve vetëm duke u shërbyer atyre. Kështu ata binden për aftësinë e tij drejtuese dhe i bien pas vullnetarisht. Dhe, pa dyshim ithtarët e tij shumë shpejt do të reflektojnë karakterin e udhëheqësit të tyre.

Më kujtohet se si, një herë, një udhëheqës fetar, që qe akuzuar për shpërdorim të pozitës dhe përfitime personale u përpoq ta mbronte veten duke u thënë pasuesve të tij se s’kish bërë asgjë më tepër nga çdo të kishin bërë ata vetë po të kishin patur mundësinë. Me fjalë të tjera ai po u thoshte se, po të kishin qenë në vendin e tij, do të kishin vepruar si ai. Fjalët e tij qenë një akuzë tepër e rëndë kundër sistemit dhe përgatitjes etike që bëhej në atë institucion.

Ndoshta, mënyra më e mirë për të mos u kompromentuar nga përfitimet që sjell pozita do të ishte vendosja e fjalës *Skllav* mbi dyert e zyrave tona komode dhe spastrimi i tyre nga gjithë ato orendi të tepërta, që nuk i shkojnë për shtat këtij emërtimi. Mos harroni



që pushteti të korrupton, madje pushteti absolut të korrupton plotësisht.

Skillavi s' duhet të ketë titull që ta ngrejë mbi nivelin e tij, ose për të qenë më të saktë, ai s' duhet të ketë titull që ta ngrejë më lart se të tjerët. Ai s' duhet të ketë grada apo tituj, por vetëm shenjat dhe vrugat e punës së rëndë. Nuk mund të mendohet që skillavi të ketë vend parkimi më të madh se sa i zoti. Ai s' duhet të ketë as zyrë më të madhe dhe të mobiluar më mirë se të tjerët. Ai s' duhet të veshë rroba që mund të ngjallin lakmi apo të tërheqin vëmendjen e të tjerëve. Skillavi s' duhet ta përdorë pozitën e tij për të penguar daljen në pah të aftësive të të zotit. Ai s' duhet ta përdorë "pushtetin" e tij për të ruajtur pozitën e "më të madhit".

Natyrë e Jezusit i kundërshton haptazi në shumë drejtime modelet e qeverisjes që përdorin sistemet botërore dhe që padyshim janë përqaftuar nga kishat. Është me të vërtetë për të ardhur keq që fjalët e një doktrine kanë forcë shumë më të madhe se sa shembulli konkret. Ne jemi treguar shumë të matur në identifikimin e herezisë doktrinare, ndoshta ka ardhur koha që të identifikojmë herezinë në praktikën e përditshme.

Për të mbrojtur modelet botërore të qeverisjes, shpesh dëgjojmë njerëz që thonë se: "Populli është si një kope dhensh që kanë nevojë për nxitje dhe drejtim." Vetëm po të mohojmë kishën dhe të pranojmë se s' jemi ithtarë të Jezusit ne mund t' i nxisim me çdo mënyrë njerëzit të na binden. Në të kundërtën, po qe se duam të jemi ndjekës të Jezusit, ne duhet t' i duam njerëzit dhe çdo veprim i tyre duhet të jetë një përgjigje e vullnetshme kundrejt dashurisë, edhe sikur rezultatet e kësaj të mos jenë aq të menjëhershme dhe efektive siç mund t' i parashikojnë disa ekspertë. Nuk mund ta përfundojmë me sistemet e normat botërore atë që Jezusi e filloi përmes Frymës së Shenjtë.

Ç' do të ndodhte sikur të silleshim me njëri-tjetrin sipas shembullit të Jezusit dhe sikur udhëheqësit tanë të jepnin të parët shembullin personal? Kjo do të ishte një mrekulli. Deri tani kemi vepruar sipas udhëzimeve që na janë dhënë, me siguri tashmë do të na thuhën gjëra krejt të ndryshme. Sikur të ndodhte kështu, bota do të sulmonte dyert e kishave tona për t' u bërë anëtarë të tyre.

## Dy anët e medaljes

Ndoshta vendi i parë dhe më i përshtatshëm për ta përmbysur piramidën e pushtetit do të ishte familja. Ky institucion i parë i botës ka kaluar çaste të vështira. Disa nga mësimet e sistemeve të ndryshme fetare kanë krijuar të çara në zhvillimin e institucionit martesor. Për të kuptuar më mirë se në ç'mënyrë dramatike mund të ndikojë tek martesë natyra e Jezusit, le të analizojmë fillimisht disa nga mësimet aktuale.

“Burri qëndron gjithmonë në krye të vargut të urdhërimeve.” Të gjitha gratë janë një shkallë më poshtë. Ato nuk kanë të drejtë të hyjnë tek Perëndia pa lejen e burrit. Kjo gjë theksohet veçanërisht në mësimet mbi lidhjet martesore. Këto mësim mbështeten kryesisht tek Letra e Efesianëve, ku Pali thekson se gratë duhet t’u nënshtrohen burrave të tyre, ashtu siç u nënshtrohen Zotit.

Konceptin e nënshtimit në jetën bashkëshortore, në librat për gra, shkrimtarët kanë prirje ta trajtojnë në dobi të tyre. Përmes këtyre librave, gratë mësojnë se si t’i bindin burrat t’u nënshtrohen vullnetit të tyre, duke përdorur forcën e seksit dhe konceptin e mprehtë, të quajtur nënshtim. Nuk është aspak e moralshme, por në fund të fundit, gratë fitojnë. Kështu, burrat përpiqen të luajnë rolin e Perëndisë, rol ky tepër i vështirë për ta, ndërsa gratë detyrohen të pranojnë rolin e vartësit, gjë që nuk u pëlqen aspak. Nënshtimi i sforcuar rrjedh nga moskuptimi i natyrës së Jezusit.

Le t’i bëjmë një analizë të thellë paragrafit tek Efesianët, duke e filluar jo nga fundi, siç bëjnë disa, por nga fillimi:

Nënshtrojuni njëri-tjetrit në druajtjen e Krishtit. Ju, gratë, nënshtrojuni burrave tuaj porsì Zotit, sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, dhe ai vetë është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i është nënshtuar Krishtit, kështu gratë duhet t’u nënshtrohen burrave të tyre në çdo gjë.

Ju, burra, t’i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të... (Ef. 5:21-25)

Pra, urdhëresa e parë që na jep Jezusi është t’i përulemi njëri-tjetrit. Vetëm kështu mund të funksionojë trupi. Urdhëresat e tjera

plotësojnë më mirë urdhëresën e parë. Përmes këtyre urdhëresave mësojmë se si ndikon në marrëdhëniet bashkëshortore përlësia dhe nënshtrimi. Gratë duhet t'u nënshtrohen burrave ashtu si Zotit, dhe burrat duhet t'i duan gratë e tyre sikurse Krishti ka dashur kishën.

Pozita e gruas për një kohë të gjatë ka qenë mjaft e qartë. Po si mund ta përshkruajmë burrin, të cilit ajo i nënshtrohet? Po Krishti, si e deshi kishën e tij? Ai hyri në kishë si një skllav; nuk sundoi mbi të, por u bë shembull i përlësisë dhe nënshtrimit. Ai u shfaq si një fëmijë, si më i vogli dhe më i parëndësishmi, nuk përdori as forcën, as famën e tij, i vendosur gjer në vdekje për të mos e ndryshuar natyrën e tij. Sa herë që sillem me gruan time në këtë mënyrë, ajo me dëshirë tregohet e përlur. Por, përlësia e humb kuptimin e saj kur kthehet në një detyrim. Dhe mos harroni se udhëheqësi ose kreu duhet të ndërmarrë i pari rolin e skllavit.

Vetëm me nënshtrim reciprok, bashkëshortët do të arrijnë të zgjidhin problemet e tyre, pa lënduar njëri-tjetrin. Gjithashtu, rruga më e drejtë për të zgjidhur mosmarrëveshjet është sinqeriteti dhe ndershmëria.

Është e rëndësishme të theksojmë se sipas kriterit të ri të përcaktuar nga Perëndia, para se të jemi pjesëtarë të familjes tokësore, jemi bij dhe bija të familjes së madhe të Tij. Gruaja ime, së pari është motra ime në Krisht dhe pastaj bashkëshortja ime, prandaj duhet ta trajtoj si fëmijën e Perëndisë, dhe bile me kujdes më të madh nga ç' do të doja të më trajtonin bijtë e mi. Në familjen e Perëndisë të gjithë jemi të barabartë, dhe as që duhet të guxoj të tregohem superior apo të mundohem të manipuloj ndonjë nga bijtë e Tij.

### ***"Të vrasësh me pambuk"***

Si mund t'u shërbejmë fëmijëve tanë dhe njëkohësisht të mos i llastojmë ata? Aktualisht, të shërbyerit është garancia më e mirë për edukimin e tyre të shëndoshë shpirtëror. Vetëm kur të kuptojmë se fëmijët tanë janë së pari bij të Perëndisë, do të bindemi që po i rritim dhe po i përgatitim për t'i vënë në shërbim të Perëndisë. Përrjedhojë, ne do tregohemi të gatshëm t'i stërvitim dhe t'i disiplinojmë, duke u shërbyer, me qëllim që të ngulitim tek ata Frymën e Atit.

Duke u shërbyer fëmijëve tanë, jemi më pranë tyre, njohim dhe plotësojmë kërkesat që kanë, e kemi më të lehtë të zbulojmë prirjet e tyre për t'u larguar nga natyra e Atit dhe t'i korrigjojmë ata. Të shërbyerit na ndihmon të marrim vendime në të mirën e fëmijëve tanë dhe t'u përmbahemi atyre me vendosmëri. Të shërbyerit na ndihmon të themi “jo” kur kjo është për të mirën e tyre. Të njëjtën gjë thekson edhe Pali në fjalët me të cilat u drejtohet prindërve: “Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Efesianët 6:4). Ecja në rrugën e Jezusit nuk do t'i mërzisë fëmijët, por do t'i bëjë të ndihen gjithnjë të rrethuar me dashuri.

T'u shërbesh fëmijëve do të thotë t'i përgatitësh ata për një rini të pavarur dhe më pas t'i drejtosh drejt Atit në Qiell. Kjo s'është as shtrëngim as lirim, por është rruga më e drejtë për ta. Është nder i madh kur Perëndia të ngarkon detyrën fisnike që t'u shërbesh bijve të Tij. Pavarësisht nga rrethanat, Perëndia e vlerëson kujdesin, shërbimin dhe dashurinë prindërore.

Kur isha gjashtë vjeç, babai u plagos rëndë në një aksident ajror, dhe që nga ajo kohë mbeti pjesërisht i paralizuar dhe me të meta mendore. Atëherë, nënës iu desh të punonte për të mbajtur familjen.

Meqenëse nëna shpesh nuk ishte në shtëpi ngaqë punonte shumë dhe meqë babai fizikisht dhe mendërisht “nuk ishte aty” familja ishte e dënuar të dështonte. Por ja që nuk ndodhi kështu! Përkundrazi, në këto kohë shumë të vështira, prindërit tanë s'e humbën besimin tek Zoti, ata i qëndruan besnikë Atij dhe neve. Në ato ditë të vështira, edhe pse pa para ose shtëpi të bukur, ne ishim të rrethuar me dashuri, me lutje e besim të patundur tek Zoti.

Në ceremoninë e varrimit të babait, dy vëllezërit e mi dhe unë qëndruam para arkivolit dhe iu drejtuam me këto fjalë miqve që kishin ardhur për t'i dhënë lamtumirën: “Babai ynë s'na la pasuri. Ai s'arriti të bënte dhe të na mësonte shumë gjëra që normalisht fëmijët i mësojnë nga baballarët e tyre. Por ai na la gjënë më të çmuar që kishte, dashurinë për Perëndinë dhe për Biblën. Ai na la dashurinë për njerëzit dhe na mësoi se si të lavdërojmë e të adhurojmë Perëndinë, ai na mësoi të mos urrejmë. Ne i jemi tepër mirënjohës për këtë pasuri të çmuar dhe të pavdekshme që na la

trashëgim. Prandaj ne sot, para varrit të tij zotohemi para të gjithëve se do të ndjekim rrugën e Perëndisë së tij.”

Ata prindër - shërbyes që e vlerësojnë së tepërmi rolin e Perëndisë në familjen e tyre e quajnë privilegj dhe përgjegjësi të madhe edukimin e fëmijëve të Perëndisë, që janë kopshti i jetës. Ndaj, fëmijët e tyre rriten më të mbrojtur, më të fortë shpirtërisht dhe me një personalitet më të shëndoshë. Fakti që Jezusi u rrit mes njerëzve të ligj provon se të shërbyerit s’është cilësi që formohet vetëm në një familje ideale apo situata të caktuara. Të vihesh në shërbim të të tjerëve nuk do të thotë të jesh i pasur, por vetëm të tregohesh i bindur ndaj natyrës shërbyese të Jezusit.

## Do Doja të Shihja një Shërbesë

*Ju dhashë i pari shembullin tim që ju  
të bëni për të tjerët atë që bëra unë për ju*

Njëherë gruas dhe fëmijëve të mi iu desh të përballonin me guxim një udhëtim të gjatë prej 650 km për të mbërritur në një kamp, ku unë kisha shkuar për të predikuar. Gjatë udhëtimit, ata kaluan përmes një qyteti të madh, rrugët e të cilit ishin mjaft të ngatërruara. Ata u përpoqën dy orë të tëra për të gjetur rrugën, por më kot. U ndalën disa herë për të pyetur policët rrugorë apo njerëz të tjerë që e njihnin vendin, por çdo përpjekje për të gjetur drejtimin dështonte.

Më në fund, të dëshpëruar jashtë mase, ata u ndalën në një stacion shërbimi me shpresën se mund të merrnin të dhëna të sakta. Por për çdo drejtim që u tregonin, familja ime përgjigjej: “ E kemi provuar, nuk ishte rruga e duhur.” Papritur, një burrë që ndodhej aty rastësisht dhe që e kishte dëgjuar bisedën ndërhyri dhe tha: “Kjo makina e kuqe është e imja. Ju, me makinën tuaj ecni pas meje dhe unë do t’ju prij rrugën.”

Kështu, ai i udhëhoqi përmes asaj xhungle të pafundme rrugësh, duke i drejtuar nëpër kryqëzimet e vështira, derisa u gjendën disa

km larg qytetit. Kur dolën në autostradë ai e ndali makinën dhe u tha: “Tani, s’do ta keni më të vështirë, vazhdoni të ndiqni këtë rrugë dhe s’do të humbisni.” Për familjen time ai njeri qe si Jezusi. S’e di nëse ai ishte apo jo ndjekës i Jezusit, por mund të them se ai e njihnte më mirë se shumë të krishterë të tjerë parimin e të udhëhequrit, për të cilin flet Jezusi.

Forma më frytdhënëse e udhëheqjes së krishterë është të udhëheqësh duke dhënë shembullin personal. Jezusi nuk ka thënë: “Bëj si them unë, po mos bëj si bëj unë.” Kjo shpjgohet qartë tek Mateu:

“Atëherë Jezusi u foli turmave dhe dishepujve të vet, duke thënë: "Skribët dhe farisenjtë ulen mbi katedrën e Moisiut. Zbatoni, pra, dhe bëni gjithçka t’ju thonë të zbatoni; por mos bëni si bëjnë ata, sepse thonë, por nuk e bëjnë. Por lidhin barrë të rënda që mbarthen me vështirësi, dhe ua vënë mbi kurriz njerëzve; Por ata nuk duan të luajnë vetë as gishtin.

“Por të gjitha veprat e tyre i bëjnë për t’u dukur nga njerëzit; i zgjerojnë filateritë e tyre dhe i zgjatin thekët e rrobave të tyre. Duan kryet e vendit në gostira dhe vendet e para në sinagoga, si edhe përshëndetjet në sheshe dhe të quhen rabbi, rabbi nga njerëzit.

“Por ju mos lejoni që t’ju quajnë rabbi, sepse vetëm një është mësuesi juaj: Krishti, dhe ju të gjithë jeni vëllezër. Dhe përmbi tokë mos thirrni askënd atë tuaj, sepse vetëm një është Ati juaj, ai që është në qiej. As mos lejoni që t’ju quajnë udhëheqës, sepse vetëm një është udhëheqësi juaj: Krishti. Dhe më i madhi prej jush le të jetë shërbëtori juaj.” (Mateu 23:1-11)

Në ushtrinë e Perëndisë, gjeneralët nuk zenë vendet e sigurta të prapavijës. Jo, vendi i tyre është në ballë të trupave luftuese, duke dalë të parët, ata japin shembullin se si fitohet beteja.

Një herë po bisedoja me një student teologjie. Nuk u besova veshëve të mi kur ai nisi të ankohej se kolegji i tij nuk kishte një fjetore të veçantë për njerëzit e “sërës së tij”, që ata të mos shqetësoheshin e të mos prisheshin nga të tjerët, që nuk ishin të interesuar për “shërbimin”.

Epoka jonë ashtu si ajo e Jezusit bën çmos për t'i ruajtur besimtarët nga ndikimi i mëkatarëve. Fenomeni i izolimit të të krishterëve nga bota sot po shfaqet kudo. E vërteta, në vend që të dalë në shesh e t'u bëjë dritë të gjithëve është fshehur nën bankat e kishave. Mëkatarët zvarriten të pashpresë para vdekjes që i kërcënon, ndërsa ne, u rrimë larg dhe vetëm i këshillojmë që të mos dorëzohen.

Por Jezusi qe Emanueli - Perëndia me ne - dhe ai na këshillon ta ndjekim pas. Ai nuk ushtroi forcë mbi dishepujt e tij. Kurrë nuk u kërkoi atyre të bënin gjëra që s'i kishte bërë ai vetë më parë, apo të cilat nuk ua kish mësuar. Nëse i duam njerëzit me të vërtetë ashtu si Jezusi, ne duhet t'u qëndrojmë pranë dhe t'u tregojmë se sa i duam, dhe përmes veprimeve tona të bëjmë që ata ta shohin qartë këtë lloj dashurie.

### ***Të mësuarit pa korniza***

Gjatë periudhës që jepja mësim në një shkollë të Krishterë vura re se mësimet dhe pyetjet mjaft të goditura mbi lutjen, që u jepja studentëve në provime, nuk i mësonin ata si të luteshin. Kjo metodë u mësonte më tepër si të mbanin shënime të sakta dhe si t'i përgjigjeshin mekanikisht pyetjeve të provimeve. Vetëm ata studentë, të cilët luteshin bashkë me mua mësonin si të luteshin.

Drejtori i një seminari të njohur deklaroi hapur se seminari i tij nuk përgatiste pastorë, por mësues seminaresh, pasi ky ishte shembulli i vetëm në klasë. Jezusi zgjodhi shembullin dhe jo klasën si metodën më të frytshme të mësimdhënies. Të përvetësosh një pikëpamje, një koncept apo zanat pa e parë më parë si zbatohet është tepër e vështirë. Me mirënjohje kujtoj shoferin që më mësoi të ngas makinën. Kurrë s'kam për t'i harruar ato duar të dashura që më mësuan të lidh lidhëset e këpucëve.

Sikur shprehja e rëndomtë “ kush është i zoti le të punojë, ai që s'është i zoti të punojë, le të mësojë të tjerët” të ishte e vërtetë, mësimi s'do të ekzistonte fare, sepse veprimet i paraprijnë mësimi. Gjithashtu, ai që ndërmerri i pari kryerjen e një veprimtarie të re e të panjohur, shumë lehtë mund të dështojë e të mbetet i fundit. Kur nxënësit vihen para një provë të re në klasë, ata tregohen të ndrojtur dhe nuk marrin guximin të dalin të parët. Atëherë mësuesi vendos



ta marrë përsipër këtë rol të vështirë, duke vënë veten në shërbim të nxënësve. Kështu ai vihet pak a shumë në rolin e gjellëprovuesit të mbretit.

Edukimi është procesi i përvetësimit të dijeve dhe vlerave, ai është procesi i formimit të edukatës dhe sjelljes. Për të krishterët, ky ka një kuptim më të gjerë, ngaqë përfshin edhe trashëgiminë e përvojës jetësore. Vetëm jeta lind jetën.

Për vite me radhë, kisha ka huazuar metodat edukuese që përdor bota në vend që t'i nxjerrë ato nga mësimet e Jezusit, u cili tha: "Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, madje çdo dishepull që ka mësuar do të jetë si mësuesi i vet." (Luka 6:40). Ne i mbyllim nxënësit brenda katër mureve të klasave, duke i shkëputur nga jeta. Jezusi veproi krejt ndryshe, ai i çoi dishepujt aty ku jeta vlonte. Ne e kufizuar edukimin në një a dy orë, ndërsa Jezusi merrej gjatë gjithë kohës me edukimin e nxënësve të tij. Ne mbështetëm idenë e formimit të klasave me shumë nxënës, ndërsa Jezusi mbante pranë vetëm 12 nxënës. Mësuesit tanë janë të rezervuar me nxënësit dhe diskutojnë haptazi vetëm për gjërat që kanë lidhje me mësimin, ndërsa Jezusi u fliste hapur nxënësve për jetën e tij. Sot, ne i plasim fëmijët tanë në shkolla, duke ia besuar edukimin e tyre njerëzve të panjohur, ndërsa Bibla përgjegjësinë kryesore për edukimin e fëmijëve ia ngarkon prindërve.

Në qoftë se ju vetë jeni një mësues, që luftoni kundër kufizimeve dhe doni të dilni jashtë mureve të klasës, parimet e mëposhtme do ishin shembuj inkurajues për ju.

Edukimi sipas metodës së Jezusit kërkon mësues që ecin krahpërkrah me nxënësit, duke i njohur ata me jetën dhe përpjekjet e tyre, mësues që ndjekin cilësitë e të shërbyerit që karakterizojnë Jezusin. Edukimi sipas metodës së Jezusit nënkupton që në qendër të vëmendjes të jenë nxënësit, veprimet e tyre, dhe jo mësuesit e kujdestarët.

Edukimi sipas metodës së Jezusit synon t'i përgatisë nxënësit që të bëhen, së pari, pjesëtarë të mbretërisë së Perëndisë, dhe jo qytetarë të Shteteve të Bashkuara apo të ndonjë vendi tjetër. Për këtë, mësuesit dhe punonjësit e tjerë, në strukturat që kanë zgjedhur modelojnë mbretërinë e Perëndisë.

Edukimi sipas stilit të Jezusit përgatit familjen si forcën kryesore për edukimin shpirtëror të fëmijëve. Edukimi sipas metodës së

Jezusit bën të qartë dallimin midis ligjit të dashurisë në mbretërinë e Perëndisë dhe ndikimit të kulturës dhe traditës, dhe na mëson se këta të fundit nuk na çojnë drejt mbretërisë së qiellit.

Edukimi sipas stilit të Jezusit e kufizon numrin e nxënësve për çdo mësues me qëllim që ky të krijojë lidhje të ngushta e t'i dojë ata me gjithë shpirt. Ai nuk përdor mjete vlerësimi që mund t'u ngjallin nxënësve mosbesim në veten e tyre.

Edukimi sipas stilit të Jezusit ndërton sisteme disiplinore që burojnë dhe mbështeten në marrëdhëniet e ngushta me edukatorët.

Edukimi sipas stilit të Jezusit i inkurajon nxënësit t'i përdorin të gjitha dhuntitë që u ka dhënë Perëndia, pa asnjë kufizim, pa u imponuar modele të gatshme.

Edukimi sipas stilit të Jezusit synon t'i pajisë nxënësit me dije të qëndrueshme për gjithë jetën. Ai u shërben më tepër nxënësve, sesa metodave apo programeve që mbështesin sisteme të ndryshme arsimore.

Edukimi sipas stilit të Jezusit njeh si qëllim kryesor në jetë dashurinë dhe jo dijet. Ai tregon se dhënia dhe përvetësimi si duhet i mësimëve të Perëndisë formon njerëz që ecin në rrugën e drejtë të Jezusit, që i duan të tjerët siç i deshi ai, që jetojnë si jetoj ai.

# As më Shumë, as më Pak

*Kushdo që përulet si ky fëmijë, do të jetë  
më i madhi në mbretërinë e Perëndisë*

Për një kohë të gjatë kam paur një koncept të gabuar mbi përulësinë. Duke e konsideruar përulësinë si një kompleks inferioriteti, nisa t’i vesh vetes një pamje thellësisht të mjerueshme dhe e zhvleftësova veten plotësisht. Fillova të mos këndoja, të mos predikoja, të mos luaja më në piano apo vegla të tjera muzikore, madje e kisha vështirë edhe të ecja. Njerëzit e vunë re këtë dhe siç shpresoja unë nisën të më thonin: “Oh, sa i thjeshtë dhe modest që je!” Dhe, unë me “modestinë” time i falënderoja që kjo cilësi e imja u kishte rënë në sy.

Sot, e kuptoj që qëndrimi im nuk ishte përulësi, por sëmundje. Përulësia nuk është një modesti e shtirur. Përulësia na ndihmon të jemi realistë, të mos e mbivlerësojmë as ta nënvleftësojmë veten. Kjo do të thotë të jemi të ndershëm dhe të sinqertë me vetveten. Duke e njohur dhe pranuar veten siç jemi, do dimë të zotërojmë më mirë emocionet tona. Përulësia na ndihmon të jetojmë pa hipokrizi.

Bibla shkruan se në shkretëtirë, Moisiu befasi u ndesh me Perëndinë përmes një shkurreje që po digjej. Pasi pranoi të kthehej në Egjipt për ta udhëhequr popullin e Izraelit jashtë Egjiptit, për t'iu siguruar se askush s'po tallej me të, i kërkoi zërit të panjohur t'iu thoshte emrin. Cilën shoqëri të biznesit përfaqëson? Dhe Perëndia iu përgjegy: “Unë jam ai që jam.” Është e vërtetë që Perëndia nuk është kontradiktor. Zoti është ai që është. Jezusi vetë tha: “Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta” dhe “Unë kam ekzistuar edhe para Abrahamit.” Përlësia është të jesh një “Unë jam.”

Një nga gjërat që do ta bëja me gjithë qejf për të tjerët është të tregohem i sinqertë (i përlur), që atyre të mos u duhet të shqyrtojnë çdo veprim timin për të zbuluar të vërtetën. S'ma do mendja se çdo mëngjez që Jezusi përshëndeste nxënësit e tij, ata duhej të vrisnin mendjen që të gjenin kuptimin e vërtetë të fjalëve të tij. Të qenit i tij i njëjtë “dje, sot e përjetë” s'do të thotë se i mungonin emocionet dhe humori, kjo do të thotë se ai ishte gjithmonë i sinqertë dhe i çiltër me ta, ndaj me plot gojën mund të thoshte “Unë jam”.

Jezusit i pëlqente që njerëzit ta njihnin nga afër:

Ata i thanë: “Rabbi, ku banon?”

Ai iu përgjigj atyre: “Ejani e shikoni” (Gjoni 1:38-39)

Përmes këtyre dy rreshtave zbulojmë se e vërteta mbi Jezusin nuk ishte rrjedhojë e hetimeve e anketave, por e sinqeritetit dhe ndershmërisë që e udhëhiqnin atë. Ai hapej me dëshirën e vet. Ai nuk udhëhiqej nga parimi se “ajo që nuk e dinë, nuk do t'i lëndoje”.

Jezusi deshi të ishte gjithmonë me nxënësit e tij, që marrëdhëniet e tyre të ngriheshin mbi bazën e sinqeritetit. Duke qëndruar “së bashku”, ne jemi në gjendje të shohim, pas fasadës së lustruar të shoqërisë, realitetin e jetës së përditshme. Para se të martoheshim, unë dhe gruaja ime kur takoheshim, i kushtonim tepër kujdes pamjes së jashtme: visheshim mirë, kriheshim me kujdes e parfumoseshim. Por vetëm kur filluam të jetojmë sëbashku, gruaja ime njohu natyrën time të vërtetë, veprimet e mia të pagdhendura dhe motivet që më nxisnin. Vetëm koha dhe qëndrimi pranë njerëzve nxjerrin në shesh të vërtetën.

Jezusi ishte besnik në zbulimin e vetes së tij plotësisht ndaj nxënësve të tij. Para se të ndahej me ta, ai u tha këto fjalë: “Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk e di ç’bën i zoti; por unë ju kam quajtur miq, sepse ju bëra të njihni të gjitha gjërat që kam dëgjuar nga Ati im.” (Gjoni 15:15). Miqësia kërkon zbulimin e vetes.

Mësimet e Jezusit mbi rëndësinë e sinqeritetit dhe zbulimit të njëritjetrit i dëgjuan turma të mëdha njerëzish, por, me nxënësit e tij ai ruajti një lidhje krejt të veçantë e tepër të ngushtë. Në qendër të vëmendjes Jezusi kishte mësimet për Atin në Qiell, prandaj shumë shpesh u fliste për këtë grupeve të mëdha të njerëzve. Por paraqitjen më të plotë të Atit, ai e bënte në grupe më të ngushta ku e dinte se fjalët e tij nuk binin në vesh të shurdhët. Ai, me të drejtë, nuk plotësonte dëshirën e kureshtarëve, por të atyre që me të vërtetë donin shpëtimin.

Është tipar i shoqërisë sonë (si kishtarë, ashtu edhe ateiste), që sa më me pozitë të jesh, aq më shumë distancohesh nga njerëzit - aq më tepër e fsheh jetën tënde private. Ndërsa me Jezusin ndodhi krejt e kundërta. Sa më shumë që depërtonte ai në shërbesën e tij mesianike, aq më thellë depërtonin miqtë e tij në jetën dhe emocionet e tij të brendshme.

## ***Në dritë të diellit***

Ngaqë nuk jemi mësuar të jetojmë hapur, këto fjalë të Shkrimit të Shenjtë na duken tepër kërcënuese:

“Para së gjithash ruhuni nga majaja e farisenjve, që është hipokrizia. Nuk ka asgjë të mbuluar që nuk do të zbulohet, as të fshehtë që nuk do të njihet. Prandaj të gjitha ato që thatë në terr do të dëgjohen në dritë; dhe ato që pëshpëritet në vesh ndër dhomat e brendshme, do të shpallen nga çatitë e shtëpive”. (Luka 12:1-3)

Përlësia, me fjalë të tjera mund të quhet “ecje në dritë”. Përlësia zgjedh të jetë realiste, e hapur dhe e sinqertë, pa fshehur asgjë. Kjo do të ishte mënyra më e mirë për t’u afruar me njerëzit. Shkallëzimi

në Letrën e parë të Gjonit 1:7 është shumë logjik: “Por, po të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë, kemi bashkësi njëri me tjetrin, dhe gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat.”

Qëndrimet dhe vlerat tona shumë rrallë rrjedhin nga parimet jetike të Biblës, prandaj tek ne nuk vepron ajo forcë që buron nga të jetuarit në dritë. Ne na frikëson zbulimi i saj. Ne u druhemi shumë ndryshimeve që duhet të bëjmë.

Ne s’kemi përsë të turpërohemi nga të metat që të tjerët venë re tek ne. Këto të meta dëshmojnë se bëjmë pjesë në racën njerëzore. Përkundrazi, ne duhet të gëzohemi për faktin që na janë falur gabimet e të metat dhe ne po rritemi shpirtërisht.

Të gjithë jemi mëkatarë dhe s’jam i sigurt nëse disa njerëz mund të quhen më tepër mëkatarë se të tjerët. Ndryshimi i vetëm është se disa mëkate shpesh janë më të dukshme se disa të tjera. Sado të mundohem të maskohem në sipërfaqe, thellë “në zemrën time vuaj mëkatin dhe poshtërsinë”. Jezusi thoshte se atyre që u janë falur më shumë mëkate, kanë dashuri më të madhe. Kjo do të thotë që ata që janë penduar plotësisht si për mëkakat e padukshme, ashtu dhe për mëkakat e dukshme janë më të çiltër e më të hapur. Ata provojnë shpengimin e plotë të Perëndisë, që më pas i mbush me forca dhe energji për t’i dashur të tjerët. Farisenjtë, të cilët dukeshin të kulluar nga jashtë, nuk ishin penduar për mëkakat e ndërgjegjes, prandaj u mungonte edhe aftësia për të dashur.

### *Çmimi i mossinqeritetit*

Sipas psikologëve të ndryshëm çdo e fshehtë, qoftë e mirë apo e keqe shkakton brenda nesh të njëjtën ndjenjë faji që shkakton vetë mëkati. Çdo emocion të fortë që provojmë, qoftë ky edhe pozitiv, kur e mbajmë të fshehur brenda vetes ndikon tepër negativisht tek ne dhe në mjedisin që na rrethon.

Vetë natyra jonë njerëzore nuk është projektuar që ne t’i fshihemi vetvetes. Përpjekjet për të fshehur veten tonë, që u shfaqën në kohën e rënies së njerëzimit, sot janë tipike të mënyrës së jetesës në tokë. Përpjekjet për të fshehur të vërtetën mbi jetën tonë na kushtojnë

shumë shtrenjt. Çdo e fshehtë na detyron të jetojmë në një mënyrë të tillë, që e fshehta të mos dalë në dritë. Me fjalë të tjera fillojmë të pushtohemi nga falsiteti, i fshihemi vetvetes dhe bëhemi kontradiktorë. Ky falsitet bie ndesh me natyrën e Jezusit, i cili është Perëndia i vërtetësisë. Ai nuk u përpoq ta fshihte jetën e tij prapa një maske. Tek ai s'kishte vend për errësirën.

Deklarata e dhimbshme e Gjonit "Jezusi qau" dëshmon se Jezusi i shprehte haptazi emocionet e tij edhe para njerëzve. As zemërimin nuk e fshihte kurrë. Ndjenjat e tij, dhembshuria, gëzimi, hidhërimi dukeshin sheshit, ndaj kronistët e ungjijve e patën të lehtë ta vinin re këtë dhe ta kujtonin në shkrimet e tyre.

Vetëm po të jemi të përulur dhe të singertë do të mund të përballojmë si duhet emocionet e forta. Bibla na mëson se mund të zemërohemi, por zemërimi s' duhet të zgjasë shumë dhe s' duhet të na shtyjë në mëkat. Ne e shtrembërojmë këtë mësim duke e interpretuar sikur s' duhet të lëmë as buzët të na dridhen nga zemërimi, sikur duhet të shtrëngojmë dhëmbët e ta mbajmë përbrenda gjithë pezmatimin.

Reagimi i kundërt që shfaqet në përgjithësi kur mundohemi ta ndrydhim zemërimin për një kohë të gjatë është hakmarrja apo përdorimi i dhunës tinëz. Por duhet ta dimë se, as dhuna, as kryelartësia s' na ndihmojnë ta mposhtim zemërimin. Vetëm përulësia na aftëson t'i zotërojmë e t'i pranojmë ndjenjat tona. Vetëm kështu do të mund të them lirshëm: "Jam i zemëruar", kur dua të shpjegoj veprimet e mia. Jam i lirë të pyes nëse dikush do me të vërtetë të më zemërojë, që të kërkoj ndihmën e të tjerëve për të ndryshuar sjellje, në qoftë se jam duke vepruar gabim.

Aftësia për të shprehur haptazi ndjenjat tona, nëpërmjet përulësisë shpesh shtrihet edhe në marrëdhënien tonë me Perëndinë. Kur ndodhin fatkeqësi natyrore, të mërziutur e të zemëruar, ne me marifet i përcaktojmë ato si "vepra të Perëndisë". Kur shprehim ndjenjat tona, mos vallë është më me rrezik që t'ia shprehim zemërimin tonë Perëndisë? A mendoni se Perëndia mund të gënjëhet nga lajkat dhe dredhitë tona?

Meqë shumica e lutjeve tona sot janë ankesa për mënyrën se si Perëndia po e udhëheq botën, mos ndoshta ndjenjat tona të pastra që kemi për Perëndinë apo zhgënjimet që përjetojmë në marrëdhënien me Të do të ishin jshtë rregullave? Bukuria e

marrëdhënieve intime është se ato, jo vetëm arrijnë t'u bëjnë ballë situatave emocionale, por edhe i shfrytëzojnë ato për pasurimin e forcimin e tyre. Mos ndoshta marrëdhëniet tona me Atin janë aq të brishta, saqë të mos guxojmë t'i themi Atij hapur gjithçka ndiejmë? Apo mos i druhami hakmarrjes prej krijuesit të mëshirës? Vetë, Jezusi, para vdekjes në kryq, thellësisht i dëshpëruar thirri: "O Atë, pse më braktise?"

Është për t'u habitur që nën ndikimin e kulturave të ndryshme jemi mësuar t'i fshehim ndjenjat tona. Fatkeqësisht, disa të krishterëve u është thënë se duhet të buzëqeshin, edhe sikur të jenë në kulmin e dëshpërimit. Madje, ata janë mësuar ta mohojnë plotësisht ekzistencën e dhimbjeve shpirtërore, sepse gjoja të krishterët duhet të jenë gjithnjë të gëzuar e buzagaz. Shpesh çifte të martuarish, që ndodhen në periudha vështirësish e mosmarrëveshjesh, gjatë rrugës për në kishë janë të vrenjtur dhe të heshtur me njëri-tjetrin, por, sapo afrohen te kisha mbulojnë fytyrat e tyre me maskën "e buzëqeshjes" dhe kur njerëzit i drejtohen me fjalët e zakonshme: "Si po ia çoni?", menjëherë kthejnë përgjigjen standarte: "Mirë, faleminderit!", të shoqëruar me një buzëqeshje të shtirur.

Në qoftë se ka një vend, ku duhet të vijmë për të rrefyer mëkatet tona, për të shprehur haptazi e pa ndrojtje ndjenjat tona, ku duhet të drejtohem për ndihmë dhe të gjejmë shërim, ky vend duhet të jetë kisha. Por është fatkeqësi që kisha gjithnjë e më tepër po kthehet në një vend, ku duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm për të fshehur ndjenjat tona të vërteta për të mos njollosur emrin e mirë që kemi.

Trupi i Krishtit, sidomos ai që përbëhet nga grupe të vogla, me lidhje të ngushta dhe funksionim të mirë, ka forcë shëruese jashtëzakonisht të madhe, edhe pse ne nuk e trajtojmë si të tillë. Kur shkojmë të vizitohemi tek mjeku ne nuk mund të tregohemi të rezervuar e të pasinqertë siç tregohemi shpesh me trupin shëruar të Krishtit. A do t'i thonit dot mjekut që ju viziton: "Unë kam një sëmundje që s'mund ta them."? Sigurisht që jo! Fatkeqësisht, një gjë e tillë ndodh shpesh brenda kishës. Ne duam t'i ndajmë shqetësimet tona me të tjerët, por nuk duam t'u tregojmë atyre se cilat janë këto shqetësime. A ka kuptim të shkojmë tek mjeku për t'u vizituar dhe t'ia fshehim atij dhimbjet që ndiejmë, ose t'i



tregojmë një vend tjetër dhe jo atë vend që na dhemb në të vërtetë? Sigurisht që jo! A mund të shkojmë te mjeku dhe t'i themi: "Kam ardhur të vizitohem në vend të shokut tim, më vizito mua dhe përcakto sëmundjen e tij"? Sigurisht që jo! Por kjo ndodh në kishë. Marrëdhëniet tona bazohen në frikën dhe mosbesimin. Ne parapëlqejmë të fshihemi, të mos tregohemi të hapur. Deri diku ne kemi pranuar që kisha të jetë më tepër vendi i njerëzve të përsosur, sesa i mëkatarëve të falur. Prirja e kishës për të ruajtur të papërlyer pamjen e jashtme dhe emrin e mirë e ka zhytur atë në një krizë mungese sinqeriteti dhe ndershmërie, ku e vërteta shtrembërohet ndër kohë që ne projektojmë që të gjithë të shohin një kopje të ideale. Ndërkohë, ne vazhdojmë të shpresojmë që e vërteta të mos dalë në shesh dhe fasada të jetë e pranueshme për opinionin. Në emër të Jezusit, ne vazhdojmë t'i fshehim mëkatet dhe të metat tona, duke dënuar të gjithë ata që do të guxonin të ngrinin zërin apo të na i vinin në dukje "gabimet" tona.

Ja si e karakterizon Valter Skoti përlulesinë: "Oh, ç'rrjetë të ngatërruar që thurim, kur përpiqemi të mashtrojmë!" Kur padashje i udhëzoi të tjerët gabim, dhe ata veprojnë sipas udhëzimeve të mia, ata për rrjedhojë do të përgjigjen gabim. Unë më pas reagoj negativisht kundrejt gabimeve të tyre, dhe kështu cikli përsëritet, derisa, më në fund plas lufta, dhe asnjëra palë nuk kujton se si nisi.

Në letrën drejtuar Filipianëve, Pali thekson rëndësinë e sinqeritetit në kishë: "Ato gjëra që keni mësuar, marrë dhe dëgjuar nga mua, i bëni..." (Filipianëve 4:9). Ndërsa Thesalonikasve u shkruante: "Kështu, duke patur një dashuri të madhe ndaj jush, ishim të kënaqur duke ju komunikuar jo vetëm ungjillin e Perëndisë, por edhe vetë jetën tonë, sepse na u bëtë të dashur." (1 Thesalonikasve 2:8).

Por më gjerë ai e shtjellon këtë koncept në letrën drejtuar Korintasve:

Dhe jo si Moisiu, i cili vinte një vel mbi fytyrën e vet, që bjitë e Izraelit të mos vështronin me sy fundin e asaj që duhej të anullohej... Sepse Zoti është Fryma, dhe atje ku është Fryma e Zotit, atje është liria. Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtin shëmbëllim nga lavdia në lavdi, porsì prej Frymës së Zotit. (2 Korintasve 3:13,17,18)

Gjithmonë i përdorja këto vargje duke theksuar lirinë që vjen nga Fryma e Shenjtë për të justifikuar disa nga aspektet më të çuditshme të jetës entuziaste të kishës. Tani e kuptoj se prania e Frymës së Shenjtë më ndihmon të heq maskën e hipokrizisë dhe të shfaqem hapur para njerëzve, jo se jam i përkryer, por sepse tek unë pasqyrohet lavdia e Zotit, sepse jam duke u shndërruar, jam në përmirësim dhe rritje të vazhdueshme.

Moisiu e mbuloi fytyrën e tij me vel për të fshehur dobësinë e tij. Ai e bëri këtë gjë me dëshirën e tij. Në pamje të parë ne na duket se ai s'kishte arsye ta bënte këtë gjë, por, sa herë që veprojmë në kundërshtim me ligjin, dobësia e karakterit njerëzor (sidomos përballë provave të mëdha shpirtërore) na shtyn të sillemi me hipokrizi, të fshihemi dhe të mbulohemi për të treguar vetëm anët tona më të mira.

Hiri është kaq i ndryshëm në përmbushjen e ligjit. Tek Gjoni (1:17) thuhet se me anë të Moisiut, Perëndia na dha ligjin, por me anë të Jezusit, Mesisë, na dha hirin dhe të vërtetën. Ligji kërkon drejtësi - përmes hirit bëhemi të tillë. Atë që kërkon ligji, na e siguron hiri. Ligji është shtypje - hiri është lehtësim. Ligji është zgjedhë, ndërsa hiri është liri. Hiri dhe e vërteta mund të veprojnë vetëm në dritë, në sy të të gjithëve. Natyra e vërtetë e hirit kërkon që gjërat të dalin në dritë, të mos qëndrojnë në errësirë:

“Por kush bën të vërtetën vjen tek drita, që veprat e tij të zbulohen, sepse u bënë në Perëndinë”. (Gjoni 3:21).

Të jetosh me maskë do të thotë të mos e shijosh lirinë e Frymës së Shenjtë, që zotëron faljen dhe na jep zemër për të grisur velin që na mbulon, për të nxjerrë në dritë lavdinë e Perëndisë. Ne jemi të lirë ta bëjmë këtë, jo sepse kemi arritur përsosmërinë që do të na mbrojë nga shikimet turbulluese të botës përreth, por sepse ndryshe nga Moisiu, ne “s’po tretemi”, përkundrazi po rritemi e po i shëmbëllemë gjithnjë e më shumë Perëndisë.

Perëndia kishte parashikuar që çdo gjë që thuhej, bëhej apo mendohej do të zbulohet. Mjerë ata që do vazhdojnë të fshihen! Për ata që janë të hapur dhe që rriten, thjesht do të jetë një histori çlirimi.

## Fëmija Është...

*I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë...  
sepse e tyre është mbretëria e Perëndisë.*

Fëmijët zinin një vend të veçantë në zemrën e Jezusit. Nëpërmjet tyre ai u dha një mësim tepër të dobishëm nxënësve të tij.

Atëherë i prunë disa fëmijë të vegjël që ai t'i prekte ata; por dishepujt i qortonin ata që i prunë. Kur Jezusi e pa këtë, i indinjuar, u tha atyre: "I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse e tyre është mbretëria e Perëndisë. Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të". Dhe, si i mori në krahë, i bekoj duke vënë duart mbi ta. (Marku 10:13-16)

*Fëmija është një krijesë e butë, që s'kërcënon njeri. Unë s'do të trëmbesha aspak po të ndeshja një fëmijë në një qoshe të errët. Në qoftë se ne do të ndjekim Jezusin dhe do ta përfaqësojmë atë denjësisht, bota do të na druhej, aq sa i druhemi ne një fëmije. Ndaj Jezusi theksoi: "Unë po ju dërgoj si dele mes ujqërve; jini, pra, të mençur si gjarpërinjtë dhe të pastër si pëllumbat" (Mateu 10:16).*

Disa vjet më parë, kur isha ndihmëspastor në Illinois, gratë vinin në kishë për lutje çdo të enjte në mëngjes. Ngaqë mbidheshin vetëm gratë dhe unë nuk isha i ftuar, parapëlqëja ta kaloja atë kohë duke luajtur me fëmijët e tyre në çerdhen që ndodhej aty pranë. Kurrë s'do më hiqet nga mendja takimi i parë me ta. Hapa sportelin e derës së çerdhes, zgjata trupin brenda dhe thirra: "Ç'kemi kolopuça! Sot ka ardhur mes jush pastor Ervini. Hajdeni të lozim së bashku!" Me të dëgjuar zërin tim njëri prej fëmijëve iku me vrap i frikësuar në dhomën tjetër. Të tjerët, sikur të mos kishte ndodhur gjë, vazhduan të merreshin gjithsecili me punët e tij. Epo si duket s'e dinë se kush jam unë, mendova, dhe vendosa të hyj brënda. Iu afrova grupit të tyre dhe për të dytën herë u thashë: "Ç'kemi kolopuça! Hajde luajmë së bashku!" Një fëmijë tjetër, i frikësuar, iku me vrap nga dhoma ngjitur. Të tjerët vazhduan lojën me mospërfillje si të thonin: "Dëgjuat gjë?"

Në këtë moment e ndjeva që egoja ime po ngrinte krye. Kujdestarja e fëmijëve filloi të qeshte duke u zbavitur. Aq i zemëruar isha, sa më vinte t'i afrohesha njërit prej fëmijëve, ta shkundja fort dhe t'i thoja: "Ne të dy do luajmë bashkë dhe ke për ta parë sa do kënaqemi. A më dëgjon?" Por fatmirësisht, në atë moment dëshpërimi, Fryma e Shenjtë ndërhyri dhe më sollti në kujtesë fëmijërinë time dhe përshtypjen që më bënëin atëherë të rriturit me shtatmadhësinë e tyre. M'u kujtua që më dukeshin si gjigandë, që të kallnin frikë. Si fëmijë, bota ime s'mund të shihte mbi lartësinë e gjurit. Kurrë nuk merrja pjesë në biseda të rriturish. E përse të flisja me ta? Se mos merrja vesh nga politika apo ekonomia! Për mua një monedhë përcaktohej nga madhësia dhe jo nga vlera që mbante. Megjithatë, ata donin të më kishin në sy ndonëse s'ma vinin veshin.

Kështu, i prekur nga këto kujtime u ula përtokë dhe iu drejtova atyre me këto fjalë: "Ç'kemi kolopuça! Hajde luajmë! Dhe s'kaluan tridhjetë sekonda para se të fillonin të më hipnin në qafë, duke gërthitur, duke më tërhequr nga kravata e nga flokët, duke ma prishur plotësisht paraqitjen dinjitoze. Që nga ajo ditë, kur shkoja tek ta, me të hyrë, përplasesha mbi dysheme si shoku i tyre i ngushtë nga i cili s'kishin përse të kishin frikë.

Natyrë fëminore e butë e Jezusit nuk frikësonte njeri. Atij i afroheshin pa ndrojtje si miqtë dhe të dashurit e tij, ashtu dhe armiqtë. Farisenjtë dhe Saducenjtë e sulmonin me zjarr, ngaqë ai tregohej i thjeshtë. Sikur Jezusi të kishte përshkuar botën me një shkëlqim parajsor dhe me një zë gjëmues e mbretëror, ata as që do kishin guxuar ta sulmonin. Fëmijët e ndienin veten mirë pranë tij. Do të mjaftonte një shikim i shpejtë për të kuptuar se kjo arrihej vetëm në saj të natyrës së tij fëminore. Anëtarët e Sinedrit thurrën një komplot për ta kapur, por shpejt u zbrapsën, jo sepse i trembeshin Jezusit, por sepse u druhashin njerëzve që e mbronin atë.

*Fëmijët s' dinë të mashtrojnë*, Pjesë e të qenit fëmijë është të jesh i përlurur dhe i sinqertë. Në fytyrat e tyre lexohet menjëherë gëzimi, ashtu dhe trishtimi. Ata s' dinë ta fshehin frikën. Të gjithë e dimë se dy fëmijë që lozin së bashku do të qeshin e do të gërthasin, do të vrapojnë, do të grinden me njëri-tjetrin dhe do të qajnë. Dhe kur i lëmë të lirë të veprojnë kështu, ata do të zihen keq dhe do të zemërohen me njëri-tjetrin, por pas pesë minutash do të pajtohen dhe do të fillojnë të luajnë së bashku sërish, sikur të mos ketë ndodhur asgjë.

Më kujtohet se kur im bir ishte pesë vjeç, njëherë donte të nxirrte jashtë shtëpisë një lodër delikate, me të cilën duhej të luante vetëm brenda. Pavarësisht nga këshillat tona, ai u përpoq të dilte. Me trup të përkulur, me dorën të fshehur nga prapa, me një shikim prej hajduti u mundua me marifet t'i shpëtonte shikimit tonë. Por në fytyrën e tij qe e shkruar gjithçka po bënte. Ai s' dinte të fshihej. Por mos mendoni se duhet shumë kohë për t'i mësuar artin e ndërlikuar të mashtrimit që përdorin të rriturit.

Më kujtohet një periudhë e fëmijërisë së tij, kur atij i pëlqenin truket magjike, por si fëmijë që ishte e kishte të vështirë kryerjen e tyre. Të rriturit e kishin fare të lehtë ta gjenin se në cilën dorë gjendej objekti i fshehur. Pa dyshim në dorën "e mbyllur". Ai s' dinte të mashtronte.

Shumë prej prindërve mund të kujtojnë rastet, kur u duhej t'u jepnin fëmijëve të tyre lugën me ilaç. Ata shtrëngonin fort buzët dhe e kyçnin gojën, pavarësisht nga lutjet e vazhdueshme të prindërve.

Atëherë, nisnin hiletë prindërore: “Shiko sa i mirë është. Ja, po e pi unë i pari.” Pasi të pinin një gllënjë të vogël nga ai lëng i hidhur do të buzëqeshnin sikur të kishin ngritur një dolli. Atëherë, fëmija, i bindur do të hapte gojën dhe menjëherë do të kuptonte se të jesh i rritur do të thotë të dish të gënjeshe e të mashtrosh.

Si do të ndihesha unë sikur të merrja vesh se një njeri që e doja po përdorte mënyra të ndryshme për të më mashtuar? Si do ishin marrëdhëniet tona, sikur miqësia jonë të bazohej në sinqeritetin? Mashtrimi është i huaj për fëmijën, për dashurinë edhe për Jezusin.

Më pëlqen t’u tregoj histori fëmijëve. Ata mund ta shprehin mosbesimin menjëherë. Kur u paraqet diçka si të vërtetë ata e pranojnë atë si të tillë. Ata janë mjeshtra që t’i pranojnë gjërat ashtu siç i shohin. Kështu dëshironte Jezusi ta shihnim dhe ta pranonim ne mbretërinë e Perëndisë. Së pari, kjo është çështje e besimit tonë - ne mund ta pranojmë ose jo - para se ajo të bëhet pjesë e arsytimit tonë.

*Fëmija është një krijesë e pafajshme.* Kur Jezusi na këshillonte të tregoheshim si fëmijët në çastin kur do të pranonim mbretërinë, ai kishte parasysh ata që, si fëmijët, s’u ishin nënshtruar ende kërkesave të ligjit. Vjen një moshë e caktuar kur fëmija konsiderohet i ndërgjegjshëm dhe i nënshtrohet ligjit. Deri atëherë ai konsiderohet i pafajshëm. Ta pranosh si një fëmijë hirin dhe faljen e Perëndisë do të thotë ta kuptosh që tani jemi në fazën e pafajësisë. Sa të vështirë e kemi ta pranojmë faljen e Perëndisë si fëmija! Ne vazhdojmë të krijojmë ligjësi dhe kërkesa të ndryshme si për vete, ashtu edhe për të tjerët. E kemi të vështirë ta pranojmë faljen e mëkateve dhe ta konsiderojmë veten “sikur s’kemi mëkatuar kurrë”. Prandaj këmbëngulim që ta fitojmë prej Perëndisë faljen dhe pafajësinë. Derisa ta arrijmë këtë gjë, do vazhdojmë t’i shërbejmë të tjerëve më tepër të shtyrë nga ndjenja e fajit dhe nevojat tona personale, sesa nga ndjenja e përkushtimit dhe dëshira për të vuajtur bashkë me ta e për t’u shërbyer me gjithë shpirt.

# I Dorës së Dytë

*Më i madhi mes jush duhet të jetë si më i vogli*

I parëlinduri është gjithmonë më i fituari. Nga statistikat rezulton se i parëlinduri gjithnjë arrin më tepër, shpesh ai arrin pozita të larta, në provime arrin rezultate të larta etj. Ndryshe nga fëmijët e tjerë, i parëlinduri gëzon gjithë vëmendjen dhe kujdesin e prindërve. Këta fëmijë, që në moshë të hershme ngarkohen me përgjegjësi, dhe kjo bën që ato të piqen më shpejt. Ndaj ata s'e ndiejnë pothuajse fare nevojën e ndihmës së të tjerëve. Ata mund t'i përballojnë vetë situatat e problemet.

Ndryshe ndodh me më të voglin. Mbi të gjitha, atij i duhet të ndeshet me veprimet deri diku arrogante të vëllait më të madh, që mund t'i shkaktojnë probleme të përjetshme. Shumica e gjërave që ka janë sende të përdorura, të dorës së dytë, që vëllai i madh s'i përdor më ose i konsideron të pavlefshme. Etaloni matës për më të voglin është gjithnjë vëllai i madh. Edhe identiteti i tij lidhet me emrin e vëllait më të madh, prandaj shpesh në shkollë i thonë: "Oh, ti je vëllai i filanit që ishte i tilli e i këtilli!" Ai, bile pritet të shkëlqejë e të dallohet në po ato fusha ku ka shkëlqyer vëllai i madh. Gjithë jeta e tij fillon t'i ngjajë një odiseje pa mbarim në kërkim të identitetit të tij të vërtetë.

Është fakt, që të qenit më i vogli, nga natyra vetë s'të garanton pozita të forta dhe autoritare, as sundim mbi të tjerët. Ky pozicion

të ofron më tepër një pozicion pritjeje dhe pranimit të gjërave që të ofrohen apo që mbesin pasi zgjedhin më të mëdhenjtë.

Kur Jezusi përdori fjalën “më i vogli”, ajo mbartte një kuptim shumë më të madh, sesa sot. Më i vogli i vëllezërve ishte një rebel tipik që nuk i interesonte ruajtja e statu-kuosë. Në sistemin ku jetonte ai e ndiente veten të shtypur. Suksesi i tij varej nga aftësitë vetiake dhe mëshira e të tjerëve. Jeta në përgjithësi dhe tradita në veçanti nuk ishin në anën e tij. I parëlinduri gëzon të drejtën e trashëgimisë dhe në disa raste është trashëgimtar i krejt pasurisë. Si të mos jetë më i vogli rebel kur i gjithë pushteti kalon tek më i madhi? Edhe për më të voglin veprim vetëmbrojtës, të mëdhenjtë që e kanë nën kontroll, do t’i ngjisnin nofkën “rebel”.

Ndryshe nga më të vegjlit, të parëlindurve u intereson ky sistem marrëdhëniesh. Vetë radha e lindjes u ka siguruar atyre pozita për të ardhmen. Për to fjala më me peshë është: “Të ruajmë të paprekur statu-kuonë.” (“Pasi punët po ecin për së mbari. Le t’i lëmë ashtu siç janë!”). Të mëdhenjtë kanë të drejtën e qeverisjes. Pozitat autoritare u ngarkoheshin gjithmonë atyre. Duhet ta pranojmë se, në këtë botë, të jesh i parëlindur është një favor i madh.

Por, Jezusi na këshillon t’i ngajmë më të voglit edhe pse jemi në moshë të rritur. Në qoftë se shpërdorojmë privilegjet dhe autoritetin që gëzojmë, duke e përdorur këtë mbi më të vegjlit, atëherë ne dhunojmë natyrën e Jezuit. Për të gjithë ato sisteme të botës apo sisteme fetare që duan të ruajnë status-kuonë, kjo deklaratë është tepër therëse dhe i ngjan shpalljes së një lufte.



# I Fundit në Radhë

*Nëse ndonjërit i pëlqen të jetë i pari,  
ai duhet të jetë krejt i fundit*

Krejt i fundit - një shprehje sa kuptimplote për ata njerëz që zgjedhin të bëhen shërbëtorë të të tjerëve, aq e papranueshme për natyrën tonë njerëzore.

Më kujtohet ajo kohë, kur ishim më të rinj dhe së bashku me familjen udhëtonim gjatë stinës së verës me një “Volkswagen”. Rrugës për tek vendet ku më duhej të predikoja ndaleshim dhe ngrinin çadra kampimi për të kaluar natën apo për të pushuar. Kështu bënim një rrugë e dy punë, kryenim detyrën por edhe argëtoheshim. Pasi bënim 300 km e fillonim të ndiheshim të lodhur, unë zgjidhja një vend të përshtatshëm për të bërë një pushim - zakonisht ndonjë lulishte të vogël lagjeje. A mund t’i përfytyroni fëmijët e mi duke klithur: “Unë jam i fundit, unë jam i fundit!”, ndërsa kërcejnë nga makina e sulen me vrap drejt lisharësit të vetëm të lulishtes. As mos u mundoni ta përfytyroni një skenë të tillë, pasi kjo as që ndodhi dhe as që ndodh zakonisht. Natyra jonë njerëzore na nxit të dalim gjithmonë të parët.

Epoka në të cilën jetojmë është epoka e konkurrencës, por kjo e fundit e humb kuptimin, në qoftë se i mungon stimuli për të dalë i

pari, për të qenë më i miri, apo kur mungon rivali me të cilin do të matesh. Është tepër e vështirë të konkurrosh me dikë që pranon të dalë i fundit në garë apo që nuk pranon të marrë pjesë në garë vetëm që të mos dalë ai i pari.

Dua apo s' dua ta pranoj, të dalësh i pari do të thotë t'i ulësh të tjerët nga pozita. Epërsia ime arrihet vetëm në kurriz të dikujt tjetër. Kështu unë kam dy alternativa - ose të jem egoist, ose t'i dua dhe të vihem plotësisht në shërbim të të tjerëve. Ndjenja e fortë egoiste më shtyn deri në atë pikë sa t'i konsideroj veprimet e mia si të frymëzuara nga Shkrimet e Shenjta, dhe të them se Perëndia "dëshiron" që disa nga ne të kapin majën e Olimp, kështu që ne s'mund të kundërshtojmë vullnetin e Perëndisë. (Shpesh e ndiej veten shumë të zotin në artin e arsyetimit.)

### ***Rivaliteti Vëllazëror***

Një varg traditash kanë mundur të depërtojnë në kishë ngaqë konsiderohen si të mira në shoqërinë tonë ateiste. Një prej tyre është edhe konkurrenca. Që në moshë fare të re, tek ne shfaqen prirjet për të fituar, për të dalë parët, për të arritur ç'është më e mira dhe për të marrë sa më shumë tituj nderi. Shkolla është institucioni bazë që të ushqen çdo ditë me një dozë shpirti konkurrues. Po të mungonte konkurrenca, e cila sjell gjallëri dhe argëtim, mësimi do bëhej i mërzhikshëm. Pa dyshim që kjo është një formë e mirë nxitjeje. Kur rrethanat e konkurrimit janë të mira, ne nxitemi të punojmë më tepër. Po cilat mund të jenë rezultatet e konkurrencës brenda trupit të Krishtit?

Asnjë trup nuk mund të mbijetojë në qoftë se organet e tij janë në konkurrencë të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Një trup është i shëndetshëm kur secila pjesë kryen funksionin e vet, duke e bashkërenduar plotësisht punën e saj me atë të pjesëve të tjera. Konkurrenca, nga vetë natyra e saj është vetëshërbyese dhe s'ka asgjë të përbashkët me natyrën shërbyese dhe vetëmohuese të Jezusit. Disa nga atributet e veçanta të konkurrencës do ta vërtetojnë më së miri arsyetimin tonë.

Që konkurrenca të bëhet sa më e frytshme duhet të vendoset një çmim apo stimul, qoftë ky stimul material apo thjesht një çmim që

dëshmon për aftësinë e atij që ua kalon të tjerëve dhe del gjithmonë i pari.

Së pari, të kërkosh shpërblim material për një shërbim që i ke bërë Perëndisë do të thotë të veprosh në kundërshtim me Shkrimet e Shenjta. Tek Letra drejtuar Romakëve 14:17 thuhet: “Sepse mbretëria e Perëndisë nuk është të ngrënët dhe të pirët, por drejtësia, paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë.”

Së dyti, dëshira për të dalë mbi të tjerët është plotësisht në kundërshtim me udhëzimet e Biblës, e cila na mëson të pranojmë vendin e fundit për hir të të tjerëve. Synimi për të qenë mbi të tjerët ushqen egon dhe mendjemadhësinë. S’ke si të mos jesh mendjemadh, ndërkohë që kërkon të jesh mbi të tjerët.

Konkurrenca lind edhe mashtrimin, pasi në qendër të saj është një çmim me vlerë që ne synojmë ta fitojmë. Në vend që të nxisë veprimet e cilësitë më të mira, ajo i hap rrugën shpirtit materialist dhe mendjemadhësisë.

Kam zbuluar se unë jam një fitues “mjeran”. Kur arrij t’ia kaloj dikujt, ndiej një gëzim të brendshëm të paparë dhe s’jam në gjendje ta frenoj këtë ndjenjë. Kjo është në natyrën time. Nganjëherë, ndodh që, si me shaka “miqësore” ia përmend disa herë kundërshtarit faktin që e kam mundur, aq sa bëhem tepër i papëlqyeshëm e bajat.

Por, unë s’jam i keq vetëm kur fitoj, unë jam shumë më i keq kur humbas. Pas një humbjeje më ndodh të humbas edhe arsyen. Ndjenja e xhelozisë dhe e zemërimit drejtohet mbi kundërshtarin që guxoi të më mundë. Që nga momenti i disfatës filloj të kurdis plane dhe pres me padurim çastin kur do të mund ta barazoj rezultatin. Më pas, pak nga pak filloj ta kuptoj se qëndrimi im ndaj fitores apo disfatës bie plotësisht në kundërshtim me parimet e vërteta të krishtera.

Një tipar tjetër i konkurrencës është si ajo vetëm mund të masë veprimet tona më të parëndësishme. Askush s’mund të japë kurrë një çmim për botën shpirtërore, besimin apo dashurinë, pasi këto s’mund të maten. Ne mund të llogarisim veprime të veçanta fizike, si për shembull numrin e vizitorëve në Shkollën e së Dielës apo shumë e parave të mbledhura për një mision të caktuar. Çmimi që jepet për veprimtari të tilla është një tregues i mirë i nxitjes së vërtetë.

Çdo garë ka rregullat e saj. Po kush i përcakton rregullat? Një njeri, i cili ulet dhe përpilon një listë rregullash sipas dëshirës së tij. Po të ndodhte kështu me jetët tona, ato do të drejtoheshin në një mënyrë shumë arbitrare.

Ndoshta dëmi më i madh që konkurrenca i shkakton shëndetit të trupit të Krishtit është se prej saj shumica dalin të humbur dhe vetëm një numër i vogël arrijnë të fitojnë. T'i përkasësh Krishtit do të thotë të jesh përjetësisht i fituar. Veprimet që nuk bazohen në këtë realitet por që përforcojnë ndjenjën e zakonshme njerëzore të disfatës nuk kanë asgjë të përbashkët me natyrën e Jezusit.

Shpesh kam debatuar ashpër me njerëz të cilët mbrojnë idenë se konkurrenca brenda trupit është diçka shumë e bukur dhe ia vlen ta zhvillosh sepse të jep kënaqësi. Por kam vënë re se vetëm ata njerëz, të cilët janë mësuar të fitojnë e të dalin të parët, ata që për shkak të lindjes, jo zgjedhjes së tyre, u bekuan me trupa dhe mendje të forta, e mbrojnë atë me zjarr. Ata harrojnë se Perëndia i ka bekuar që në bark të nënës me trup të fuqishëm apo mendje të mprehtë, dhe se nuk është merita e tyre personale. Kjo e sqaron plotësisht çështjen për të cilën bëjmë fjalë.

Unë jam plotësisht i bindur se konkurrenca mund të gjejë shpengim. Hapi i parë mund të jetë shvlerësimi i çmimit të saj ose njohja e vlerës së tij vetëm gjatë kryerjes së veprimtarisë (pra gjatë veprimtarisë gëzimin ta ndash me miqtë). Hapi i dytë mund të jetë shpikja e lojërave ku shkathësia atletike të mos vlerësohej dhe çdonjëri, pavarësisht nga aftësitë, të jetë në kushte të barabarta me të tjerët. Hapi i tretë do të jetë krijimi i situatave që do të nxisnin më tepër ndjenjën e miqësisë, se të konkurrencës. Dhe hapi i katërt, gjetja e mënyrave për t'u dhënë “gjymtyrëve më pak të nderuara... më shumë nderim”, siç porosit Pali në letrën e parë drejtuar Korintasve 12:22-25.

Duhet të bëjmë kujdes sepse nga kjo mund të lindë një problem i mprehtë. Nuk duhet të themi: “Meqenëse jam më i madhi, po të lë ty të parin dhe unë po rri në fund”. Sa e shëmtuar do të ishte kjo! Jo! Po t'i duam njerëzit me dashurinë e Jezusit duhet të gëzohemi kur t'i shohim se kanë dalë të parët e ndihen mirë, pa kuptuar se, duke ndihmuar ata, kemi ngelur në fund për vete. Vetëm atëherë e

kemi vënë veten plotësisht në shërbim të të tjerëve.

Atëherë lind pyetja: “Si do të ishte kisha sikur të gjithë ne ta trajtonim njëri-tjetrin në këtë mënyrë?” Jam i bindur se të shërbyerit me dashuri brenda trupit të Krishtit, jo vetëm që do t’i frymëzonte pjesëtarët e saj, por do t’ua rrëmbente aq shumë zemrat njerëzve, sa ata do kërkonin me ngulm të bëheshin anëtarë të saj. Është e vështirë t’i rezistosh dashurisë. S’do të doja gjë tjetër, veçse t’i dëgjoja edhe njëherë njerëzit të thonin: “Po sa shumë që e duan njëri-tjetrin këta të krishterët!”

Shpirti i konkurrencës mes dishepujve, dëshira për të qenë kush e kush më i madh, e shtyu Jezusin t’u mësonte të kundërtën - tiparet e më të madhit të Mbretërisë. Nëse do ndjek shembullin e Jezusit duhet që ai të prekë çdo aspekt të jetës sime, duke përfshirë edhe krenarinë e lindur që më shtyn të dal i pari ndër vëllezërit e mi.

## Ka Vend në Grazhd

*Sepse kush është më i vogli mes jush, ai do të jetë më i madhi*

S’kam dëgjuar ndonjëherë që çmimet e titujt t’u jepen të vegjëlve. Më të vegjlit nuk rrinë në fund për të fituar lavdi. Dëshira për të qenë më i vogli lind vetëm në rastin kur ne ndihemi mirë dhe e pranojmë pozicionin tonë. Po qe se e përbuzim përlulësinë dhe duam të bëjmë emër, vështirë se lakmojmë vendin e më të voglit.

Udhëheqës të ndryshëm, të etur për sukses e famë përdorin çmimet e nderet si një mënyrë të suksesshme për të manipuluar punonjësit e tyre. Figura dinjitoze fetare janë kompromentuar paturpësisht vetëm për t’u bërë të famshëm.

Ashtu si konkurrenca vepron e nxitur nga ndjenja e lartësimit të vetes, edhe etja jonë për nderime ndizet e merr zjarr nga pikësynime krejt të ndryshme nga ato të Jezusit. Ai “nuk i dha vetes emër e famë.” Kaq shumë e kemi dhunuar natyrën e tij në lidhje me nderimet dhe njohjen, sa do të doja t’ju tërhiqja vëmendjen për ta shqyrtuar së bashku këtë problem.

Ne jetojmë sot në një shoqëri që priret nga reklamat e biznesi. Faqja mbi kishën e gazetës javore lokale shpesh është e mbushur me vetëlëvdata të ngjashme me reklamat që Hollivudi u bën prodhimeve të tij. Aq efikase është kjo metodë, saqë njerëzit s’i kushtojnë

pikë vëmendjeje kësaj faqeje gazete. Organizatat individuale dhe shoqërore kishtarë japin grada dhe tituj njëlloj si institucionet e tjera botërore. Të dëgjosh hyrjet e gjata e prezantimet e tepruara në festivalet e konferencat e krishtera është me të vërtetë një përvojë e hidhur. Dhënia e titujve të nderit sot nga universitetet e krishtera për qëllime përfitimi apo leverdi të dyanshme janë me të vërtetë një skandal.

Disa plane nderimi të universiteteve janë menduar që të nxjerrin përfitim nga sqima dhe shitja e librave të marrësit të nderit. Puna arrin deri aty sa njëra nga detyrat që kryejnë përfaqësuesit fetarë që merren me marrëdhëniet publike, rrahin të sigurojnë fitime e përnderime publike në shërbim të hierakisë fetare. Më vjen turp ta them, por edhe unë vetë kam gisht në planet që synonin të kompromentonin njerëzit nëpërmjet shpërblimeve materiale për t'i përdorur më pas si vegla për qëllimet tona.

Si është e mundur të harrojmë mësimet e Shkrimeve të Shenjta dhe të vazhdojmë të përdorim nderet për qëllime manipulimi? Do të jetë shumë me rrezik për kishën, po të vazhdojmë të mbështesim dhe të përdorim metodat e sistemeve botërore.

Mësimet e Jezusit mbi veprimet që bëjmë për sy të botës janë shumë të qarta:

“Mos e jepni lëmoshën tuaj para njerëzve, me qëllim që ata t’ju admirojnë; përndryshe nuk do të shpërbleheni te Ati juaj, që është në qiej. Kur do të japësh lëmoshë, pra, mos i bjer borisë para teje, ashtu siç bëjnë hipokritët në sinagoga dhe në rrugët, për të qenë të nderuar nga njerëzit; në të vërtetë ju them, se ata tashmë e kanë marrë shpërblimin e tyre.”

(Mateu 6:1-2)

Jezusi kërkon që ne të mos e trumbetojnë ndihmën që u japim të tjerëve. Ai kërkon që lutjet tona të mos jenë të bujshme që t’i dëgjojë gjithë bota. Ati ynë e vlerëson dhe e shpërblen haptazi ndihmën dhe lutjet tona të heshtura. Atij duhet t’ia besojmë vlerësimin tonë dhe jo njerëzve të tjerë sado të rëndësishëm qofshin ata. Po qe se bëhemi pjestarë të një sistemi vetëstimulues, ne nuk arrijmë ta kuptojmë se vetëm Ati mund të vlerësojë veprimet tona dhe jo sistemi që ne vetë kemi ndërtuar. Pali, prerazi përcakton vijën e

kufirit tek letra e dytë drejtuar Korintasve 10:17-18: “ Ai që lëvdohet, le të lëvdohet në Zotin, sepse nuk miratohet ai që e rekomandon veten e tij, por ai të cilin e rekomandon Zoti.”

Asnjëri nga të dy shembujt që lëvdojnë Jezusin nuk i justifikojnë sistemet tona të lavdërimit. Tek Luka 2:52 thuhet: “Dhe Jezusi rritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve.” Pikërisht ata njerëz nën hirin e të cilëve u rrit dhe për të cilët ai jetoi, qenë të parët që e përqeshën, e mohuan dhe e detyruan të deklaronte se profeti s’nderohet në vendin e vet. Më vonë, në fragmentin e hyrjes triumfuese tek Mateu 21, turma e njerëzve që e nderuan atë duke ia shtruar rrugën me palma dhe duke brohoritur “Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit! Hosana!”, kërkuan që ai të kryqëzohej. Kjo dëshmon, se, sado të mëdha të jenë nderimet e njerëzve, ato janë boshe, të pavlera dhe të rreme.

I vetmi vlerësim i arsyeshëm që duhet të kërkohet dhe që nuk e humbet vlerën e tij është “...synimi drejt çmimit të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus” që gjendet tek (Filipianët 3:14). Kjo “thirrje e lartë” është një thirrje për t’u vënë në shërbim të njerëzimit.

### ***Kur hani është plot***

S’është e thënë që qilari të jetë vendi më i keq, i prerë për llumin e shoqërisë, për dembelët, të pakënaqurit e të plogëtit. Natyra e Jezusit të shtyn ta zgjedhësh pozitën e të fundit, duke vlerësuar lart të tjerët dhe duke bërë të pamundurën për ta, pa kuptuar se vetë del i fundit.

Janë të paktë në këtë botë ata njerëz që arrijnë të ngjiten në majë, pasi disa prej tyre plagosen, të tjerë dekurajohen. Por, sikur të gjithë të arrinin të ngjiteshin gjer lart, maja është aq e ngushtë, sa edhe të aftët dhe ata që me të vërtetë e meritojnë të jenë aty do të hasnin pengesa të mëdha. Hani i quajtur sukses e pasuri është gjithmonë plot tamam në çastin kur mendon se mund ta arrish. Janë të panumërt ata që kërkojnë të punësohen në punët më të mira, ose të jetojnë në shtëpi luksoze - por ja që vendet janë të pakta dhe çmimet shumë të larta.

Por ekziston një strehë ku ka vend për të gjithë. Ajo quhet grazhd. Është një vend i vogël dhe i ndotur ku jetojnë bagëtitë, por është



vendi në të cilin lindi Biri i Perëndisë, më i madhi i mbretërisë, shërbëtori i njerëzimit. Aty ka vend boll në çdo kohë po të doni të viheni në shërbim të të tjerëve, pasi pak njerëz luftojnë për të zënë një vend të tillë. Në qoftë se me të vërtetë i doni njerëzit dhe doni t'u shërbeni s'është vështirë të gjeni vend. Ndofta s'do gjeni lavdi e çmime, por vendi do të jetë i bollshëm.

Kur engjëlli i Perëndisë i foli Marisë dhe i tregoi se Perëndia e kishte zgjedhur të lindte Krishtin ajo kuptoi se ç'ishte krenaria dhe përlësia, e ndoshta edhe se ç'ishte grazhdi. Prandaj tha:

“Shpirti im e madhëron Zotin  
dhe fryma ime ngazëllon në Perëndinë,  
Shpëtimtarin tim,  
sepse ai e shikoi me pëlqim përlësinë  
e shërbëtores së tij;  
sepse ja, tani e tutje të gjithë brezat  
do të më shpallin të lume,  
sepse i Pushtetshmi  
më bëri gjëra të mëdha,  
dhe i Shenjtë është emri i tij!  
Dhe mëshira e tij shtrihet nga brezi në brez  
për ata që e druajnë.  
Ai veproi pushtetshëm  
me krahun e vet;  
i shpërndau krenarët  
me mendimet e zemrave të tyre;  
i përmbysi pushtetarët  
nga fronat e tyre  
dhe i ngriti të përlulurit;  
i mbushi me të mira të uriturit  
dhe i ktheu duarbosh të pasurit.  
Ai e ndihmoi Izraelin, shërbëtorin e vet,  
duke i kujtuar për mëshirën e tij,  
ashtu si iu pati deklaruar etërve tanë,  
Abrahamit dhe pasardhësve të tij,  
përgjithmonë.”

Luka 1:46-55

Pra, Jezusin e gjejmë në vendet më të mjera - në grazhde, mes të varfërve, duke u shërbyer me përlulësi, duke dhënë i pari shembullin e tij, i parrezikshëm si fëmija dhe më i vogli, gjithmonë i fundit dhe më i parëndësishmi. Por kudo që shkante, gjendej dikush të cilit do t'i shërbente.

Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezus Krishtin:

I cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie,  
 nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort  
 për të qenë barabar me Perëndinë,  
 por e zbrazti veten e tij,  
 duke marrë trajtë shërbëtori,  
 e u bë i ngjashëm me njerëzit;  
 dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri,  
 e përuli vetveten duke u bërë  
 i bindur deri në vdekje,  
 deri në vdekje të kryqit.

Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht  
 dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër,  
 që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju  
 i krijesave qiellore, tokësore dhe nëntokësore,  
 dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezus Krishti është Zot,  
 për lavdi të Perëndisë Atë.

Filipianët 2:5-11

# Lamtumirë Taktika të Forcës

*Jezus Krishti...edhe pse ishte Perëndia vetë,  
nuk kaqej pas privilegjeve hyjnore*

Në letrën që i drejton kishës në Filipi, Pali trajton thellësisht personin dhe natyrën e Jezusit. Aty, ai përmend shembujt që Jezusi vetë u dha dishepujve të tij, ndërsa u shpjegonte se ç'do të thotë të jesh i pari i mbretërisë. Por Pali shton edhe diçka aktuale: “Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë.” (Filipianët 2:5-6). Interpretimi më i thjeshtë që mund t’i bëjmë këtij fragmenti është se, edhe pse Jezusi qe Perëndia vetë, ai nuk u përpoq të udhëhiqte mbretërinë me anë të forcës.

Shuma të pallogaritshme parash harxhohen sot në botë për armatim. Jezusi i dënonte këto veprime, pasi ai i vlerësonte shumë njerëzit dhe as që i shkonte ndërmend të përdorte forcën mbi ta. Atij s’i mungoi forca dhe pushteti për të urdhëruar legjionet e engjëjve që t’i vinin në ndihmë, ta shpëtonin nga ekzekutimi në kryq dhe të hakmerreshin ndaj turmës së njerëzve që e trajtuan aq poshtërsisht. Por ai s’e bëri një veprim të tillë. Jo vetëm kaq, por ai

mund të shkonte fshat më fshat, t'i mbërthente për fyti e t'i kërcënonte ata njerëz që s'do të pranonin të bëheshin pasues të tij. Por, as këtë s'e bëri. Aq shumë e respektonte ai lirine tonë, sa kurrë nuk pranoi të bënte veprime që mund të shkatërronin apo pengonin lirinë e zgjedhjes sonë. Kështu vepron dashuria e vërtetë.

Për të nxjerrë më mirë në pah mirësinë e Jezusit, Mateu citon disa vargje nga Isaia:

“Ja shërbëtori im, që unë e zgjodha; i dashuri im në të cilin shpirti im është i kënaqur.

Unë do ta vë Frymën time mbi të dhe ai do t'u shpallë drejtësinë popujve.

Ai nuk do të zihet dhe as nuk do të bërtasë dhe askush nuk do t'ia dëgjojë zërin e tij nëpër sheshe.

Ai nuk do ta thërmojë kallamin e thyer dhe nuk do ta shuajë kandilin që bën tym, derisa të mos e ketë bërë të triumfojë drejtësinë.

Dhe njerëzit do të shpresojnë në emrin e tij.”

Mateu 12:18-21

Ne s'kemi ndonjë shprehje krahasimi për kallamin e thyer dhe kandilin që bën tym. Kuptimi i përafërt që mund të nxjerrim nga fjalët e tij është se “Ai s'do t'i shkelë njerëzit e pafuqishëm dhe se kërkon të gjejë mes njerëzve shkëndijën më të vogël të shpresës që pastaj të mund të ndezë zjarrin e madh.”

Kur isha me skautistët e vegjël më kujtohet se ndiznim zjarr me gurë stralli ose duke fërkuar dy shkopinj bashkë. Ne merrnim pak eshkë dhe e vendosnim në një vend ku mund të binin shkëndijat e strallit ose ku vepronte nxehtësia që çlirohej nga fërkimi i dy shkopinjve dhe kështu ajo ndizej e merrte flakë.

S'ka dyshim që nga fërkimi i shpejtë shkëndijat do të binin mbi eshkën. Sikur edhe një e vetme të ishte ajo shkëndijë, asnjëri nga ne s'do ta quante të pavlefshme dhe s'do ta shuante. Përkundrazi, do fillonim të kujdeseshim më tepër, do ta merrnim eshkën në duar, do t'i frynim fort për t'i dhënë oksigjen që të ndizej. Ky është një shembull mjaft i mirë për të përshkruar mënyrën se si na trajton Jezusi ne dhe sa ndryshe e trajtojmë ne njëri-tjetrin.

Si mësues universiteti jam i detyruar t'i vlerësoj studentët me nota. Kjo është gjëja më e urryer në profesionin tim. Sipas sistemit tonë, ata njerëz që s'arrijnë së paku masën 65% të nivelit tonë s'kanë më punë me mua.

Edhe pse nuk na vjen mirë, duhet ta pranojmë se me dashje apo pa dashje me vlerësimet tona të përgjithshme ne i klasifikojmë njerëzit. Kur ata nuk arrijnë të plotësojnë shumicën e kriterëve për të qenë “njerëz cilësorë”, ne nuk u japim mundësinë të bëhen miqtë tanë. Kjo ndodh edhe brenda kishës. Ata njerëz që nuk arrijnë t'u përmbahen normave e rregullave të një sjelljeje minimale në së paku tetëdhjetë përqind të kohës, nuk meritojnë vëmendjen dhe përkushtimin tonë.

Sa ndryshon nga këto masa ndëshkuese e pedante ftesa fisnike që Jezusi u bën njerëzve të munduar e të rënduar: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!”. Ai nuk shkel mbi ne sepse tek ne shndrit vetëm një shkëndijë shprese. Ai na merr në duar me dhembshuri dhe si shkëndijave të strallit, sjell drejt nesh erën e madhe të Perëndisë derisa zjarri i tij të na pagëzojë.

### *A i justifikon qëllimi mjetet?*

Duke lexuar Filipianëve 2:5-6, ku thuhet se Jezusi nuk kapej pas privilegjeve hyjnore zbulojmë edhe faktin se Jezusi nuk shtyhej nga ambiciet e verbëra. Kur synojmë të arrijmë diçka të lartë dhe me vlera të përjetshme e kemi shumë të vështirë të mbajmë ekuilibrin e duhur në metodat nëpërmjet të cilave realizohen këto synime. Për të gjithë ne është e njohur pyetja: “A i justifikon qëllimi mjetet?”

Sigurisht që Jezusin s'mund ta pengonte askush për të përdorur të gjitha mjetet për të arritur synimet e larta që kishte. Por ai kurrë nuk u nxit nga motive të paqarta. Çdonjëri që ka patur mundësinë të punojë në radhët e sistemeve të ndryshme ekonomike apo në ndonjë biznes është ndeshur me metodat shkatërrimtare të përdorura për qëllime ambicioze; ngritje në pozitë apo përfitime financiare,

synime këto që arrihen vetëm në kurriz të të tjerëve. Edhe në kisha sot vihet re një fenomen i tillë. Njerëzit shpesh shfrytëzojnë njëri-tjetrin për të arritur qëllimet e tyre, nganjëherë qëllime plotësisht të pranueshme si ungjillizimi.

### *Metodat për të fituar*

Ungjillizimi i tepruar i ngjan kafshimeve të tërbuara të një peshkaqeni tepër të uritur. Ne fshikullojmë me forcë duke derdhur shumë gjak, dhe duke shuar në këtë mënyrë etjen tonë për statistika. Ekziston një skemë mendimi që thotë: “Rëndësi ka të arrijmë t’i bindim njerëzit që të luten për faljen e mëkateve të tyre. S’ka shumë rëndësi se si ia arrijmë këtij qëllimi. S’është e thënë që ata të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për atë që po bëjnë. Rëndësi ka që ata ta bëjnë këtë gjë.”

Në këtë mënyrë ne kemi bërë të pamundurën për t’i afruar mëkatarët e për t’u ofruar miqësinë tonë këtyre njerëzve që u ka munguar dashuria. Ne e dimë tashmë që këtyre njerëzve duhet t’u afrohem si një tregtar, pa zbuluar qëllimin e bisedës sonë deri në çastin e përshtatshëm psikologjik. Kur vjen ky çast ne prekim me marifet thelbin e bisedës për të parë si do ta presin ata. Pasi e kemi bërë edhe këtë “rit” ne u rekomandojmë literaturën e duhur dhe zhdukemi nga jeta e tyre pa lënë gjurmë. Kjo është si të lësh në rrugë fëmijën e porsalindur me shpresë se do ta gjejë vetë rrugën për te pragu i një shtëpie të huaj, apo me shpresë se dikush do të kujtohet ta gjejë atë një ditë.

Një gjë e ngjashme me një thirrje moderne për shpëtim ndodhi vetëm një herë në Dhiatën e Re, ditën e Rrëshajëve, kur pas predikimit të mbajtur nga Pjetri, tre mijë veta i dhanë jetën Jezus Krishtit. E veçanta e kësaj ngjarjeje qe se nismëtare u bë turma e njerëzve dhe jo Pjetri, i cili nuk bëri ndonjë thirrje. Sot ndodh krejt ndryshe. Ne sot luftojmë ta arrijmë këtë me forcat tona, pa marrë parasysh nëse Fryma e Shenjtë arrin t’i pushtojë njerëzit apo jo. Madje, ka ungjilltarë të cilët spekulojnë me të fshehtat për të tërhequr drejt altarit një numër sa më të madh njerëzish. Unë që e kam kaluar gjithë jetën në kishë i kam provuar në kurriz të gjitha format manipuluese të përdorura, dhe kjo më bën të vuaj shpirtërisht. Le t’i analizojmë disa nga këto forma.

Shpesh predikimet mbyllen me një mesazh përfundimtar që s'ka lidhje fare me brendinë e predikimit të porsabërë. Nganjëherë rrëfimi i një historie të frikshme që është shpikur vetëm për të shkaktuar emocione, i paraprin thirrjes për të dalë përpara dhe për të marrë vendimin mbi Jezusin.

Shpesh, vetë atmosfera joreale që krijohet nga kokat e ulura, sytë e mbyllur, tingujt e lehtë të organos, e pengojnë njeriun të marrë një vendim të çiltër. Në këtë atmosferë forcat psikologjike që s'kanë të bëjnë aspak me çështjen për të cilën bëhet fjalë ndërhyjnë dhe ndikojnë në marrjen e vendimit pa e ndier këtë në zemër e mendje.

Njëherë, kur po i jepja dikujt “lajmin e madh” dhe po i ofroja mundësinë për të marrë një vendim mbi Krishtin, ai më bëri një pyetje që më shtangu. Ai më pyeti: “Po sikur përgjigjja ime të jetë “jo” a do të më kesh më mik?” Ungjillizimi sipas stilit të Jezusit nuk mbështetet kurrë në metodat që çenojnë personalitetin njerëzor apo mohojnë lirinë e individit. Përkundrazi, ai nxit aftësinë e njerëzve për të marrë vendime sa më të drejta e të vullnetshme.

Ungjillizimi sipas stilit të Jezusit nuk përdor kurrë mjete mashtrimi apo forma të pandershme për t'i bërë njerëzit të ndërrojnë besim. Perëndia është e vërteta dhe realiteti. Çdo mjet apo mënyrë që synon të mashtrrojë njerëzit dhe që vepron tinëz, shkel stilin e Jezusit.

Ungjillizimi sipas stilit të Jezusit përqëndrohet te figura e Tij dhe jo tek stilet apo doktrinat e stolisura kishtarë.

Ungjillizimi sipas stilit të Jezusit buron nga thelbi i jetës sonë. Ai kërkon që ne të zbulojmë vetë, me dëshirë jetën tonë, jo vetëm para të krishterëve, por edhe para mëkatarëve.

Po e përsëris edhe një herë. Jezusi, i cili erdhi për t'ua falur mëkatet njerëzve dhe jo për të përfituar prej tyre, nuk përdori kurrë mënyra mashtrimi ndërsa u bënte thirrje atyre t'i binin pas. Shumë lehtë ai mund të kishte mashtruar tagrambledhësin e penduar Zakeun apo sundimtarin e ri të pasur apo edhe turmën e njerëzve të cilën e ushqeu me bukë dhe që më pas kërkuan ta bënin mbretin e tyre. Qëllimit të lartë ai i shërbeu me mjete të ndershme e dinjitoze. Ai nuk udhëhiqej nga ambiciet e ulëta, por nga dashuria dhe bindja ndaj Atit.

# Mirëdita, unë jam Reverend...

*Jezus Krishti ... s'i dha vetes asnjë titull*

Jezusi s'i dha vetes ndonjë titull, e zhveshi plotësisht veten nga gjithçka hyjnore - **kenosisi** i madh. Ai s'i dha vetes emër e famë, as imazh madhështor.

Më kujtohet babai im, ndërsa tundte kokën dhe përsëriste me vete: “Ah, s'do doja gjë tjetër veçse të dija se ç'do të thotë kjo fjalë. Ka diçka të fuqishme këtu. Sa do të doja ta dija!” Ndoshta kjo është arsyeja që ky Shkrim më është ngulitur në mendje dhe më mundon ashtu siç mundonte dhe babain. Gjithnjë më ka pëlqyer të bëhem i respektueshëm. Më pëlqen të shoqërohem me njerëz të mirë, më pëlqen që të tjerët të më kujtojnë gjithnjë për të mirë, më pëlqen ta shoh emrin tim të reklamuar pa gabime, më pëlqen të jetoj në një lagje të mirë, të ngas makinën e markës që më përshtatet dhe të vishem me shije dhe në përputhje me karakterin tim. Por Jezusi nuk kërkoi të respektohej.

Krijimi i imazhit në Shtetet e Bashkuara është kthyer në një biznes shumë të rëndësishëm sot. Kandidatët për presidentë ose njerëz të tjerë, të cilët kanë nevojë për miratimin e publikut harxhojnë miliona dollarë vetëm për të përmirësuar imazhin e tyre. Që të mund të fitojnë besimin e klientëve, pavarësisht nga cilësia e prodhimeve të



tyre, shoqëritë e reklamave harxhojnë biliona vetëm për të na bindur se numri i klientëve të tyre është i madh dhe për të ndërtuar imazhe që të ngjallin besim. Paraqitja e jashtme për amerikanët ka shumë rëndësi.

Por nuk duhet të harrojmë se pamja e jashtme dhe fama janë thjesht mjete për të siguruar epërsi mbi të tjerët apo për t'i manipuluar ata për të arritur synimet tona. Megjithatë shumë njerëz gabojnë, madje dhe ne pastorët. Sikur të paraqitem në zyrën tënde dhe të prezantohem: "Mirëdita, unë jam Reverend Zoti Geil Din Ervin", kaq do mjaftonte që ti të ndiheshe i tronditur dhe i çorientuar, menjëherë do ndryshoje pozicionin, nuk do të shaje e mallkoje më, do hiqje nga tryeza e punës ca materiale leximi, do merrje një pamje tepër formale.

Në të njëjtën mënyrë do të reagoje sikur të mos prezantosh me emër, por të vija i veshur me një kostum të zi dhe këmishë të bardhë. Menjëherë do mendoje se jam ndonjë ministër, sipërmarrës apo predikues. I njëjti rezultat.

Ose thjesht mund të prezantohesha me një zë akademik apo me një ton shenjtëror të ndjekur nga lotë pas çdo fjale duke të lënë përshtypjen e një predikuesi. Përsëri prania ime do të të trondiste.

Njëherë, ndërsa po udhëtoja me avion nga Los Anxhelos në Dallas pata rastin të njihesha me pronarin e një shoqërie prodhimesh elektronike, të cilit fillova t'i flas për Jezusin. Në çastin që ai u ndje i gatshëm për të marrë vendimin e madh, ndaloi për një çast dhe më pyeti se ç'punë bëja. Kur i tregova se isha pastor, ai shtangu në vend dhe mendja filloi t'i sillej rrotull ndërsa mendohej të kujtonte fjalët që kishte nxjerrë nga goja pak më parë. Një grua që qe ulur në krahun tjetër, kur dëgjoji se unë isha pastor thirri nga gëzimi dhe pohoi se kishte kohë që dëshironte të takohej me një pastor për të sqaruar disa gjëra. Njëra nga pyetjet që ajo më drejtoi ishte sa engjëj mund të qëndronin mbi kokën e një gjilpëre. Atëherë biseda me personin e mëparshëm ndryshoi dhe u bë tepër "formale" dhe pesha e atij imazhi jo real, që ishim munduar të krijonim filloi të rëndonte mbi mua.

Akoma më habisin ata libra të shkruar nga njerëz të shquar, që theksojnë me forcë domosdoshmërinë e ruajtjes së figurës së pastorit.

Ata na këshillojnë të mos u japim shumë të njohur njerëzve, që ata të mos na shohin flokë lëshuar apo të na thërrasin në emër. Në këto libra thuhet se njerëzit duhet të mësohen të respektojnë pozitën e një pastori dhe ta nderojnë atë si një profesion. Ndoshta kjo është dhe arsyeja që kur udhëtoj, shpesh takoj shumë pastorë, të cilët ndihen të vetmuar e të zhgënjyer. Por Perëndia nuk ka paracaktuar një jetesë të tillë. Po të lexojmë ungjillin sipas Lukës do shohim se as Jezusi vetë nuk jetoi kështu: Pastaj të gjithë tagrambledhësit dhe mëkatarët i afroreshin për ta dëgjuar. Dhe farisenjtë dhe skribët murmuritnin duke thënë: “Ky i pranon mëkatarët dhe ha bashkë me ta.” (Luka 15:1-2)

Jezusi shpesh bënte veprime të tilla që çënonin emrin e tij të mirë. Ai nuk i druhej opinionit dhe shoqërohej me njerëz të kategorive të ndryshme. Shpesh në grupin e tij ndodhej edhe një ish-prostitutë. Ai bënte gjithçka që u shërbente interesave më të larta të njerëzimit, pa marrë parasysh humbjet e tij:

Një nga farisenjtë e ftoi atë të hajë bashkë me të; dhe ai hyri në shtëpinë e fariseut dhe u ul në tryezë. Dhe ja, një grua mëkatore, kur mori vesh se ai ishte në tryezën e shtëpisë së një fariseu, sollti një enë alabastri plot me vaj erëkëndshëm, dhe, duke qëndruar prapa te këmbët e tij dhe duke qarë, filloi t’ia lajë me lot këmbët dhe t’ia fshinte me flokët e kokës së saj; dhe t’ia puthte e t’ia vajoste me vaj erëkëndshëm. Kur e pa këtë gjë, fariseu që e kishte ftuar, tha me vete: “Nëse ky do të ishte një profet, do ta dinte se çfarë lloj njeriu është gruaja që po e prek, sepse ajo është një mëkatore.” (Luka 7:36-39)

Një farise i mirë s’do ta lejonte kurrë një grua ta prekte e sidomos një grua e tillë si kjo, as do të mund t’i afrohej atij në sy të njerëzve. Por ja, që në këto rreshta të Biblës thuhet se një grua mëkatore iu afrua Jezusit dhe filloi t’i përkëdhelte këmbët me atë mënyrë e mjeshtëri që këto gra zotërojnë. Dhe për çudi Jezusi, në vend që ta qortonte për këtë veprim, qorton Fariseun gjykues dhe e nderon këtë grua e cila ishte penduar për fajet e saj dhe s’rreshtte së puthuri këmbët e tij.

Kam një shok që jeton në një qytet të madh të huaj ku prostitucioni është i lejuar me ligj. Ky është një pastor tepër i nderuar dhe i respektuar, të cilin Perëndia e ka ngarkuar të merret me hallet e këtyre grave. Shpejt ai e kuptoi se askush nuk ishte kujdesur ndonjëherë për to. Edhe ata njerëz që ishin përpjekur t'i ndihmonin, u rrinin larg që të mos njollosnin emrin dhe respektin që gëzonin. Pa marrë parasysh pasojat, ky pastor filloi të hynte në shtëpitë publike më qëllim që të bisedonte e të zinte shoqëri me prostitutat. Fillimi që i vështirë, pasi ato përpiqeshin ta provokonin me erotizmin e tyre, por shpejt arritën ta kuptonin se ai s'ndodhej atje për t'i shfrytëzuar. Kështu që shpejt filluan të miqësoheshin e të flisnin për Jezusin dhe për ngjarjet e jetës së tyre. Ashtu si Jezusi edhe ky pastor, i shtyrë nga dashuria për këto vajza rrezikoi emrin dhe figurën e tij të nderuar.

Po të duam të jemi shtegtarë dhe të huaj në këtë botë, s'kemi përse të luftojmë e të kacavirremi pas atyre gjërave që do të na sigurojnë sukses, famë e pasuri.

### ***Zotërimet janë 9/10 ...***

Me anë të letrës së dytë drejtuar Korintasve, Pali na sqaron se çfarë kuptonte Jezusi me mosvlerësimin e vetes: “Sepse ju e njihni hirin e Zotit tonë Jezus Krisht, i cili, duke qenë i pasur, u bë i varfër për ju; që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij.” (kap.8:9)

Sido që ta interpretojmë këtë thënie, të varfër në shpirt apo të varfër nga ana financiare, përfundimi është tepër tronditës dhe i papranueshëm për natyrën tonë njerëzore. Vetëm pasi të kemi krijuar një konceptim të ri të natyrës së Jezusit do të mund të fillojmë ta kuptojmë përse ai thoshte se më të lehtë e ka deveja të kalojë përmes vrimës së gjilpërës, sesa pasaniku në mbretërinë e Perëndisë. Me sa duket, pasuria përbën pengesën më të madhe për t'iu afruar natyrës së Jezusit dhe për të ecur në rrugën e tij. Për këtë pasanikut i duhet të braktisë shumë gjëra, ndër këto, më të rëndësishmen, pasurinë.

Këshilla e fundit që Jezusi i dha sundimtarit të ri të pasur, i cili ishte treguar i ndershëm gjithë jetën e tij, por pak nga pak po bëhej

skllav i pasurisë, qe: “duhet të bësh edhe një punë; shit gjithçka që ke dhe ndajua të vobektëve.”

Habitem se si shumë njerëz (përfshirë mua), dëshirën e tyre për të qenë të pasur e justifikojnë me pretendimin se, me paratë e tyre do të mund të ndihmojnë nevojtarët, ndërkohë që s’bëjnë as përpjekjen më të vogël për t’i ndihmuar e për t’u shërbyer njerëzve.

Ndryshe qe Jezusi. Ai, jo vetëm i njihte zemrat e njerëzve, por dinte edhe se si ta mposhte dhe t’i bënte ballë tundimit. Mësimet e tij nuk thoshin: “Shkoni e shisni gjithçka që keni dhe ia jepni paratë nëpërmjet organizatës sime, Perëndisë”. Ai s’tha kurrë: “Tregojeni dashurinë dhe devotshmërinë tuaj duke shitur gjithçka që keni e m’i dorëzoni paratë mua, Perëndisë.”

Sundimtari i ri i pasur dukej se i kishte në rregull të gjitha gjërat. Ndoshta zbatimi i mësimëve të Jezusit ishte i vetmi hap që i duhej të bënte për të fituar dashurinë e njerëzve. Por Jezusi nuk u tha të gjithë miqve të tij të pasur të shisnin gjithë pasurinë e tyre e t’ua jepnin atë të varfërve siç i tha sundimtarit të ri. Ai kishte aftësinë e mprehtë për të zbuluar se ku është zemra dhe thesari ynë.

Jezusi, asnjëherë nuk hoqi dorë nga mendimi që kishte për pasurinë, megjithëse edhe vetë nxënësit e tij nuk arrinin ta kuptonin gjithmonë, ndërsa Farisenjtë në veçanti nuk ia vinin veshin fjalëve të tij. Farisenjtë thoshin se kur njerëzit ishin të pasur, Perëndia ishte i kënaqur nga puna e tyre dhe se kur njerëzit ishin të varfër, Perëndia ishte i pakënaqur. Vazhdimisht Jezusi kundërshtonte vlerësimet që bënte bota:

Dhe farisenjtë të cilët ishin shumë të dhënë pas parasë, i dëgjonin të gjitha këto dhe e tallnin. Dhe ai u tha atyre: “Ju jeni ata që e justifikoni veten përpara njerëzve, por Perëndia i njeh zemrat tuaja; sepse ajo që vlerësohet shumë ndër njerëzit është gjë e neveritshme para Perëndisë.” (Luka 16:14-15)

Sa e fortë është akuza ndaj sistemit tonë në frazën e fundit ku thuhet se ajo që vlerësohet nga njerëzit është e neveritshme para Perëndisë!

Natyrë e Jezusit është e kundërta e natyrës së rënë të njeriut dhe njëkohësisht çlirimtare e saj. Ne fjalët e mëposhtme Jezusi ne jep një ide mbi rëndësinë e vërtetë të vlerave:

Këta e pyetën duke thënë: “Mësues, ne e dimë se ti flet dhe mëson drejt dhe që nuk je aspak i anshëm, por mëson rugën e Perëndisë në të vërtetë. A është e lejueshme për ne t’i paguajmë taksë Çezarit apo jo?”

Por ai, duke e kuptuar ligësinë e tyre, u tha atyre: “Përse më provokoni? Më tregoni një denar: e kujt është fytyra dhe mbishkrimi që ka?”.

Dhe ata, duke u përgjigjur thanë: “E Çezarit!”. Atëherë ai u tha atyre:

“I jepni, pra, Çezarit atë që i përket Çezarit, dhe Perëndisë, atë që është e Perëndisë!” (Luka 20:21-25)

Paratë i shkojnë mbretërisë së Çezarit, edhe pse mbi to shkruhen ose jo fjalët “Ne besojmë tek Perëndia”. Paraja është mall i kësaj bote, është simboli ku përqëndrohet gjithë lakmia jonë.

Në kohët që jetojmë, dëshira për “më tepër” i nxit prindërit të merren njëherësh me punë të ndryshme për t’u siguruar familjeve të tyre standarte jetese sa më të larta. Në këtë garë për të arritur më të mirën ata harrojnë se i kanë privuar fëmijët e tyre nga dhuratat më e çmuar, nga kujdesi prindëror.

Vazhdimisht i lutem Perëndisë për një brez, që do të pranojë një standart më të ulët jetese, me qëllim që t’u kushtohen më tepër familjeve të tyre dhe njerëzve të tjerë nevojtarë.

Njerëzit përbëjnë mbretërinë e Perëndisë. Ne mbajmë vulën e tij. Ai na krijoi sipas shëmbëlltyrës së tij dhe ne i përkasim atij. Ai nuk u bë i varfër për të krijuar situata dramatike që t’u bënte përshtypje njerëzve, as për të vënë veten në provë. Jo, ai u varfërua për të mirën tonë - që nga varfërimi i tij të mund të pasuroheshim ne.

### ***Ndërtimi i grazhdeve më të mëdha***

Në jetë ndodh shpesh, që kur marrim vendime praktike, nuk kemi parasysh problemet më të rëndësishme. Por ç’duhet të kemi parasysh kur ndërtojmë një kishë? E dimë të gjithë se në kishën e hershme s’kishte komoditet dhe me siguri Jezusi nuk kërkoi lehtësira. Ato janë bërë që të shkojnë me natyrën e Jezusit vetëm me anë të njohurive dhe të përpjekjeve të kujdesshme.

Kur vendosim të ngremë një kishë, kemi marrë një vendim sociologjik lidhur me faktin se cila shtresë e popullsisë do ta ndjejë veten rehat aty. Kur zgjidhim stilin arkitekturor kemi marrë një tjetër vendim sociologjik. Kur zgjedhim adhurimin që do të përdorim, kemi marrë një vendim tjetër sociologjik lidhur me kush do të adhurojë me ne. Përcaktimi i mënyrës së të veshurit, materialeve të leximit, rregullave dhe normave e kufizojnë më tej numrin e pjesëmarrësve. Metodatat e Jezusit synonin heqjen e këtyre kufizimeve. Ai mirëpriti të munduarit e të vuajturit. Po qe se do t'i mbyllim derën kësaj kategorie njerëzish ne i kundërvihemi natyrës së Jezusit.

Një nga thëniet “e fuqishme” më të urryera që ndërhyjnë në marrjen e vendimeve në lidhje me komoditetet e kishave është: “Jezusi meriton më të mirën.” Edhe unë i këtij mendimi jam, por problemi është se ne nuk do të arrijmë kurrë të kuptojmë se ç’është më e mira pa kuptuar dhe ndjekur plotësisht natyrën e Jezusit. Përndryshe ne do t’ia ngarkonim dëshirën për luks atij që me vendosmëri e shmange lavdërimin e veetes. Mendoj se ajo që po themi është: “Ne kërkojmë më të mirën.”

Kaq shumë e kemi shtrembëruar Ungjillin, sa edhe pjesën më të madhe të të ardhurave e kemi përdorur për komoditete dhe jo në ndihmë të njerëzve. Bota me të drejtë ngre zërin dhe na quan “Egoistë!” Përderisa jemi vetëm kalimtarë në këtë botë, përse duhet të harxhojmë kohën, energjitë dhe burimet tona për ngritjen e ndërtesave, ndërkohë që nevojat e njerëzve mbeten të paplotësuara?

Para se të pranojmë të hyjmë në një ndërtesë apo të miratojmë një projekt ndërtimi, është e nevojshme të bëjmë ca pyetje. A do të na ndihmojë kjo të bëhemi skllëvër më të mirë, apo do të na mundësojë të rrisim sundimin mbi të tjerët? Ç’shembull do të jepnim në një ndërtesë të tillë? A do të karakterizohemi nga përulësia këtu? A do jemi të sinqertë si fëmijët këtu, apo kjo ndërtesë do t’u shërbejë ambicieve tona personale? Sikur të na duhej të financonim vetë për të, a do ta ndërtonim apo do të hiqnim dorë? Mos ndoshta ndërtimi i saj do të cënonte emrin tonë të mirë? A do të jepnim edhe jetën për hir të saj, apo s’do të kishte rëndësi të madhe? Ç’masa do të merrnim për mbrojtjen e ndërtesës nga dëmtimet? A do t’i lejonim njerëzit të ndotnin tapetin e saj, apo s’do t’i linim të shkelnin me këpucë? A do ndiheshin mirë ata duke hyrë këmbëzbathur? A

do të kishite orendi kushtuar njerëzve të tjerë përveç Jezusit? A do ketë podiume apo vende të caktuara për njerëz “të veçantë”? Si do të spikaste në këtë ndërtesë dallimi mes të pasurve dhe të varfërve?

Në qoftë se e ndiejmë se ndërtimi i kishave është i domosdoshëm, atëherë le të heqim dorë nga projektet e teatrove të këtij shekulli, ku e gjithë vëmendja drejtohet nga skena dhe të gjitha ndenjësot vendosen në atë drejtim. Le të projektojmë ndërtesa që do t’i shërbejnë rritjes së bashkëveprimit të trupit të Krishtit dhe do të na japin mundësinë për të dashur njëri-tjetrin. Le ta bëjmë të njohur se bashkësia është aty ku veprohet dhe se qendra e adhurimit është Perëndia dhe jo metodat tona organizative. Le t’i braktisim reklamat në gazeta për të tërhequr sa më shumë njerëz në rrjetin tonë.

Le t’i përdorim efektivisht gjatë shtatë ditëve të javës ndërtesat ekzistuese në shërbim të njerëzve. Dhe po të ndërtojmë të tjera, le të mos kapemi fort pas tyre, pasi çdo gjë që është e destinuar të prishet apo të tronditet, do të prishet dhe tronditet, vetëm e përhershëmja do të mbijetojë.

# Zbritja në Tokë

*Shërbëtor i vërtetë nga natyra,  
i ngjashëm me njerëzit, me pamje njeriu*

Gjatë bisedës me një funksionar të lartë kishtar mësova se atë e frikësonte përshkrimi shumë njerëzor që i bëja unë Jezusit. Ai mendonte se kështu unë rrezikojta t'i afrohesha shumë humanizmit. Vështirë të ndodhte një gjë e tillë, pasi humanizmi nuk pranon dhe njeh hyjni tjetër përveç njeriut. Por Jezusi qe plotësisht hyjnor dhe plotësisht njerëzor. Si i tillë, ai qe njëlloj si unë, me të njëjtat pasione dhe tundime.

Këtë na e zbulon shkrimtari i letrës drejtuar Hebrenjve, i cili shkruan: “Sepse ne nuk kemi kryepriфт që nuk mund t'i vijë keq për dobësitë tona, po një që u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar.” (Hebrenjve 4:15)

Vërtet të tundohej si unë Biri i Perëndisë? Është vështirë ta besosh, por ja që qenka e vërtetë. Nganjëherë, mendoj se tundimet e mia janë krejt origjinale, dhe Jezusi nuk ishte vënë ndonjëherë para provave të tilla. Në fakt ai u vu.

Jakobi shkruan: “Por secili tundohet i udhëhequr dhe i mashtruar nga lakmia e vet.” (Jakobi 1:14)



Mos vallë kjo do të thotë se Jezusi ishte i ndërtuar me të njëjtat epshe si unë? Është e qartë se ne tundo kemi të udhëhequr dhe të mashtruar nga vetë lakmitë tona. Jezusi nuk ra në mëkat. Kjo më jep zemër, pasi duke qenë njeri si unë, ai qe në gjendje t'i bindej plotësisht Atit dhe tani ma përcjell mua aftësinë për t'iu bindur Atit dhe për t'u bërë i pamëkat si ai. Oh, ai qe plotësisht njerëzor, ai djersinte, binte erë, bënte banjë, kryente çdo nevojë personale! Ai qe njeri dhe Perëndi njëkohësisht!

Shembulli i tij më nxit të jem i përlurur, ta pranoj natyrën time njerëzore, të mos shtirem si shpirtëror por të jem realist me veten time, të pranoj faljen dhe të fal të tjerët.

### *Të çlirohesh nga çdo barrë*

Asgjë s'bëhet më rregullisht, sesa pagesa e faturave dhe taksave. Shumë prej nesh, pavarësisht nga dëshira e madhe, nuk arrijmë kurrë t'i shpëtojmë peshës së borxheve. Po kështu, aty nga mosha tridhjetë vjeçare mund të përpilojmë një listë të pafund të gjërave dhe veprimeve që do të kishim dashur të mos i kishim thënë apo bërë gjatë jetës sonë, duke përfshirë edhe padrejtësitë ndaj të tjerëve, të cilat rëndojnë akoma në ndërgjegjen tonë. Në këtë moshë, gjithashtu mund të radhisim padrejtësitë që na janë bërë dhe duke i kujtuar mbushemi me zemërim.

Pesha e borxhit, e padrejtësive dhe e zemërimit trazojnë qetësinë tonë shpirtërore dhe prishin marrëdhëniet miqësore me të tjerët. Vetëm përmes faljes ne mund të çlirohemi nga kjo barrë. Të shërbyerit na mëson se zemërimi dhe urrejtja e gjymton skllavin dhe e bën atë të pavlefshëm. Të shërbyerit synon lirinë që sigurohet përmes faljes së mëkateve. Jezusi vuri si kusht themelor për nxënësit e tij aftësinë për t'i falur të tjerët:

Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: “Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?”

Jezusi i tha: “Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë.” (Mateu 18:21-22)

Zakonisht jam në gjendje të fal deri në tri herë, madje pas faljes së parë tregohem shumë i matur. Por dëshira e Jezusit është që ne ta identifikojmë veten me bashkëbesimtarin, i cili përpiqet të ndryshojë por s’e ka të lehtë. Jezusi kërkon që unë t’u mësoj të tjerëve faljen, duke falur vetë i pari, ashtu siç ua mësoi ai dishepujve të tij, duke iu drejtuar Atit me këto fjalë: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë”.

Jezusi, duke mos marrë parasysh vuajtjet çnjerëzore dhe plagët e thella që i shkaktuam, për t’u pajtuar me ne u mor vesh me të Atin dhe i tha: “Le t’u japim atyre një mësim; t’ua falim gabimin që bënë!” Perëndia më ndihmon që ta dua mëkatarin në mëkat dhe t’ia shfaq hapur dashurinë. Mëkati është shtrembërim i natyrës njerëzore të krijuar nga Perëndia. Falja zotëron forcë të mahnitshme për të ndrequr mëkatin.

Falja shmang distancën midis njerëzve, i bën ata tepër të afërt e të dashur me njëri-tjetrin, duke plotësuar kështu cilësitë e të shërbyerit.

### ***Dashuria e mbështjellë me lëkurë njeriu***

Të pakta janë ato gjëra që mund të na japin kënaqësi e ngrohtësi si të prekurit. Edhe një fëmijë i vogël ua di vlerën. Një natë me stuhi, një nënë shkoi në dhomën e së bijës së frikësuar për ta qetësuar atë dhe i tha: “Mos ki frikë! Jezusi është pranë teje dhe të mbron.” E bija iu përgjigj: “Mirë pra, ti fli në dhomën time me Jezusin, ndërsa unë po shkoj të fle me babin!” Asaj vajze të vogël i mungonte kontakti fizik, një dorë e ngrohtë.

Mishërimi bëri të mundur ardhjen në tokë të mbretit shërbyes, i cili mund të na prekte dhe të cilin do të mund ta preknim. Bibla është e mbushur me dëshmi për të prekurit e Jezusit. Aq e thellë dhe e plotë qe dashuria e tij për njerëzit, sa edhe lebrozët që ishin të paprekshëm e ndjenë ngrohtësinë e duarve të tij. Fëmijët, kafshët dhe toka që ai krijoi qenë frut i prekjës së tij. S’është për t’u çuditur

që, sa herë përmendet në Dhiatën e Re fjala “njëri-tjetrin”, kjo e fundit nënkupton lidhje të ngushta që kanë nevojë për prekje dhe kontakt fizik. S’është për t’u çuditur që larja e këmbëve të Pjetrit nga Jezusi ishte kusht i miqësisë së tyre. S’është për t’u çuditur që vetëm me të prekur (sikur edhe vetëm rrobën e Jezusit) njerëzit shëroheshin. S’është për t’u çuditur që caktimi i priftërinjve kërkon “vënien e duarve”. S’është për t’u çuditur që dhuntitë dhe e drejta e trashëgimisë u kalohej fëmijëve me anë të të prekurit. S’është për t’u habitur që shkrimtari i Letrës së Hebrenjve e konsideronte doktrinën e shtrirjes së duarve si më elementaren.

Kishte raste kur Jezusi ndihej i dobët ndaj prekjes. Në kopsht, pas ringjalljes, ai iu lut Maria Magdalenës të mos e prekte, pasi akoma s’kishte shkuar tek Ati në qiell. Duke qenë në mish, ai e kishte të vështirë të përballonte përkëdhelitë e saja femërore.

Gjatë qëndrimit të tij në tokë, Jezusi qe dashuria e mbështjellë me lëkurë njeriu. Edhe sot e kësaj dite saga e mishërimit vazhdon, ndërkohë që Jezusi na mbron ne para Atit. Libri i Hebrenjve na kujton se atij i vjen keq për dobësitë tona.(4:15)

# Bëmë Baba të të Ngjaj

*Ai u tregua i përulur dhe i bindur*

Gjithnjë kam patur një koncept të gabuar mbi bindjen. Sipas meje, bindja i ngjante një përgjegjësie apo kërkesë të padëshiruar, e nganjëherë edhe të padrejtë që e zbatojmë për hir të një personi më të fuqishëm dhe më me pozitë se ne. Por ky nuk qe koncepti mbi bindjen që e udhëhiqte Krishtin në jetën e tij. Cili ishte ndryshimi?

Bindja ngjallte gëzim tek Jezusi, pasi kishte të bënte me vërtetësinë e natyrës fillestare njerëzore të krijuar nga Perëndia sipas shëmbëlltyrës së Tij, por që Adami dhe Eva e përdhosën me dëshirën e vet. Shenjë e veçantë e jetës së Jezusit ishte bindja e plotë ndaj Atit: “Në të vërtetë, po ju them se Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes, përveç asaj që sheh se bën Ati; gjërat në fakt që bën Ati, i bën po ashtu edhe Biri. Sepse Ati e do Birin dhe i dëftën gjithçka që bën vetë” (Gjoni 5:19-20).

Meqenëse Jezusi po zbulonte natyrën e Perëndisë, atëherë duhet të pranojmë se tiparet që e karakterizojnë Jezusin na përshkruajnë Perëndinë e gjithë krijesës. Perëndia dhe Biri i Tij janë për ne shembuj të të shërbyerit, përlësisë dhe sinqeritetit, që e identifikuan veten me fëmijët, të vegjlit dhe të fundit, që nuk përdorën forcë mbi të tjerët dhe gjithmonë dhanë nga vetja. Këto tipare, të motivuara

vetëm nga dashuria ishin, jo vetëm parime udhëheqëse, por dhe urdhëresa në jetën e Jezusit. Ai i konsideronte këto parime të shenjta dhe kurrë nuk i shkelte.

Jezusi për hir të dashurisë për njerëzit dhe për t'u shërbyer atyre pranoi t'i bindej Atit edhe në Gjetsemani, ku çmimi që duhej të paguante për mëkatet tona arriti kulmin. Në pikën më kritike ai zgjodhi të sakrifikonte veten e tij, për të na treguar dashurinë dhe vërtetësinë e Atit.

Duke qenë egoist nga natyra shpesh dështoj kur dua të marr vendime në të mirë të të tjerëve. Jezusi e njihte të fshehtën e të bindurit që sillte gëzim. Tek Ungjilli sipas Mateut, ai u zbulon me pak fjalë nxënësve të tij mesazhin më të përmbledhur të Perëndisë, atomin fillestar mbi të cilin u ndërtua gjithçka tjetër:

“Në qoftë se dikush do të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë. Sepse ai që do të dojë ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë atë.”

(Mateu 16:24-25)

Sikur të mund ta zbatoja plotësisht këtë parim në jetën time, s'ka dyshim që të gjitha parimet për të cilat kemi folur do të gjenin zgjidhje. Ky është thelbi i veprimtarisë së Perëndisë, thelbi që mban universin të bashkuar, thelbi që siguron vazhdimësinë e funksionimit të trupit tim dhe trupit të Krishtit, gjithashtu. Kështu, nëpërmjet zbatimit të tij në jetë, pushteti i Perëndisë vepron tek unë. Kjo s'është aspak misterioze apo mistike dhe ndryshe nga paragrafët e tjerë nuk ka dramën, prandaj unë s'e kam të vështirë ta harroj e ta lë pas dore.

Përpjekjet e mia për të zbatuar parimin e vetësakrifikimit kanë dhënë rezultate më të frytshme se çdo parim tjetër. Ky parim e ka ndryshuar jetën time në mënyrë rrënjësore. Çdo prirje egoiste që më trazon jetën dhe më shkakton vuajtje mund të mposhtet vetëm kur filloj të jetoj sipas vullnetit të Perëndisë, kur prek atomin që më nxit të veproj i shtyrë nga dashuria për të tjerët.

Edhe dhuntitë karizmatike, të cilat shfaqen me shumë gjallëri i nënshtrohen këtij parimi. Asnjëra prej tyre s'duhet të përdoret për ambiciet tona egoiste, por për ndërtimin dhe forcimin e trupit.

Dhuntitë e të shërbyerit duhet të përdoren për të pajisur të tjerët. Çdo veprim që nuk është në të mirën e të tjerëve kundërshton vullnetin e Perëndisë dhe dëmton trupin e Krishtit.

Respekti dhe nderimi ynë për Perëndinë shpesh është njollosur, ngaqë shumë nga kërkesat tona për shenjtërinë janë kthyer në pretendime thjesht personale, që nuk i shërbejnë sa duhet marrëdhënieve mes njëri-tjetrit.

Ndërsa merrja pjesë në një festival të Krishterë, pata rastin të shkëmbej disa mendime mbi problemet që kisha trajtuar në një rën nga seancat e pasdites me dy çifte të martuarish, njëri prej të cilëve ishte Budist. Aty nga mesi i bisedës njëri nga të krishterët ndezi një cigare, dhe më pas kërkoi falje duke u justifikuar se po bënte përpjekje për ta lënë duhanin, pasi ky ves do të prishte dëshminë e tij.

Gruaja Budiste bëri një deklaratë, që edhe sot e kësaj dite më rrënqethet mishi kur e kujtoj. Ajo tha: “Kur disa nga ne jo të krishterët bëhen të krishterë, ne nuk shohim se sa të devotshëm tregohen ata, duke jetuar sipas disa normave që vetë i kanë vendosur për shenjtërimin e tyre, por hapim sytë e shohim se si fillojnë të sillen me njerëzit.” Duke dëgjuar atë grua m’u duk sikur kisha dëgjuar vetë Perëndinë. Farisenjtë mund të hidhnin mbi Jezusin akuza të ndryshme, ata mund ta akuzonin atë si pijanec apo grykës, por nuk mund t’i mohonin atij dashurinë që tregonte për njerëzit. Ai kishte fituar mbi ta, pasi i ishte bindur Atit të tij.

### *Një slogan i çuditshëm*

Forca për t’u bindur Atit, Jezusit i erdhi përmes vajosjes së Frymës që derdhi mbi të Ati. Vajosja shpesh nuk kuptohet siç duhet. Kam dëgjuar se në të shkuarën kjo fjalë përdorej si një slogan i çuditshëm. Kur një pastor e ndjente se kishte *vajosjen me Frymën*, reagimet fizike shfaqeshin menjëherë tek ai. Zëri i tij ngrihej në maksimum, goditjet mbi bangon nga ku fliste shtoheshin. Në mënyrë të ngjashme, kur një bashkësi fliste për një pastor që ishte i vajosur, s’kishte të bënte fare me atë që po thoshte ai, por në vend të kësaj ishte një mënyrë për të përshkruar stilin me të cilin predikonte.

Le të shikojmë se ç’efekt pati vajosja te Jezusi. Fillimisht, Fryma e dërgoi atë në shkretëtirë, ku ndërsa agjëronte tundohet dhe vihet

në provë nga djalli. Aty ai njih forcën e sendeve që na mposhtin ne. Aty ai provon të njëjtat situata që na duhet të përballojmë dhe zbulon dobësitë tona. Më pas, fitimtar mbi djallin, ai kthehet në sinagogë ku i dorëzojnë librin e profetit Isaia dhe ai lexon:

“Fryma e Zotit është mbi mua,  
sepse ai më vajosi për të ungjillizuar të varfërit;  
Ai më dërgoi për të shpallur çlirimin e të burgosurve  
dhe kthimin e të parit të verbërve,  
për të çliruar përsëri të shtypurit,  
dhe për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit.”

Luka 4:18-19

Ja si ndikoi vajosja tek Jezusi. Ajo e bëri atë të përmbushte natyrën e tij, duke iu bindur plotësisht vullnetit të Atit.

Vajosja e shenjtë si e ndryshme nga vajosja mjekësore apo nga format e ndryshme shoqërore ka një kuptim të veçantë - t’i përkushtohesh Perëndisë, të veçohesh dhe fuqizohesh për kryerjen e misionit të caktuar. Fjala *Mesia*, ose *Krishti* do të thotë “i vajosuri”. Me fjalë të tjera, Jezusi ishte përkushtuar plotësisht, ishte zgjedhur nga Ati dhe kishte fuqinë e Tij, jo për të ngritur zërin apo për të folur rrjedhshëm, por për të bërë diçka - për të shpallur lajmin e mirë, për të çliruar të burgosurit, për t’u kthyer dritën të verbërve dhe për të çliruar të shtypurit. Kështu do të veprojë vajosja edhe tek unë po qe se do të ec në rrugën e Jezusit.

Përveç këtyre detyrave, vajosja e ngarkoi Jezusin të shkonte midis të varfërve, të burgosurve, të verbërve dhe të shtypurve - lloji i shoqëruesve shumë më pak tërheqës. Asnjëri nga këta njerëz nuk ishte në gjendje ta shpërblente Jezusin për shërbimet e tij. Ata vetëm do mund të përfitonin prej tij. Bindja kërkon të japësh, më tepër sesa të marrësh.

Të shohim se në shërbim të cilëve njerëz do na ngarkojë ne vajosja, dhe çfarë do të na duhet t’u themi.

### ***Me kë është Perëndia?***

*Lajmi i mirë për të varfrit.* Mua do më pëlqente më tepër t’ua shpallja lajmin e mirë të pasurve, pasi edhe rezultatet janë më të

mira. Të varfërit ngaqë rrallë marrin lajme të mira s'dinë si të reagojnë. Kur u vjen diçka e mirë, ata e humbasin arsyen dhe e shpërdorojnë atë. Kam bindjen se gjendja e tyre është e pashpresë, po qe se ata nuk mësojnë se si duhet të reagojnë ndaj ndihmës që u ofrohet. Por ja që vajosja e ngarkoi Jezusin së pari t'u shpallte lajmin të varfërve.

*Liria për robërit.* Kur ka qenë hera e fundit që keni qenë në burg për të vizituar dikë? Ne na zë turpi kur ndonjë i njohur apo i afërm i yni ndodhet në burg.

Po të mendosh si unë do të shprehesh kështu: "Përse të shkoj të takoj një të burgosur? Drejtësia ka gjykuar veprimet e tij dhe mendoj se izolimi nga njerëz si unë është pjesë e dënimit dhe rehabilitimit të tyre." Kjo detyrë e vajosjes ka diçka që më shqetëson jashtë mase.

Jo për të gjithë njerëzit që dergjen brenda burgjeve zbatohet drejtësia. Shumë prej tyre, meqë s'kanë të ardhura për të vazhduar proceset gjyqësore lihen në harresë edhe pse duhej të ishin liruar prej shumë kohësh, sikur drejtësia të vepronte njëlloj për këdo. Burgjet janë vendet ku njerëzit harrohen dhe humbin çdo perspektivë. Ja përse Jezusi kërkonte të harruarit dhe shkante tek ata.

Edhe pse me veprimet e tyre ata e kanë zhgënjyer shoqërinë dhe duhet të vuajnë dënimin, s' duhet të harrojmë se janë njerëz dhe Jezusi për njerëzit zbriti në tokë. Pasi luajti rolin e të burgosurit në filmin "Porta e ujit", Çak Kolsoni, si ekspert juridik, u njoh nga afër me padrejtësitë që u bëheshin shumë prej të burgosurve. Zbulimi i këtij realiteti ndryshoi aq shumë qëndrimin e tij, saqë, nga këshilltar presidencial që qe, u bë pastor i të burgosurve në emër të Jezusit.

Burgjet nuk janë mjedise të përshtatshme për formimin e një personaliteti të shëndoshë apo të një figure të lartë morale, edhe pse ne e dëshirojmë këtë gjë për të dashurit tanë. Jezusi e arriti këtë, ai zbriti për të çliruar të burgosurit.

Po të mos ju vijë përshtat ky përcaktim që po u bëj burgjeve reale dhe do të donit t'i trajtonit në kontekstin e zgjedhës shpirtërore, po ju them se është e njëjta analogji. Shumë njerëz janë dhënë pas drogës, alkolit, bixhozit e korrupsionit. Izolimi ynë nga këta njerëz është po aq i madh sa dhe izolimi pas hekurave të qelive. Për t'u dhënë zemër, ne u thërrasim atyre që nga larg apo pas hekurave, u



themi se janë të lirë, pa u ofruar miqësinë tonë, e cila mund t'i bindë ata për deklaratën tonë.

Të burgosurit nga mëkati dhe të burgosurit e qelive vuajnë turpin e opinionit, dyshimin dhe mosbesimin e njerëzve që i rrethojnë edhe pasi janë liruuar. Sapo fillojmë t'u shërbejmë e kuptojmë sa shumë kohë dhe energji na duhet t'u kushtojmë.

Personalisht kam bindjen se, para se të mund t'u shpallim lirinë të burgosurve duhet të kemi vajosjen e Frymës mbi vete dhe duhet t'i duam njerëzit.

*Kthimi i dritës së syve të verbërve.* Njëri nga argumentet që shpesh shtroj para Perëndisë është zhgënjimi që ndiej në vetvete, pasi nuk arrij t'i shëroj njerëzit me lutjet e mia. Ndërsa argumenti që shtron Perëndia para meje është se, jo vetëm që nuk tregohem sa duhet këmbëngulës në lutjet e mia, por as ndjek shërimin e tyre këmba-këmbës. E kam të vështirë ta kuptoj shërimin, edhe pse vetë kam parë shumë raste shërimi, sa të besoj se s'janë gjithmonë të shpjeguara psikologjikisht. Por kam parë edhe aq shumë raste shërimi të njerëzve sa të bindem se teologjitë që e shpjegojnë mosshërimin si mungesë besimi nga ana e të sëmurit janë të pabazuara. Ndërsa shkonte vend më vend, Jezusi shëroi me lehtësi shumë njerëz. Kishte vende ku ai i shëroi gjithë të sëmurët. Nuk besoj se njerëzit e asaj kohe besonin më shumë se sa besojnë njerëzit sot tek Perëndia. Edhe kur vinte re se i sëmuri shprehte rastësisht mosbesim, Jezusi vazhdonte ta shëronte. Të vetmet vende ku ai nuk ushtroi forcën e tij shëruese ishin ato ku spikaste mosbesimi i shumicës.

Sot, kur njerëz të lënduar i drejtohen Jezusit apo kërkojnë që njerëzit të lutem për ta, nuk do të thotë se atyre u mungon besimi. Disa shërohen, por jo të gjithë. Mos vallë duhet t'i përzëmë ata njerëz me predikimin qortues se besimi i tyre nuk është i mjaftueshëm? S'më duket aspak e drejtë dhe nuk është qëndrimi që do mbante Jezusi. Unë nuk e kuptoj përse disa shërohen dhe disa të tjerë jo, por ashtu siç më ka urdhëruar Zotëria Shërbëtor, unë do vazhdoj të lutem për të sëmurët (dhe të verbërit) dhe shërimin e tyre do t'ia lë në dorë Zotit. Ndërkaq, cila do jetë shërbesa ime ndaj të verbërve (fizikisht dhe shpirtërisht) gjatë procesit të

shërimit? Unë do të ec përkrah tyre, do t'u prij rrugën e t'i mbroj nga rreziqet, do t'u flas që të përtërihen shpirtërisht dhe do t'i mbaj në lidhje të vazhdueshme me Shëruesin. Të më falni për egoizmin tim, por e pohoj se më pëlqen që jam i pari person (fizik apo shpirtëror) i verbër që faktikisht sheh.

*"T'u sjellësh lirinë të shtypurve"*. Njerëzit e shtypur mbeten një enigmë për ne. Ne duam t'i ndihmojmë ata, por ata vazhdojnë të na frikësojnë me veprimet e tyre ose s'e pranojnë ndihmën tonë e na e përplasnin në fytyrë me arrogancë. Ndaj pa u menduar gjatë ne arrijmë në përfundimin se ata e meritojnë të jenë të shtypur.

Pavarësisht nga ky fakt, zemra e kishës duhet të rrahë gjithmonë bashkë me zemrën e të shtypurve. Por nuk ndodh kështu gjithmonë, bile ç'është më e keqja, nganjëherë vetë kisha bëhet burim shtypjeje. Të përjashtosh individin për shkak të ngjyrës apo statutit të tij dhe të mbështetësh ato institucione dhe organizata që veprojnë kështu, do të thotë të kundërshtosh natyrën e Jezusit, të mos i bindesh Atit dhe të pengosh Frymën që të veprojë mbi ne. Shpresoj që këto veprime të mos justifikohen me emrin e Jezusit, pasi kjo do të ishte e pafalshme.

Shumë prej nesh, në kishë humbëm një rast të artë në vitin 1960, kur radikalistët shqyrtuan çështjen e lirisë të të shtypurve. S'dua t'ia di fare nëse prapa çështjes së të shtypurve ata fshihnin synime të dyshimta apo përdorën metoda të gabuara. Ne të parët duhej ta mbështesnim propozimin e tyre për t'u shpallur lirinë të shtypurve, pasi kjo përputhej me dëshirën tonë. Fakti që ne nuk ushqenim simpati për radikalistët na pengoi të merrnim një vendim të tillë. Më pas, arritëm deri aty sa të identifikonim si radikalistë dhe me ide komuniste çdonjërin që përpiqej t'u shpallte lirinë të shtypurve. Jezusi s'donte t'ia dinte se kush ishin ata njerëz që mbronin të shtypurit. Ai vetë e dinte që ishte me ta. Unë e kam kuptuar se mundohem shumë të ruaj emrin tim të mirë. Ndoshta është më mirë ta zhvesh veten nga çdo meritë, ashtu siç bëri Ai.

Ana tjetër e medaljes ka të bëjë me çlirimin e njerëzve të plagosur e zemërthyer. Kur dikush na qëllon, vendi i goditur nxihet dhe na dhemb. Nga dhimbja që ndiejmë mundohemi të mos i lëndojmë vendet e nxira të trupit. Po të vazhdojnë të na godasin ne tërhiqemi më

tepër në mbrojtje, sa më në fund mbështillemi si kërmilli në guackë tepër të mbrojtur plagët tona.

Më kujtohet që pas një zhgënjimi që pësova në dashuri u betova se nuk do të lidhesha më me askënd tjetër. Arrita deri aty sa rrezik s' do të bija në dashuri me ndonjë vajzë tjetër. Shpesh plagët dhe zhgënjimet që pësojmë në jetë na shkëpusin nga të tjerët, nga dashuria dhe përkujdesjet për ta dhe jeta jonë përqëndrohet në vetëmbrojtjen. Një jetë e tillë sjell vdekjen dhe skllavërimin tonë trupor e mendor. Përmes vajosjes së Frymës Jezusi na bën thirrje t' i zbulojmë me kujdes dhe t' i kurojmë plagët, që njerëzit të jenë të lirë të jetojnë pa vetëmbrojtje.

Tek ungjilli i Mateut (7:3-5), Jezusi na këshillon të mos përpiqemi të heqim lëmishten nga syri i tjetrit, kur kemi traun në syrin tonë. Kjo këshillë simbolizon mënyrën se si duhet t' u afrohemi njerëzve të lënduar nga jeta. Ne s' duhet t' u afrohemi duke i gjykuar për gabimet, pasi kjo do t' i bënte të tërhiqeshin nga frika.

Sidoqoftë, dhimbja që kam ndier kur të tjerët më kanë hequr traun nga syri më ndihmon të tregohem tepër i kujdesshëm me të tjerët që kanë një lëmishtë. Dhe unë vetë s' do t' i drejtohem kurrë për ndihmë një "mjeku" që për vete ka dy trarë në sy.

*Shpallja e vitit të mëshirës së Zotit.* Shpesh pyes veten se çfarë s' dinë njerëzit nga jeta ime dhe çfarë s' përputhet me vullnetin e Perëndisë? Sikur unë të isha njeri nga pjesëtarët e grupit që do të kapte në flagrancë gruan kurorëshkelëse, a do ta qortoja atë ashpër dhe a do të votoja që ta ndëshkonin duke e qëlluar me gurë?

Si një ungjilltar i ri, u enda lart e poshtë për t' u bërë të njohur njerëzve se bota ku jetojmë është e mbushur me ligësi. Ata e dinin mirë këtë. Zemrat i dënojnë ata tashmë. Unë mendoja se mënyra se si po ua thosha ishte e ndryshme dhe më e fuqishme.

Më pas, dëgjova Jezusin që më tregoi se përmes vajosjes unë do të jem në gjendje t' i them botës se Perëndia i do dhe është me ta. Sa ndryshonte mesazhi im nga ai që bota dëshiron të dëgjojë!

Fryma e Shenjtë që vajosi Jezusin përputhej plotësisht me natyrën e tij dhe të Atit dhe rezultati ishte përkushtimi, bindja dhe vënia plotësisht në shërbim të njerëzimit. A nuk do të veprojë njëlloj tek unë vajosja?

# Bariu i Mirë Nuk e Braktis Kopenë

*Ai u tregua i përvulur dhe iu bind edhe  
vdekjes - bile vdekjes në kryq*

“Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij” (Gjoni 15:13). Kjo është prova përfundimtare e dashurisë. A thua jam në gjendje edhe unë ta jap jetën time vullnetarisht? Është e rëndësishme të theksojmë se askush nuk e detyroi Jezusin të vepronte kështu. Dashuria nuk mund të imponohet, askush nuk të shtrëngon të dashurosh. Skllavëria vendoset me forcë, ndërsa të shërbyerit është një zgjedhje e bërë nga dashuria. Prandaj, vendimi për të sakrifikuar vetveten që një zgjedhje që Jezusi e bëri i shtyrë nga dashuria për njerëzit.

“Unë jam bariu i mirë; bariu i mirë jep jetën e vet për delet. Kurse rrogëtari, që nuk është bari, dhe delet nuk janë të vetat, sheh ujku që po vjen, i braktis delet dhe ikën; dhe ujku i rrëmben dhe i shpërndan delet. Rrogëtari ikën sepse është rrogëtar dhe nuk do t’ia dijë për delet.”

“Unë jam bariu i mirë, dhe i njoh delet e mia dhe ato më njohin mua, ashtu siç më njeh Ati mua dhe unë e njoh Atin dhe lë jetën time për delet. Unë kam edhe dele të tjera që

nuk janë të kësaj vathe; duhet t'i mbledh edhe ato, dhe ato do ta dëgjojnë zërin tim, dhe do të jetë një tufë e vetme dhe një Bari i vetëm. Prandaj Ati më do, sepse unë e lë jetën time që ta marr përsëri. Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja; unë kam pushtet ta lë e pushtet ta marr përsëri; ky është urdhri që kam marrë nga Ati im." (Gjoni 10:11-18)

Forca për të sakrifikuar veten për të tjerët mund të burojë vetëm nga njohja e thellë e Atit dhe dëgjimi i zërit të tij. E rëndësishme për delet sot është ta dëgjojnë Atë, të jenë në gjendje të dallojnë tingullin e Tij, thirrjen që na bën për t'u shërbyer të tjerëve, duke kuptuar se t'i bindemi fjalës së Tij nuk do të thotë kursesi të çenojmë të drejtat e të tjerëve, të shtyrë nga interesat tona. Jezusi që i bindur se vdekja nuk do t'i sillte fundin, por fillimin e një bote krejt të re.

# Një e Papritur e Këndshme

*Për këtë arsye Perëndia e lartësoi*

Mënyra se si analizohet natyra e Jezusit më frikëson pak si njeri i zakonshëm që jam. Edhe pse asnjë nga cilësitë që e karakterizojnë nuk shërben për të pushtuar botën, prapëseprapë ai na urdhëron të bëjmë dishepuj prej të gjithë popujve. Si mund ta bëjmë të njohur emrin e tij pa patur pushtet, ndikim, apo para? Si mund të ketë sukses një sistem i tillë jo vetëshërbyes?

Në fundin e çdo paragrafi të dhënë më poshtë, Perëndia na radhit edhe një herë tiparet e Jezusit. Përmes tyre, Ai na njuh edhe me synimet e Tij. Në fragmentin e shkëputur nga kapitulli i dytë i Filipianëve Pali tregon se çfarë arrin po të ndjekësh në jetë shembullin e Jezusit, e t'i bindesh Atit:

Prandaj dhe Perëndia e lartësoi madhërisht  
dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër  
që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave  
(ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore,  
dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot,  
për lavdi të Perëndisë Atë.

Filipianët 2:9-11

Duke lexuar këta rreshta arrij në përfundimin se po të jetojmë sipas shembullit të Atit do të arrijmë dhe rezultatet e Tij. Ne s'kemi fuqi ta pushtojmë botën vetë, prandaj duhet t'i afrohemi asaj me një mënyrë të tillë, që t'i hapë rrugë Perëndisë ta përdorë fuqinë e Tij përmes nesh.

Kam parë njerëz që edhe pse nuk e ndiqnin shumë stilin e Jezusit arrinin të korrnin sukses në qarqet fetare. Kjo më shqetësonte shumë, pasi nuk i shihja gjërat në perspektivë. Suksesi i tyre ishte tepër i vogël në krahasim me ç'ka mund të kishin arritur. Ne mund të arrijmë sukses me forcat tona, por ky kushtëzohet dhe kufizohet gjithmonë nga aftësitë tona njerëzore, ndaj ne s'do mund të përmbushim dot detyrat që na janë ngarkuar. Vetëm po të jetojmë sipas stilit të Jezusit, suksesi ynë do kufizohet vetëm nga aftësitë e Perëndisë.

Ai nuk do t'i përshtatet kurrë logjikës sonë njerëzore, por do t'i përshtatet besimit tonë dhe pa dyshim do të kërkojë që ne t'i besojmë atij, pasi ai është besnik ndaj nesh dhe do ta mbajë premtimin e dhënë. Ja se si na drejtohet ai: "Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk e di ç'bën i zoti; por unë ju kam quajtur miq, sepse ju bëra të njihni të gjitha gjërat që kam dëgjuar nga Ati im." (Gjoni 15:15)

Ja dhe rezultati i lavdishëm. Tani ne dimë si të lutemi. Ne dimë si të dashurojmë. Tani e dimë burimin e forcës sonë dhe dimë se si duhet ta përdorim atë.

# I Plotfuqishmi

*Jezusi e dinte se Ati i kishte dhënë  
pushtet të plotë mbi gjithçka*

Njëherë po ndiqja një program televiziv, ku po intervistoheshin disa pretendentë për një çmim të veçantë në badi-bilding. Ndërsa shfaqeshin në skenë muskujt u dallgëzoheshin nën lëkurën e vajosur si ca kafshë të vogla në garë me njeri-tjetrin. Paraqitja e forcës së tyre ishte e mahnitshme. Pyetjes se përse e përdornin gjithë atë forcë, ata i përgjigjeshin pa fjalë, duke marrë poza për të shfaqur edhe një herë formën e muskujve të tyre. Sa më shumë që këmbëngulte intervistuesi në pyetjen e tij, aq më tepër poza merrnin ata. Po ju, përse do ta përdornit një forcë të tillë?

Në çerekun e fundit të këtij shekulli, figura e Supermenit u bë pjesë e kulturës amerikane. Ai u shfaq për herë të parë në një libër komik, pastaj në një serial televiziv dhe së fundi aventurat e tij u shfaqën në një seri filmash të kushtueshëm. Jemi të rrëmbyer prej tij se ai është më i shpejtë si plumbi, më i fuqishëm se lokomotiva, që i kapërcen ndërtesat shumëkatëshe me një kërcim. Ne na pëlqen të jemi të fuqishëm dhe forca e Supermenit i përshtatet shumë fantazive tona. Po përse do ta përdornim gjithë atë forcë?



Ç'bën Jezusi? Tek kapitulli i 13 i Ungjillit sipas Gjonit, Jezusi e ka kuptuar se çasti vendimtar ka ardhur. Ai bëhet gati t'u shfaqë nxënësve “dashurinë e tij të plotë”. Ai e di se Perëndia e kishte dërguar dhe se tek Ai do të kthehej përsëri. Ai e di gjithashtu se Ati i kishte dhënë pushtet mbi gjithçka. Ç' do ndodhte pra në këtë çast vendimtar? Mos vallë fishekzjarret do të përfllaknin qiellin? Mos forca e gjallë do të manifestohej më e plotë se kurrë më parë?

A mund ta përfytyroni Jezusin bashkë me nxënësit e tij të ulur rreth tryezës, me muskujt e fryrë të krahëve nën rrobën e gjerë, me pelerinë hedhur krahëve? Forcat e së keqes kishin muaj që po komplotonin për të organizuar vrasjen e tij, por ai as që donte t'ia dinte, pasi një fuqi e jashtëzakonshme gjallëronte trupin e tij. Ai ngrihet në këmbë, u afrohet nxënësve të tij dhe me forcën e tij të jashtëzakonshme...a e dini se çfarë nis të bëjë? “Ai u ngrit nga darka dhe hoqi rrobat e tij, mori një peshqir dhe u ngjesh. Mbase hodhi ujë në legen, filloi të lante këmbët e dishepujve...” Ja se si e përdorka forcën! Për të larë këmbët! Ne nuk kemi një zakon me të cilin ta krahasojmë larjen e këmbëve.

Larja e këmbëve ishte një shenjë mikpritjeje dhe bëhej nga shërbëtori ose i zoti i shtëpisë, kur ky ishte i varfër dhe nuk mund të paguante një shërbëtor. Larja e këmbëve konsiderohej si një veprim i ulët dhe jo dinjitoz, prandaj nuk kryhej nga persona të rëndësishëm. Është një lloj sikur Presidenti i Shteteve të Bashkuara të pastrojë banjot e Shtëpisë së Bardhë, apo mbreti i një vendi të fshijë rrugët.

Askush nuk do të pranonte të bënte një punë të tillë kaq të ulët, që do të rrezikonte dinjitetin e tij, po qe se kjo nuk do t'i përshtatej natyrës së vet. Jezusi e njihte mirë veten, ndaj nuk i duhej të jepte prova. Ai mund të bënte punët më të rëndomta pa e ndier veten keq.

Po të isha në vendin e Jezusit do të ngrija pakëz njërën këmbë, që të mund ta shihnin të gjithë nxënësit, dhe duke u kollitur me nervozizëm do t'u lija të kuptonin se diçka e rëndësishme kishte mbetur pa bërë. Një punë e tillë s'ishte e denjë për mua.

Pjetri e kuptoi se larja e këmbëve çenonte dinjitetin e Jezusit, prandaj i erdhi rëndë të pranonte një shërbim të tillë prej tij. Ai i

pohoi Jezusit se kurrë nuk do ta linte që t'ia lante këmbët. Përgjigjja e Jezusit flet shumë për marrëdhëniet tona me të dhe me njëritjetrin, ashtu si edhe për natyrën e tij të vërtetë: “Po nuk të lava, ti nuk do të kesh pjesë tek unë”. Në qoftë se nuk do të arrijmë ta kuptojmë drejt natyrën e Jezusit dhe nuk do t'i lejojmë atij të jetë për ne ashtu si duhet të jetë, ne nuk do të mund ta njohim dhe s'do të bëhemi dot plotësisht pjesë e tij. Ne mund të bëhemi anëtarë të klubit të tij dhe të përdorim fjalorin e duhur, por kurrë nuk do të mund të krijojmë lidhje të ngushta me të, po qe se nuk i lejojmë atij të na shërbejë.

Përgjigjja e Pjetrit është tipike si përgjigjet që i kthejmë ne njëritjetrit. Ne shpesh arsyetojmë: “Jemi miq, por s'ke pse të dish gjithçka për mua”. “Unë do t'ia laj vetë këmbët e mia, ndërsa ti mund të m'i shpëlash, meqë kështu është zakon.” Ndoshta, duke mos i lejuar Jezusit të na lajë këmbët prishim dhe lidhjen e ngushtë me të dhe me të tjerët, pasi kështu nuk plotësojmë urdhëresën e tij. Ne duhet të pastrojmë njëritjetrin, t'i shkundim pluhurin e udhëtimeve të përditshme, që të jemi të pastër kur të ulemi në sofrën e Zotit.

Kështu, mbasi ua lau këmbët, mori përsëri rrobat e tij, zuri vend rishtaz në tryezë dhe u tha atyre: “A e kuptoni këtë që ju kam bërë?”

Ju më quani Mësues dhe Zot, dhe mirë thoni, sepse jam. Në qoftë se unë, Zoti dhe Mësuesi, ju kam larë këmbët, edhe ju duhet t'ia lani këmbët njëritjetrit. Unë, në fakt, ju kam dhënë shembullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju. Në të vërtetë, po ju them: “Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar.”

(Gjoni 13:12-16)

Disa njerëz mundohen ta interpretojnë këtë si një rit të ri që Jezusi po institucionalizonte, një shërbim të vërtetë të larjes së këmbëve. Nuk më pëlqen t'ia hyj diskutimeve me ata që mendojnë kështu, por di të them se kam pasur rastin të marr pjesë në shërbesa të larjes së këmbëve dhe kam ndier një atmosferë të vërtetë

gjallëruese. Sidoqoftë, s' më ka ndodhur të marr pjesë në një shërbesë ku të ekspozohen këmbë të palara. Ne jemi aq të kujdesshëm sa t' i lajmë mirë këmbët tona para se shenjtët t' i shohin, t' i nuhasin apo t' i prekin ato.

Personalisht, nuk besoj se Jezusi po shtonte një rit të ri fetar. Ai po na jepte një shembull konkret se si duhet të sillemi me njëri-tjetrin. Në qoftë se nuk është vërtet fjala për të larë këmbët, atëherë ç' duhet të bëjmë për ta përmbushur këtë urdhëresë të tij? Përgjigjja mund të jetë një pyetje që secili duhet t' i drejtojë vetes: "Si mund të bëhemi të denjë për t' u ulur në sofrën e Zotit?"

Kur dikush tregohet i gatshëm të dëgjojë problemet e mia është njëlloj sikur më ka larë larë këmbët. Po kështu, kur dikush më jep zemër apo më beson një të fshehtë apo shqetësim të tijin. Ne duhet vetëm të gjejmë çfarë e ndyn dhe e njollosh jetën tonë, ndërsa pastrimin duhet t' ua besojmë të tjerëve, atyre që na duan të mirën.

Ky mendim ndikoi fuqishëm tek unë dhe më ndihmoi për të ndryshuar mënyrën e komunikimit në shërbesat e të dielave. Fillova të zbuloj se njerëzit e veshur hijshëm e pastër, që uleshin me rregull në kishë nuk ndiheshin të pastër nga brënda. Shumë prej tyre kishin mosmarrëveshje me bashkëpunëtorët e tyre jobsimitarë, të tjerë vazhdonin të dëgjonin histori vulgare dhe bajate. Shumë gra dhe vajza i kishin ngacmuar një javë më parë. Mes familjarëve vihej re një ftohtësi, zemërim dhe heshtje. Pësia e fajit, e vërteta dhe gënjeshtria rëndonin mbi ta duke e trazuar pa masë gjendjen e tyre shpirtërore.

Si duhet të sillesha me ta? Mos duhej t' i kritikoja ashpër që nga podiumi ku flisja, apo t' i qortoja për jetën që bënin? Mos duhej t' i bëja fajtorë për zemrat e tyre të plagosura? Jo, kjo nuk duhet të ndodhë pasi si unë, edhe ata kanë nevojë që dikush t' ua lajë këmbët.

Ne nuk do të arrijmë të zbulojmë miqësinë e vërtetë, po qe se gjatë kohës që do të kalojmë së bashku si të krishterë nuk do t' i lajmë këmbët njëri-tjetrit.

"Po t' i dini këto gjëra, të lumtur jeni ju nëse do t' i bëni."  
(Gjoni 13:17)

# Duke Jetuar Në Stil

## E ëmbla dhe e hidhura

Kur ndjekim në hartë itinerarin e një udhëtimiti, për të gjetur vendmbërritjen duhet të dimë më parë pikënisjen. Tani që kemi parë dallimin midis Jezusit dhe vetes sonë, ne e dimë pak a shumë se ku jemi, ndaj na duket sikur udhëtimiti ynë do të zgjasë një jetë, sidoqoftë më në fund do të mbërrijmë atje ku duam.

Kur Ezekieli u detyrua t'i hante fjalët që kishte shkruar, pas zbulesës që kishte marrë nga Perëndia, në gojë ato iu dukën të ëmbla, por në stomak të hidhura. Kështu do të ndodhë edhe me fjalët e mia që unë u kam thënë. Sado të ëmbla të tingëllojnë ato, zor se do t'i gëlltisni, për vetë faktin se ndryshojnë shumë nga prirjet tona njerëzore. Ne tmerrohemi sa herë që përpiqemi të gjejmë rrugën e shpëtimit.

Fatmirësisht, kemi kujt t'i drejtohem për ndihmë. Ne e gjejmë atë të konkretizuar te trupi i Krishtit dhe përfshirja e Perëndisë në rritjen tonë personale. Jo vetëm kaq, por mbi çdo ftesë të Perëndisë gjenden inicialet R.S.V.P. (ju lutem përgjigjuni).

## **Kocka e Kyçit të Këmbës e Lidhur me Kockën e Këmbës**

Por Perëndia e ndërtoi trupin duke i dhënë më tepër nder asaj pjese që e kishte mangut, që të mos kishte përçarje në trup, por të gjitha gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën. Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të. Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e tij, veç e veç. (1 Korintasve 12:24-27)

Jo më kot, Perëndia zgjodhi trupin si shembull konkretizimi për pasuesit e tij. Trupi është organik, elastik dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Trupi mbijeton vetëm në qoftë se ai funksionon sipas natyrës së Jezusit. Asnjë pjesë e trupit natyror nuk mund të jetojë më vete, pasi çdo pjesë e veçantë e trupit njerëzor është e ndërtuar dhe e vendosur atje për t'i shërbyer pjesës tjetër të trupit. Në qoftë se një pjesë e veçantë e trupit fillon të mendojë dhe të jetojë vetëm për vete, ajo bëhet kancer për trupin (siç e quajnë doktorët). Si trupi im, ashtu dhe trupi i Krishtit do të mund të mbijetojnë për sa kohë që secila pjesë do t'u shërbejë pjesëve të tjera.

Analogjia me trupin njerëzor të çon në disa përfundime logjike. Asnjë trup nuk mund të përmbajë pjesë ambicioze brenda vetes. S'ka ndodhur kurrë që gishtat e këmbëve të më thonë: "Meqë jam me të vërtetë gisht i mirë, a mund të ngjitem më lart për t'u bërë

gju, bërryl apo hundë?” Sa qesharake që tingëllon! Gishtërinjtë e mi të këmbëve e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në errësi. Pak njerëz kanë rast t’i shohin. Ata punojnë nën një peshë të madhe dhe në një atmosferë aspak të këndshme dhe hapësirë tepër të kufizuar. Por kurrë nuk ankohen se s’kanë ngrënë akulllore apo pse fytyrës i kushtohet më tepër vëmendje. S’më kanë thënë kurrë: “Meqë ti e shpërblen kështu punën tonë, ne po shkojmë në një trup tjetër.”

Kur njëri prej kyçeve të këmbës dëmtohet dhe s’e mban dot peshën e trupit, pjesët e tjera nuk e flakin tej, ngaqë për shkak të tij çalon krejt trupi. Përkundrazi, ato luftojnë me dëshirë për të mposhtur plogëshinë, ndërkohë që organi i dëmtuar shërohet pak nga pak.

Nëse duke ngulur një gozhdë godas gabimisht thoin e gishtit të madh, dora e plagosur nuk godet me çekiç gishtin e madh të dorës tjetër për të marrë hak.

Dora ime e djathtë nuk e qorton të majtën se është më e dobët dhe jo aq e shkathët sa ajo.

Kur rruhemi, një shtresë e lëkurës së fytyrës dëmtohet dhe ka nevojë të ripërtërihet me anë të rruazave të gjakut. Këto të fundit punojnë çdo ditë për ripërtëritjen e lëkurës, por asnjëherë s’i kam dëgjuar të thonë se, po qe se njerëzit nuk do të tregohen më të kujdesshëm me lëkurën e tyre, ato nuk do t’u shërbejnë më.

Grushti im nuk godet stomakun, kur ky më dhemb, apo fytyrën kur ajo djeg, përkundrazi. Trupi im kujdeset për veten e tij dhe është gjithnjë në vetëmbrojtje. Sa herë që fytyra ime kërcënohet nga ndonjë goditje, dora pa marrë parasysh rrezikun do të mbulojë fytyrën për të mbrojtur sytë.

Nganjëherë, pjesët e trupit tim mund të shfaqin shenja lodhjeje e do të ankohen për mbingarkesën e stërmundimin, por asnjëherë si kam parë të pezmatohen për funksionin që kryejnë.

Sigurisht, ju e kuptoni ku e kam fjalën. Si pjesëtarë të trupit të Krishtit ne jemi krijuar për t’i shërbyer njëri-tjetrit. Vetëm kështu do dëshironte ta shihte trupin e tij Krishti.

## Të burgosurit e historisë

Në qoftë se jeta jonë personale duhet të pasqyrojë natyrën e Jezusit, atëherë edhe strukturat që ndërtojmë - organizatat dhe sektet e ndryshme - duhet të pasqyrojnë të njëjtën gjë. Këtë e theksoj, sepse brenda një kohë të shkurtër pas krijimit të tyre, shumica e organizmave dhe grupeve fetare fillojnë të shfaqin karakteristikat e shoqërive të zakonshme të biznesit. Struktura e pushtetit të tyre merr formën e një piramide. Ekspertë të kualifikuar fillojnë të kujdesen më shumë për funksionet e tyre sesa për strukturat e trupit dhe dhuntitë shpirtërore. Hatëret sundojnë kudo. Ata degjenerojnë dhe largohen gjithnjë e më shumë nga problemet e elektoratit të tyre. Deklaratat e përbashkëta ndryshojnë thellësisht nga fjalët e individëve. Gjatë bisedave private me përfaqësues të ndryshëm të bordeve të lartë drejtues fetarë kam zbuluar se në thelb ata janë njerëz me mendime të përparuar, që kujdesen për njerëzit dhe që kanë mosbesim të thellë në teologjitë e ndryshme dhe në vetë rolin e tyre.

Por, çuditërisht, kur mbidhen së bashku në takime, përfundimi i takimit është gjithmonë i ndryshëm nga mendimet individuale të secilit. S'kam si të mos dyshoj se, sapo fillojnë t'i nënshtrohen atij sistemi që aq shumë i ngjan sistemit botëror, ata fillojnë t'i marrin sinjalet nga dikush tjetër. Në qoftë se një sistem organizativ u mohan të drejtën ose i pengon njerëzit që të komunikojnë me Perëndinë

dhe mbi këtë bazë të marrin vendimet përkatëse, ai pa dyshim gabon rëndë. Ky nuk është stili i Jezusit.

Natyra e Jezusit duhet t' u jepet njerëzve si model, ndërsa natyra e organizimit i shërben vetëmbrojtjes. Të jesh egoist do të thotë të shkelësh mësimet e Jezusit. Kjo vërtetohet më së miri nga fjalët e tij: “Ai që do të kërkojë të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do ta humbasë, do ta shpëtojë.” (Luka 17:33).

Pas një farë kohe, strukturat fillojnë të vuajnë nga “ngurtësimi i hallkave” të cilat, ndonëse janë krijuar për t' i shërbyer njerëzve, bëhen më të rëndësishme se ata vetë. Miti grek i Prokustit e përshkruan mirë këtë situatë.

Prokusti e kishte shtëpinë në mes të një rruge që lidhte dy qytete të mëdha të cilët ndodheshin një ditë rrugë larg njëri-tjetrit. Meqë shtëpia ndodhej ndanë udhës, udhëtarë të ndryshëm ndalonin për të ngrënë dhe për të kaluar natën. Shtëpia e Prokustit shquhej për mikpritje. Ushqimi që i bollshëm, dhomat ishin të mëdha dhe gjithçka që falas. Njerëzit mund të rrinin si në shtëpinë e tyre. Atyre u kërkohej vetëm një gjë. Shtëpia duhej të buçiste nga hareja. Pas kësaj vinte kërkesa tjetër, çdo njeri që ndodhej atje duhej t' i përshtatej shtratit ku flinte. Në qoftë se ishte shumë i shkurtër, do t' ia tërhiqnin gjymtyrët, dhe në qoftë se ishte më i gjatë do t' i prisnin një pjesë të trupit.

Shumë njerëz i përshtateshin shtratit fare mirë. Ata flinin rehat dhe kur iknin lëvdonin ngado që shkonin mikpritjen e Prokustit, duke i nxitur miqtë dhe të njohurit të shkonin e të kalonin natën atje kur t' u binte rruga. Por shumë të tjerë humbën jetën në shtëpinë e Prokustit dhe askush nuk mundi të dëgjonte dëshminë e tyre. Kur sektet dhe organizatat e tjera fetare hedhin rrënjë, teologjitë dhe strukturat e tyre shoqërore bëhen tepër të ngurta. Kushdo që guxon të shfaqë një mendim përparimtar apo një fjalë profetike sulmohet ashpërsisht me fjalë ose përjashtohet fare nga Jeruzalemi (qendra e grupit). Vetëm ata që i nënshtrohen modelit të paracaktuar mbijetojnë. Jo vetëm kaq por, meqë kriteret e zgjedhjes së personelit janë përsosur pranohen vetëm ata njerëz që kanë aftësi për t' u ngritur në pozitë. Udhëheqja shpirtërore kalon në plan të dytë, ndërsa aftësia dhe mprehtësia politike triumfon. Historia ka vërtetuar se ditët e para të



shumë lëvizjeve të reja shquhen për një udhëheqje të jashtëzakonshme, që e kanë zgjedhur thjesht për meritat e saj. Por më pas, kur lëvizja shuhet, udhëheqja e re e zgjedhur në baza institucionale fillon të ndjekë një model më tepër burokratik.

Shumë herë u kam kërkuar njerëzve që përgatiten për shërbim të më thonë emrat e atyre që ata do të zgjidhnin si udhëheqje shpirtërore në kishë. Asnjëherë nuk përmendën emrin e ndonjë zyrtari të ndonjë organizate. Në një farë mënyre e drejta për të pasur një udhëheqje të denjë është zëvendësuar me luftën e pandershme për pushtet.

Si mund të parandalojë një strukturë kaq shumë dështime? Në të vërtetë, ajo s'mund të bëjë asgjë. Meqë ajo i ngjan një bishe, e vetmja rrugë për të shpëtuar është ta shkatërrosh. Ja, një propozim ky tepër i prerë dhe i rreptë!

Çdo organizatë fetare duhet të parashikojë në legjislacionin e saj dekretin e pakthyesëm mbi shpërndarjen dhe shpërbërjen e saj pas pesëdhjetë vjetësh. Për disa organizata ky afat duhet të jetë njëzet e pesë vjet. Kjo do t'u siguronte zgjedhësve një lidhje të vazhdueshme me Perëndinë, do t'i jepte mundësi organizatës të ripërtërihej dhe do ta çlironte atë nga prirja për të siguruar fitime dhe famë. Fondet do të vihehin në shërbim të njerëzve. Strukturat që kundërshtojnë natyrën e Jezusit do të vdisnin dhe kisha nuk do të ndihej shumë fajtoresh ndaj njerëzve.

Një veprim i tillë, thjesht do bënte të njohur mënyrën se si vepron Fryma e Shenjtë. Ai mban gjallë lëvizjet e reja në zhvillim dhe në lidhje të vazhdueshme me të, ndërkohë që strukturat e vjetëruara mundohen t'i shtypin e t'i përjashtojnë nga gjiri i tyre. Një lëvizje e re e tregon vitalitetin e saj duke u rritur më shpejt se gjithçka tjetër përreth, derisa arrin përmasat e lëvizjes së mëparshme, nga e cila qe përjashtuar. Me kalimin e kohës grupi i ri fillon të bëhet po aq i ngurtë sa grupi i mëparshëm, dhe shpejt lind një tjetër lëvizje që lidhet më ngushtë me Frymën e Shenjtë dhe me njerëzit, e kështu me radhë. Përse nuk udhëhiqemi nga Fryma e Shenjtë, e të sigurojmë kështu një vdekje që do të na sjellë jetën duke u shtuar si kokrra e grurit?

Përlësia e Jezusit kërkon sinqeritet të plotë nga ne. E megjithatë, materialet propagandistike të sistemeve që kërkojnë të ruajnë pozitën

e tyre me çdo kusht, përmbajnë një përqindje vërtetësie të mjaftueshme për t'u siguruar vazhdimësinë dhe mbështetjen e njerëzve. Disa nga këta materiale e paraqesin si të gjallë dhe aktiv një sistem për një kohë më të gjatë pasi ai ka vdekur dhe është kalbur. Të ndjekësh rrugën e Jezusit do të thotë të jesh në gjëndje t'i bësh ballë joshjes për pozitë të lartë apo etjes për lavdi, do të thotë që të pranosh vetëm përkrahjen e njerëzve që kanë ndihmuar vullnetarisht pasi ju janë mirënjohës për shërbimet që keni bërë. Kur një strukturë fillon të reklamojë veten, ajo ka dhunuar natyrën e Jezusit dhe ka pirë helmin e vdekjes së saj.

Organizatata fetare duhet t'i kufizojnë fondet rezervë. Sa më shumë t'i rrisin fondet rezervë, aq më pak mund të mbështetemi te Fryma e Shenjtë, aq më pak u shërbejmë njerëzve. As sektet nuk duhet të grumbullojnë pasuri në këtë vend ku ndryshku prish e hajdutët shkatërrojnë dhe grabisin. Grumbullimi i pasurisë së madhe s'është tipar i natyrës së Jezusit. Sa herë që të shihni një organizatë që zotëron shuma të mëdha të jeni të sigurtë se herët a vonë do të plasë skandali. Por një sistem s'do ta dhunonte aspak natyrën e Jezusit nëse do të kërkonte nga njerëzit e tij çdo gjë që do t'i shërbente të mirës së sistemit. Mbretëria e Perëndisë përbëhet nga vullnetarë. Një njeri që u shërben të tjerëve, që tregohet si një fëmijë dhe zgjedh të jetë i fundit zor se vepron në kurriz të të tjerëve. Sistemet që veprojnë kështu janë në grahmen e fundit.

Çdo sistem duhet të synojë, në radhë të parë, të ndërtojë marrëdhënie të mira mes njerëzve, që të përmbushë urdhëresën mbi dashurinë. S'duhet të ndërtohen struktura, që para kërkesës për dashuri e bashkim, vënë kërkesën për autoritet e nënshtrim. Askush brenda strukturës nuk duhet të qëndrojë më larg se një hap nga zgjedhësit, përsa i përket autoritetit dhe kontaktit me ta. Asnjë pushtet s'mund të pranohet thjesht nga pozita. Njerëzit e zgjedhur të Perëndisë duhet të kenë autoritet të plotë, por në qoftë se ata nuk arrijnë ta sigurojnë atë vetë nëpërmjet jetës dhe aftësive të tyre s'ka pozitë që mund t'ua japë. Asnjë autoritet institucional nuk mund të zëvendësojë denjësisht dhuntitë që të jep Zoti dhe autoritetin që buron prej tyre.

Ne duhet të çlirohemi nga disa forma kulturore siç janë zgjedhjet elektorale dhe të mësohemi të marrim vendime që burojnë nga

uniteti, i cili lind nga marrëdhënie të sinqerta dhe dashamirëse, vendime të marra nga udhëheqës që kanë hequr dorë nga prirjet sunduese, vendime që nuk cënojnë interesat vetiake të askujt.

Ne duhet të hedhim poshtë mendimin e gabuar se pastorët janë një elitë me privilegje të ligjëruara. Shumica e strukturave të këtij lloji janë thjesht sindikata predikuesish, që janë ende larg rolit të shërbëtorit.

William Stringfellow qe shumë pranë së vërtetës kur deklaroi se të gjitha institucionet e botës janë djallëzore, pasi u bëjnë njerëzve po ato gjëra si edhe djajtë. Unë e kam të vështirë ta përgënjëshetroj këtë thënie të tij.

Jezusi jetoi mes njerëzve. Ai s'mori kurrë pjesë në ndonjë strukturë fetare të kohës së tij përveçse në vende të tilla si sinagogat ku mblidheshin njerëzit më të thjeshtë. Shembulli i tij duhet të frymëzojë e të udhëheqë mbarë botën besimtare.

Duke analizuar jetën e Jezusit zbulojmë se ai zemërohej më keq me ata njerëz që kishin ndërtuar foletë e tyre brenda institucioneve vetëshërbyese, që s'donin t'ia dinin për nevojat e popullit dhe kishin braktisur me kohë rrugën e të shërbyerit. Edhe një nga urdhëresat e mëdha të së kaluarës "Kujtojeni ditën e Shtunë", përdorej për qëllime të politikës institucionale. Ndaj, Jezusi bën çmos t'u hapë sytë : "E shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunën" (Marku 2:27) - thekson ai.

Gjithë dashuria e Jezusit synonte të shpëtonte njerëzit nga mëkatet dhe jo të kufizonte veprimet e jetën njerëzore, t'u zbulonte të vërtetën dhe kështu t'i bënte të lirë. Ligji duhej të vepronte në funksion të dashurisë. Jezusin e zemëronin ata njerëz apo sisteme që nuk vlerësonin njerëzit dhe s'ua vinin veshin nevojave të tyre.

"Mjerë ju, skribë dhe farisenjë hipokritë! Sepse ju llogaritni të dhjetën e mëndrës, të koprës dhe të barit të gjumit, dhe lini pas dore gjërat më të rëndësishme të ligjit: gjyqin, mëshirën dhe besimin.

O, gjarpërinj, o pjellë nëpërkash! Si do t'i shpëtoni gjykimin të Gehenas? Prandaj, ja unë po ju dërgoj profetë, dijetarë dhe skribë; ju disa prej tyre do t'i vritni dhe do t'i kryqëzoni, disa të tjerë do t'i fshikulloni në sinagogat tuaja dhe do t'i persekutoni nga një qytet në tjetrin."

(Pjesë nga kap.23 i Mateut).

Farisenjtë i besonin aq verbërisht sistemit që kishin ndërtuar, saqë tani, me anë të tij vetëm prishnin e çoroditnin njerëzit. Ne sot nuk duhet të jemi aq naivë sa të mendojmë se fjalët dhe kritikën që Jezusi ua drejtoi atyre nuk janë aktuale sot.

Në njëfarë mënyre, Perëndia duhet të fshijë nga mendjet tona shekuj të tërë keqkuptimi dhe të na ndihmojë të kuptojmë se institucionet dhe strukturat e botës së bashku me sistemet drejtuese përkatëse nuk kanë lidhje me trupin organik të Krishtit. Sado frytdhënës të jetë sistemi botëror, ai nuk mund të zbatohet automatikisht për kishën.

Një tjetër Shkrim i Shenjtë, të cilit do të doja t'i përmbahesha tregon se si lidhej Jezusi me sistemin botëror të kohës së tij (qoftë ky fetar apo dhe ateist). Ju takon juve dhe Frymës së Shenjtë ta vini në zbatim:

Sepse trupat e atyre kafshëve, gjaku i të cilave është sjellë prej kryepriftit në shenjtëroren për mëkatin, digjen jashtë fushës. Prandaj edhe Jezusi, për të shenjtëruar popullin me gjakun e vet, pësoi jashtë derës (së qytetit). Le të dalim, pra, drejt tij jashtë fushës, duke bartur poshtërimin e tij. Sepse nuk kemi këtu qytet të përhershëm, por kërkojmë atë që ka për të ardhur. (Hebrenjve 13:11-14)

## Lidhja që Na Bashkon

Është një gjë për të cilën gjithë të krishterët e botës do të binin dakord, fakti që Jezusi është Zot. Dallimet doktrinare, ndryshimet kulturore dhe ambiciet individuale kanë bërë që ne sot të jemi një grup i përçarë. Për të pasur atë unitet, për të cilin Jezusi lutej vazhdimisht, duhet të jemi të bashkuar rreth tij dhe vetëm tij.

Në një mbledhje të motrave katolike, unë isha një nga të paktët pastorë protestantë, që më kërkuan t'u flisja pjesëmarrësve mbi perspektivën për bashkim duke theksuar edhe shkaqet që sillnin përçarje. Zhvillimet e historisë dhe të traditës kishtare u shprehën me aq kompetencë dhe aq bukur nga parafolësit, sa që fillova të ndihesha pak i shqetësuar për thjeshtësinë e mesazhit tim. Kur më erdhi radha, u ngrita dhe thashë: “Unë jam pjesëtar i një sekti shumë të ri, por që ka zhvilluar shumë tradita që mund të na ndajnë. S’dua t’i përmend se cilat janë këto, pasi jam i sigurt se as ju nuk doni t’i dini. Ndërsa ju jeni pjestarë të një grupi shumë të vjetër dhe me më shumë tradita se gjithë ne të tjerët, të cilat nuk ia vlen t’i përmendim sot, pasi jam i sigurt se ndryshimi i këtyre formave s’do sillte sot zgjidhjen për bashkim. Sidoqoftë, sa herë do të dëshironit të mblidhemi së bashku e të flasim për Jezusin unë jam gati! Me të mbaruar këto fjalë u ula në vendin tim. Pas mbarimit të mbledhjes shumë nga të pranishmit m’u afruan dhe më mbytën me ftesa për të shkuar në shkollat e tyre që të shprehja të njëjtin mesazh.

Disa vite më parë mora pjesë në një konferencë të organizuar në Singapor. Konferenca synonte të gjente rrugë të përbashkëta për arritjen e një uniteti mes kishave dhe të dëgjonte se çfarë po i thoshte Perëndia secilit. Merrnin pjesë katërqind përfaqësues të dyzet sekteve të ndryshme fetare. Pas një jave bashkëbisedimi intensiv, deklarata e përbashkët që të gjithë mund ta nënshkruanin pa u mëdyshur ishte “Jezus Krishti është Zot!”

Kurrë nuk ka pasur një kishë të vetme botërore organike, dhe, edhe sikur të ekzistonte një e tillë, ajo do ishte më tepër një institucion frike, sesa nderimi dhe respekti. Por uniteti do të arrihet pasi Ati u përgjigjet lutjeve të Jezusit: “O Atë i Shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, që të jenë një sikurse ne! ...që të jenë të përsosur në unitet dhe që bota të njohë që ti më ke dërguar dhe që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua.” (Gjoni 17,23).

Kam pasur rast të shoh mjaft kisha që karakterizohen nga uniteti. Ky unitet ekzistonte në ato bashkësi ku njerëzit e zbatonin parimin e të shërbyerit sipas shembullit të Jezusit. Por kam patur rast të shoh edhe bashkësi të përçara. Kam vënë re se përçarja në kishë s’vinte kurrë ngaqë dy fraksione haheshin se kush e kush të bëhej shërbëtor, kush e kush të mbetej i fundit, të tregohej sa më i thjeshtë a të ishte i fundit që do të përdorte forcën.

Bashkimi do arrihet vetëm kur ne do ta duam njëri-tjetrin, ashtu siç na do Jezusi. Pikërisht për këtë na e kanë përshkruar natyrën e tij. Duke parë se sa shumë na do ai, ne do të duam të tjerët. Vetëm kështu do të arrihet uniteti brenda kishës.

## Në Shtëpi me Trupin

Po të jeni gati për të filluar jetën si shërbëtor i njerëzimit do më pëlqente t'u tregoja vendin nga të niseshit dhe drejtimin që duhet të ndiqnit. S'mund të them se këshillat e mia janë të vetmet që ekzistojnë, por për t'u vënë plotësisht në shërbim të të tjerëve, duhet të krijoni afërsi me ta, gjë që shumë njerëz nuk e kanë të qartë. Ndaj e ndiej të nevojshme të ndaj me ju përvojën e grupeve të vogla para se të ndërmermi një veprim të tillë.

Kisha e hershme e konsideronte shtëpinë si vendin më ideal për konsolidimin e parimeve të Krishtërit, pasi aty s'kishte vend për zbukurime rituale. Për më tepër, hapësira e kufizuar mundësonte pjesëmarrjen e përgjithshme dhe normale. Meqë të gjithë e njihnin njëri-tjetrin, ruajtja e marrëdhënieve të mira kishte rëndësi të dorës së parë. Secili kishte më shumë kohë për t'u lutur e për të shërbyer. Shkrimet mund të mësoheshin lehtë përmes dialogut dhe mund të gjenin zbatim të menjëhershëm.

Jezusi vetë, grupin e tij të parë të shërbesës e formoi vetëm me dymbëdhjetë veta. Natyra e Jezusit karakterizohej nga dashuria, prandaj kërkonte vendosjen e lidhjeve të ngushta mes njerëzve. Të shërbyerit është vështirë të realizohet në grupe të mëdha pavetorë.

Ndërsa në grupe të vogla njerëzish, kur natyra e Jezusit bëhet forcë udhëheqëse, puna shkon mirë.

Udhëheqësi që vihet në shërbim të një grupi të vogël duhet të kontrollojë së pari veprimet e tij për t'u siguruar të tjerëve lirinë e pjesëmarrjes. Ai duhet të tregohet i ndjeshëm ndaj nevojave të pjesëtarit, që t'u shërbejë atyre sa më mirë. Jo vetëm kaq, por ai s'duhet të pretendojë që anëtarët e tjerë të ndajnë gjëra të thella apo t'i përgjigjen ndonjë pyetjeje të cilën ai nuk e ka ndarë, apo nuk i është përgjigjur i pari. Ai do të udhëheqë në mënyrën e të dëgjuarit dhe në miratimin dhe shprehjen e ndjenjave të tij me ndershmëri.

I karakterizuar nga përlësia, ai jo vetëm duhet t'i shfaqë hapur ndjenjat e tij, por po të lindë nevoja duhet t'i ballafaqojë ato me dashuri. Si një fëmijë, ai duhet t'i pranojë njerëzit ashtu siç janë, pa gërmuar thellë në jetën e tyre, të ndajë me ta gëzimet dhe hidhërimet. Si njeri fare i zakonshëm që nuk gëzon emër e famë, ai nuk duhet t'ua fshehtë anëtarëve të tjerë të grupit dështimet dhe përpjekjet e tij.

Duke e konsideruar veten si më i vogli ndër vëllezërit, ai nuk duhet të qëndrojë indiferent kur dikush mashtron tjetrin, përkundrazi duhet të dalë në mbrojtje të të mashtruarve.

Studimet që kam bërë dhe pjesëmarrja në grupe të vogla më shtyjnë të trajtoj edhe një veprim me të vërtetë udhëheqës që nuk përfshihet në natyrën e Jezusit. Unë e konsideroj këtë si të fshehtë e jetës së kishës në rrethe të vogla shoqërore. Tri ndarjet e mëposhtme të këtij kapitulli flasin për teknikat që ndihmojnë rritjen dhe forcimin e këtyre marrëdhënieve.

### ***Të hapur me njëri-tjetrin***

“Amendamenti i pestë mbi të drejtën e ruajtjes së fshehtësisë të jetës private” e ka shndërruar Trupin e Krishtit në një grup



individësh të veçantë, që mbliidhen së bashku por që mbesin brenda guackave të tyre mbrojtëse. Për të dalë prej tyre, duhet në mënyrë të ndërgjegjshme të ndajmë problemet tona me të tjerët. Është e pamundur që të më njihni plotësisht vetëm duke vëzhguar jetën time. Kjo mund të arrihet vetëm kur unë t'u tregoj jetën time me përpjekjet dhe ndjenjat e mia. Rrëfimi i jetës sime, duke zbuluar para të tjerëve dobësitë e mia është kusht për përmbushjen e natyrës shërbyese.

### ***Të ecim nën dritën e diellit***

Sikur të ishit pjesëtar i një grupi, që s'ngrihet mbi bazën e parimeve të unitetit të trupit, rrëfimi me vërtetësi i jetës tënde mund të pasohej nga kërkesa për ballafaqim ose nga një kritikë e ashpër. Por nuk ndodh kështu brenda trupit, pasi trupi i mbron anëtarët e tij të kërcënuar apo të shqetësuar. Ne e miratojmë dhe e mbështesim atë që zbulon para të tjerëve jetën e vet.

E gjithë struktura dhe veprimtaria e trupit të Krishtit përmbliidhet në një thënie të vetme të Palit në Letrën e parë të Korintasve 12:7, ku deklaron se dhuntitë e Frymës së Shenjtë i janë dhënë secilit me qëllim që të përsoset moralisht për të mirën e përbashkët.

Deklarata më e fuqishme e Palit, që tregon si të vlerësojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin jepet në Letrën e dytë të Korintasve 5:16-17: “Prandaj tash e tutje ne nuk njohim më askënd sipas mishit; po, edhe sikur ta kemi njohur Krishtin sipas mishit, nuk e njohim më ashtu. Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja të gjitha gjërat u bënë të reja.”

Me fjalë të tjera, tashmë unë duhet të të konsideroj si krijesë e re, dhe të shoh tek ti cilësitë më të mira. S'mund të them më: “Ti me të vërtetë je njeri i mirë, por...” dhe më pas të të kritikoj ashpër për gabimet e tua. Unë duhet të miratoj pozitën tënde si fëmijë i Perëndisë.

Nganjëherë, natyra ime ngre zërin kundër një pohimi të tillë dhe thotë “E si mund t'i ndreqin njerëzit gabimet e tyre po s'ua vura unë në dukje?” Përgjigja është tepër e thjeshtë; Jezusi ka thënë se zemrat tona tashmë na kanë dënuar dhe se ai nuk erdhi për të na dënuar, por për të na sjellë jetë me bollëk.

Sikur t'ju kërkoja të shkruanit në një copë letër pesë gjëra nga vetja që nuk ju pëlqejnë, me siguri që s'do t'ju duheshin më shumë se gjashtëdhjetë sekonda për t'i radhitur ato. Por, sikur t'ju kërkoja që në anën tjetër të fletës të radhitnit pesë gjëra nga vetja juaj që ju pëlqejnë, do t'ju duheshin orë të tëra për ta bërë. Kjo ndodh sepse ne i njohim mirë dobësitë tona dhe dëshpërohemi për to.

Kjo përrallë e vërteton më së miri këtë. Dielli dhe Murlani panë një njeri që kalonte andej veshur me një pallto të rëndë. Ata vendosën të provonin se kush do ta detyronte njeriun të hiqte pallton. I pari e provoi Murlani. Ai fryu me forcë duke tundur vendin përreth, por sa më fort frynte Murlani, aq më shumë e shtrëngonte pallton rreth vetes njeriu. Atëherë dielli u hodh e tha: "Tani është rratha ime." Dhe lëshoi rrezet e tij të nxehta mbi njeriun. S'kaloi shumë dhe njeriu e hoqi vetë pallton dhe u largua i gëzuar.

Pra, kur njerëzit i rrethojmë me ngrohtësi ata me dëshirën dhe me përpjekjet e tyre do të zbulojnë dhe do të hedhin tej peshat e rënda e të panevojshme që kanë përdorur për t'u mbrojtur.

Duke ndarë me njëri-tjetrin ngjarjet e jetës sonë ne i besojmë njëri-tjetrit gjënë më të çmueshme që kemi, të fshehtat tona. Pasi kemi pohuar të fshehtat tona ne do të kuptojmë se kemi bërë një hap të rëndësishëm në jetë. Të bindur se tani ato janë në vend të sigurt, vendosim të rrezikojmë më tej, tani mund të kemi besim.

### ***Liria e përkushtimit***

Të armatosur me këtë besim të ri, ne mund të provojmë të ndërmarim veprime, që më parë mund të kishin qenë tepër të mundimshme madje ndoshta edhe jofrytdhënëse.

Kjo nismë për përkushtim na jep së pari lirinë për t'u rrefyer. Në letrën e Jakobit 5:16 lexojmë: "Rrëfeni fajet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin, që të shërohemi; shumë fuqi ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë shpirt.". Edhe në mungesë të besimit jam në gjendje t'i vë re mëkatet e tua, sidomos ato që janë të zakonshme apo të pranueshme nga shoqëria, si "mungesa e besimit të fortë apo të luturit e pamjaftueshëm." Por me besim të plotë, unë

mund të rrëfej ato gjëra që janë bërë pengesë për mua; kështu mund të pres lutje dhe shërim. Rrëfimi i ngjan jashtëqitjes së përditshme të trupit. Rrëfimi na ndihmon të ecim qetësisht, të pastër e të papërlyer. Kur nuk rrëfehemi rregullisht, te ne zenë vend mbeturina që është tepër vështirë të eliminohen.

Rrëfimi i vazhdueshëm është një formë e duhur e disiplinës. Duke u rrëfyer, unë u kërkoj të tjerëve që të luten për mua dhe të jenë në kontakt të vazhdueshëm për të hetuar sjelljen time. Fatkeqësisht, një përgjegjësi e tillë fisnike dhe e vazhdueshme mungon sot në kishë. Si rezultat, ne jemi patologjikisht të pavarur dhe të infektuar.

Liria e dytë që gëzojmë është lidhja personale me fjalën e Perëndisë përmes studimit e zbatimit të Biblës. Vetë studimi i zbatuar i Biblës ka karakter rrëfyes, pasi u përgjigjet dy pyetjeve që i bëjmë vetes: Çfarë më thotë Bibla dhe si do t'i përgjigjem unë? Përgjigjet e këtyre dy pyetjeve janë rrëfimet e bindjes sonë prej Frymës së Shenjtë. Thirrja e Jezusit dhe Jakobit për vënien në jetë të saj është më se e qartë: “Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb.” (Mateu 7:24). “Dhe bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues që gënjejnë vetveten.” (Letra e Jakobit 1:22).

Liria e tretë që na siguron përkushtimi ynë është ballafaqimi. Ne rralë presim deri sa pas procesit të ndërtimit të besimit të ballafaqojmë ato fusha të marrëdhënieve tona me njëri-tjetrin që dëmtojnë këto marrëdhënie. Një fjalë e urtë thotë: I duruari, i fituari. Proçesi i forcimit të besimit ndaj njëri-tjetrit siguron të drejtën dhe nevojën për ballafaqim. Rileximi i fragmenteve mbi përlulesinë dhe manipulimin do iu ndihmonte të kuptonit më mirë rrethanat kur bëhet ballafaqimi.

Liria e katërt që buron nga përkushtimi ynë ka të bëjë me miqësinë. Në Dhiatën e Re kjo quhet koinonia. Ne s'mund ta konsiderojmë veten thjesht pasagjerë të një autobuzi të quajtur kishë, pasi ne jemi pafundësisht, përjetësisht dhe përzemërsisht besnikë ndaj njëri-tjetrit. Ëndrrat dhe përfytyrimet tona, ashtu si edhe të mirat materiale bëhen pronë e përbashkët dhe u takojnë të gjithëve. Ne nuk heqim dorë nga prirja për t'u bashkuar si një trup i vetëm.

Vetëm kur të arrijmë këtë stad do të kemi përmbushur edhe funksionin e të shërbyerit. Dashuria që buron nga të shërbyerit jep e merr vazhdimisht, shpesh në mënyrë të pavetëdijshme, në veprimet e ndërsjellta të jetës së trupit.

Brenda një grupi të vogël vemë re se trupi i Krishtit ashtu si trupi ynë përparon ngadalë me maturi- por i sigurt, madje dhe nën thirrje të tilla radikale, si ato që jepen në këtë libër. Që procesi i përpunimit për zbutjen e një caliku për verë të jetë i suksesshëm duhet shumë kohë dhe kujdes, por rëndësi ka që vera të ruhet e paprishur.

## Ndarja e Dhimbjes

Një grup pastorësh me të cilët pata diskutuar disa nga parimet e të shërbyerit që ata i kishin zbatuar me sukses m'u lutën që të shkoja përsëri për të bërë një diskutim mbi këtë çështje. Pyetja e parë që më drejtuan ditën e diskutimit qe: "A e dini se sa shqetësime dhe dhimbje na keni shkaktuar?" Duke mos ditur gjë për vuajtjet që u kisha sjellë u kërkova ndjesë dhe u propozova t'u ktheheshin përsëri normave të dikurshme. Por ata m'u përgjigjën: "Kurrë!"

Vuajtjet e tyre, që më parë ishin shkaktuar nga dështimet egoiste, tani ishin vuajtje emocionale që ua shkaktonte ecja përkrah të tjerëve. Por diçka më bëri përshtypje. Edhe pse dhimbja qe e madhe, ata nuk donin të ktheheshin më tek metodat e mëparshme. Vuajtjet e shumta që janë të zakonshme për të gjithë ne vijnë nga gjendja njerëzore e dështuar, nga plagosjet aksidentale, sëmundjet apo edhe zhgënjimet. Por vuajtje të tilla nuk janë gjithmonë lloji që çliron.

Tek Filipianët 3:10, Pali thekson: "Që të njoh atë dhe fuqinë e ringjalljes së tij dhe pjesëmarrjen në mundimet e tij..." Unë personalisht digjem nga dëshira për të njohur fuqinë e ringjalljes së tij. Tek Letra e Hebrejve 5:8 lexojmë se Jezusi mësoi të tregohej i bindur nga vuajtjet që kaloi. Në të gjitha Shkrimet e Shenjta që kam lexuar thuhet se Jezui hoqi vuajtjet në kryq për të na shpëtuar, dhe, po të mos ishte për ne, ai s'do të kishte provuar vuajtje të tjera, përveç vuajtjeve që kalon çdo njeri i zakonshëm.

Meqenëse, ai tha se ne do trajtoheshim siç u trajtua ai, është logjike që, të ndjekësh shembullin e tij në praktikë do të thotë të vuash për të tjerët.

## Fjalët Ndjekin Njëra-Tjetrën

Kur të rrokim plotësisht kuptimin e natyrës shërbyese të Jezusit dhe të fillojmë t'i shohim gjërat nga ky këndvështrim, disa aspekte të shkrimeve të shenjta që më parë na dukeshin disi të errëta do të qartësohen plotësisht. Prandaj unë dua t'iu propozoj një sistem të ri interpretimi të Biblës, që të jetë i thellë në mendim, por i lehtë në të kuptuar.

Në qoftë se pranojmë se Bibla ka një lidhje të brendshme logjike duhet të shkojmë më tej dhe të pranojmë se fjala e shkruar nuk mund të kundërshtojë kurrë Fjalën e gjallë - Jezusin. Njëtrajtshmëria e brendshme e vërtetë e Biblës do të thotë se është e bindshme ndaj natyrës së Jezusit, i cili ishte zbuluesi i Perëndisë.

Si rrjedhim, asnjë interpretim i çfarëdo Shkrimi të Shenjtë nuk mund të shtrembërojë tiparet e natyrës së tij, ardhjen e tij si shërbëtor, shembullin që dha, përvullësinë e tij, ardhjen e tij si fëmijë, si më i vogli i familjes, si i fundit, i parëndësishëm, pa njohje publike dhe pa përdorur forcë.

Ne nuk duhet të interpretojmë Shkrimet e shenjta në qoftë se s'jemi të bindur se trajtimi i ynë nuk e shtrembëron natyrën e Jezusit. Le të mbeten siç janë, pa interpretim. Përderisa mënyra se si e shohim atë tani nuk përputhet plotësisht me natyrën e Jezusit, ne nuk e kemi kuptuar ende aq mirë sa ta shpallim e ta interpretojmë atë.

Tani ju mund të arrini në përfundimin se është vështirë të harmonizosh disa nga Shkrimet e përdorura kohët e fundit si doktrinë apo mënyrë jetese me natyrën e Jezusit. Ky fakt flet qartë për interpretimin gabim të këtyre Shkrimeve prej nesh.

Është e rëndësishme, gjithashtu, të mos bëhemi pre e mendimit se Bibla është pjesa e katërt që i shtohet Trinisë. Bibla është zbulesa e Perëndisë e shprehur me fjalë dhe pavarësisht se çfarë besojmë nga ajo, ne s' duhet ta çënojmë Atë që ajo ka dashur të na tregojë.



## Stili për të Gjitha Kohët

Ringjalljet e këtij shekulli kanë qenë kryesisht të një natyre Pentakostale apo karizmatike. Rizbulimi i dhuntive të Frymës nga Pentakostalët dhe entuziazmi i madh i nxiti ata të besonin dhe t'u mësonin të tjerëve se ringjallja e tyre ishte ringjallja e fundit e kohës. Ata e ndienin se s'kishte mbetur gjë tjetër për t'u zbuluar nga Shkrimet e Shenjta, prandaj edhe fenomenet e tyre karizmatike paraqitnin rezultatin përfundimtar - ringjalljen e të gjitha ringjalljeve.

Edhe pse Pentakostalët i kthyen kishës një parim të fuqishëm, që pothuaj qe harruar, ata s'arritën t'i jepnin kishës dhe botës mbarë atë unitet dhe realizim shpresash që çdokush do shpresonte në një fazë përfundimtare. Përveç përqëndrimit tek adhurimi i Jezusit dhe entuziazmit që i karakterizonte ata u bënë të njohur sepse nuk vunë theksin në njohjen e Jezusit, por në unitetin me Frymën e Shenjtë. Megjithatë, si për Pentakostalët ashtu dhe për Karizmatikët lidhjet me Jezusin janë të forta dhe të pamohueshme.

Ndoshta plani i madh po shpaloset; Fryma e Shenjtë tani që ka siguruar vëmendjen e një spektri më të gjerë kishash e njerëzish po përgatitet për të mënjanuar ndërthurjet mitologjike dhe Jezusin e "nostalgjisë" për të përmbushur detyrën kryesore të parathënë për lëvdimin e figurës së Krishtit.

Në Ungjillin sipas Gjonit, Jezusi profetizon ardhjen dhe veprimin e Frymës së Shenjtë:

“Fryma e Shenjtë...do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.”

“Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t’ju dërgoj prej Atit...ai do të dëshmojë për mua.”

“Ai do t’ju prijë në çdo të vërtetë.”

“Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t’ju kumtojë.” (Gjoni 14:26;15:26;16:13;16:14)

Nga këta paragrafë duket qartë se detyra kryesore e Frymës së Shenjtë është të na zbulojë natyrën e Jezusit dhe të bindë njerëzimin për vërtetësinë e tij. Ringjalljet e përqëndruara tek Fryma e Shenjtë e dhunuan këtë parim duke e drejtuar vëmendjen tonë tek Fryma e Shenjtë, në vend që ta linin Atë të na fliste ne dhe botës për personin Jezus.

Kam besim të plotë se ringjallja e madhe përfundimtare e botës do të jetë një ringjallje që përqëndrohet tek vetë Jezusi dhe natyra e tij. Bota s’ka njohur ndonjëherë forcë më të madhe se ajo e Jezusit dhe kisha nuk mund të ushtrojë forcë më të madhe sesa shembulli i jetës dhe dashurisë së Jezusit.

Ne s’mund t’i shpëtojmë thirrjes dhe urdhëresës që Jezusi i drejton kishës së tij : “Paqja me ju! Sikurse më ka dërguar mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju.” (Gjoni 20-21)

A mund ta besojmë me ndershmëri, se ne jemi zgjedhur për t’u dërguar pjesërisht, siç dërgoi Ati Jezusin? Sigurisht që jo! Ne duhet ta pranojmë se Ati na ka krijuar me të njëjtën natyrë dhe me të njëjtat kërkesa si të Jezusit.

Vënia e dhuntive në shërbim të trupit të Krishtit na përgatit t’i shërbejmë njëri-tjetrit, në mënyrë që t’i përngjasim sa më shumë Krishtit: “Derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit. ” (Efesianëve 4:13)

Pjekuria dhe rritja na shërben për t’u bërë si Krishti, ndërsa shërbesa jonë për t’i bërë të tjerët si Ai. Për t’u bërë si Ai duhet të kemi urtësinë e tij dhe të përvetësojmë natyrën e tij.

Në qoftë se ç'ka është thënë në këtë libër mbi natyrën e Krishtit është e vërtetë, atëherë Fryma e Shenjtë do t'ju pajisë edhe ju me këto cilësi dhe do t'ju ndihmojë t'i përdorni ato sipas mënyrës suaj. Gjërat e radhitura në kapitujt e mëparshëm janë gjëra me të cilat Fryma e Shenjtë ka punuar tek unë në jetën time. Kjo nuk do të thotë se do të ndodhë edhe tek ju njëllonj. Edhe sikur këto gjëra të mos jenë konfirmuar plotësisht në mendjen tuaj, do t'ju duhet t'i përgjigjeni disi thirrjes për të qenë si Jezusi, për të provuar forcën e tij, për të marrë pjesë në vuajtjet e tij dhe për t'u bërë si ai në vdekjen e tij.

Nuk dua që në fund të këtij libri të ndiheni fajtorë dhe të pashpresë për të arritur një ditë pjekurinë dhe plotësinë e Jezusit, ndaj për t'ju dhënë zemër po ju citoj ca fjalë nga Shkrimet e Shenjta:

Sepse Perëndia është ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij. (Filipianëve 2:13)

Ne në fakt jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to. (Efesianëve 2:10)

Njëherë e një kohë punoja në një zyrë, ku pjesëtarët e zyrës kalonin orët e drekës të martave dhe të enjteve duke luajtur basketboll tek palestra në anën tjetër të rrugës. Sot, basketbolli s'është më loja ime e preferuar. Kur bënim ndarjen në skuadra ndodhte që lojtarët të thonin: "Ej, radhën e shkuar e kishim ne Geillin në skuadër. Kësaj radhe duhet ta merrni ju..."

Pra, ju e kuptoni se unë shkoja atje vetëm për t'u ushtruar. Sidoqoftë, ishte një djalosh i quajtur Deiv, dy metra i gjatë që e mbushte fushën kur hynte për të luajtur. Mua më pëlqente të isha në skuadrën e tij, pasi gjithmonë do fitonim. Ndërsa mua më duhej vetëm t'i pasoja topin Dejvidit që ai të shënonte. Kur ne ta merrnim topin prapë, unë do triploja përreth pak sa për t'u dukur, t'ia pasoja topin Deivit dhe ai do të shënonte një dy pikësh tjetër. Dhe unë me mburrje do t'i thoja: "Jemi apo s'jemi të fortë?"

Kjo i ngjan shumë marrëdhënies që kemi me Jezusin. Ai vepron tek ne për të na ndihmuar që të plotësojmë dëshirën e tij, dhe duke na qëndruar gjithmonë pranë, ndërsa përpiqemi ta kryejmë atë. Ne jemi bashkëpunëtorët e tij. Ai ka pranuar të ketë përgjegjësi të plotë

për ne. Detyra jonë është të qëndrojmë në një skuadër me të, t'ia tregojmë shqetësimet atij dhe ta lëmë të shënojë kundër Djallit në mbrojtjen tonë: “Ju jeni prej Perëndisë, o djem të rinj, dhe i keni mundur ata, sepse ai që është në ju është më i madh se ai që është në botë.” (Letra e parë e Gjonit 4:4).

Pra, vihuni në shërbim të tij. Lejoni që Fryma e Shenjtë e tij t'ju ndërgjegjësojë për urtësinë e Krishtit, ndërsa ai vepron në jetën tonë. Mohoje veten dhe vazhdo të rritesh në Krishtin!

Duke i drejtuar sytë tek Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit, i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë. (Hebrenjve 12:2)

# UDHËZUES STUDIIMI

Tema kryesore e librit “*Stili i Jezusit*” na sqaron se Jezusi është zbulues i plotë dhe Atit dhe se përcaktimi më i qartë i natyrës së tij gjendet tek mësimet e Jezusit mbi “ Më të Madhin e Mbretërisë” dhe në fragmentet që prekin këtë temë. Të shërbyerit është tipari kryesor që përshkon librin.

Tema përmbledhet më tej në fjalën vetëmohues. Përmbajtja e librit dhe zbatimi praktik i mësimet të tij mund të kuptohen më mirë sikur fjala e lartpërmendur jo vetëm të njihet si koncept, por më tepër të ruhet në ndërgjegje.

I ndarë në kapituj të shkurtër dhe pa numër, “*Stili i Jezusit*” është një libër ideal për t’u studiuar në grup si dhe për përkushtim personal. Në qoftë se libri do të përdoret për studim grupi këshillohet të bëhet një përgatitje paraprake nga udhëheqësi i grupit.

Për ta mbajtur parasysht temën e përgjithshme të librit, ndërsa analizoni secilën listë të pyetjeve, kopjoni të katërmëdhjetë tiparet e përmendura tek paragrafi “*Ai s’është i paarritshëm*” dhe jepini nga një kopje secilit student ose përgatisni një afishe dhe vendoseni në mjedisin e studimit. Megjithatë nevojitet kohë për të mbledhur disa të dhëna, në këtë udhëzues shumica e pyetjeve mund të gjejnë zbatim praktik dhe i përshtaten shumë mirë studimit në grupe të vogla.

## Jezusi, Po

1. Gjon Pagëzori dhe apostujt e Jezusit nuk i shpëtonin dot mendimit tradicional të kulturës së kohës. Nga leximi i këtij libri dhe nga njohuritë që keni mbi Biblën, a jeni në gjendje të veçoni

nga Dhiata e Re ato ngjarje që ju tregojnë të kuptoni se njerëzit kërkonin që Jezusi t'i përshtatej një mënyre jetese dhe mendimi të caktuar?

2. Sikur Jezusi të vinte sot për herë të parë, si duhej të silllej sipas jush që të ishte sa më i pranueshëm për ju dhe për të tjerët? Si mendoni se do të vishej ai sot? Cili do të ishte ai vend që do t'i përgjigjej më mirë mësimëve të tij? Përse? Cili vend do të merrte më shpejt masa për ta ndaluar veprimtarinë e tij? Kultura e Mbretërisë dhe kulturat e botës në të cilën jetojmë duket se janë në konflikt të përhershëm. Që të mund ta kuptoni këtë më lehtë, sillni ndër mend ndonjë të huaj që ka ardhur nga një shtet tjetër dhe banon në lagjen tuaj.

3. A ndryshon shumë ai nga ju? A i është dashur të përshtatet me ushqimin, stilin e të veshurit, gjuhën dhe zakonet e vendit tuaj? Po ju, kur keni vizituar një vend tjetër, a ju është dashur të bëni shumë ndryshime për t'iu përshtatur vendit? Me cilat gjëra e keni pasur më lehtë për t'iu përshtatur dhe me cilat më vështirë?

## Njohja me Jezusin

1. Studioni me vëmendje listën e mëposhtme dhe nënvizoni me kujdes ato cilësi që ju tërheqin më tepër vëmendjen para se të vendosni të ndiqni atë njeri që përshkruhet si më poshtë.

Lindur në një grazhd  
 Lindur në një fshat jo me emër  
 Lindur në rrethara të dyshimta  
 Asgjë për t'u krenuar me jetën e parardhësve të tij  
 Vetëm njerëz të shtresave të ulëta ishin ftuar në festimin e lindjes së tij  
 Ai nuk ishte i pashëm  
 Ai u rrit mes një fqinjësie të keqe  
 Ai jo vetëm që nuk zotëronte pasuri, por edhe ndihej mirë pa të  
 Njeriu që paralajmëroi ardhjen e tij që i pagdhendur dhe mjaft i çuditshëm

Pasuesit e tij më të afërt ishin të pa aftë dhe ziheshin me njëri-tjetrin

Atij iu dha nga qeveria një dënim me vdekje mjaft poshtëruese

2. Cilat nga pikat e përmendura më sipër mendoni se do ta detyronin një kandidat për deputet të tërhiqej nga fushata elektorale, sikur këto të botoheshin në shtyp?

3. Nga ky kapitull mësojmë se Jezusi nuk përdori forcën apo manipulimin për të na bindur që të marrim një vendim të çiltër rreth tij. Radhitni në një fletore personat apo kushtet që ndikojnë në marrjen e vendimeve tuaja dhe vendosni shenjën plus përbri atyre që ju ngacmojnë më tepër. Në cilat raste e ndieni se keni marrë vendimet më të sigërtë - ato që me të vërtetë kanë buruar nga zemra juaj?

4. Përshkruani në fletore trashëgiminë tuaj shpirtërore. Si ndikon kjo në vendimet që merrni? Cilat fusha të aventurave shpirtërore keni vendosur të braktisni për shkak të kësaj trashëgimie? Si ju ka tërhequr kjo trashëgimi drejt aventurës shpirtërore?

## Numri një

1. Ky libër e veçanërisht ky kapitull përforcon më tej faktin se Jezusi qe Perëndia vetë dhe se ai qe zbulimi i plotë e përfundimtar i Atit tonë në qiell. Përpiloni në fletoren tuaj dy lista përbri njëra-tjetrës. Në njëërën listë radhisni ato gjëra që mendoni se dini për Jezusin, ndërsa në tjetrën ato gjëra në të cilat ju me të vërtetë e keni përjetuar atë.

2. Lexoni Kolosianëve 1.15-2.10. Vini re sa herë e përdor Pali fjalën “të gjithë” dhe sipëroren. Në ç’fusha të jetës suaj do t’ju pëlqente ta përdornit fjalën “të gjithë” kur flitet për Jezusin?

3. Duke patur përpara listën e tipareve të Jezusit (që përgatitët në grupin e parë të pyetjeve), lexoni me zë të lartë Kolosianëve 2.8

dhe bëni një listë të atyre traditave apo filozofive, që sipas mendimit tuaj nuk i përshtaten natyrës dhe parimeve të Krishtit.

4. Shpesh njerëzit e kanë të vështirë të flasin thjesht për Jezusin. A ju ndodh edhe juve kështu? Me cilët miq apo shokë e keni më të lehtë t' i kapërceni këto pengesa dhe të bisedoni haptazi për Jezusin?

5. Cilat janë ato shërbesa të suksesshme që ju shqetësojnë, ngaqë e ndieni se ka diçka në to që nuk i përshtatet natyrës së Jezusit? Ndaluni, reflektoni dhe lutuni për to.

## Një për të gjithë

1. Në këtë kapitull gjejmë disa deklarata të fuqishme rreth domosdoshmërisë për ta dashur njëri-tjetrin siç këshillohet tek Gjoni 13:34,35. Si arrini zakonisht ta dalloni një të krishterë? Si mund të krahasohen ato kritere vlerësimi që përdor bota me këtë urdhëresë?

2. Jezusi na urdhëroi ta duam njëri-tjetrin siç “Unë ju desha ju”. Me listën e tipareve të Jezusit përpara vetes (që nga pyetjet e para) meditonit mbi secilin tipar me bindjen se kjo është mënyra më e mirë për të qenë më pranë tij. Si i përshtatet kjo përcaktimit mbi dashurinë?

3. Cilët janë ata njerëz që shfaqin në marrëdhënie me ju cilësi të shërbyerit? Po ju vetë si e zbatoni këtë në shërbim të të tjerëve?

## Të gjithë për një

1. Në këtë kapitull bëhen deklaratat më të fuqishme rreth dashurisë, të bazuara tek Mateu 22: 35-40 ku përforcohet ideja se e gjithë Bibla flet si ta duam Perëndinë dhe të afërmit tanë. A ju gëzon ky fakt apo në njëfarë mënyre ju shqetëson? Në qoftë se ju shqetëson, tregoni arsyen ose shkruajeni atë në fletoren e shënimeve.



2. Lexoni një material çfarëdo mbi besimin ose edhe deklaratën e besimit të kishës suaj. Ç’rekomandime në lidhje me dashurinë mes besimtarëve dhe pasuesve të Jezusit gjeni në to? Dashuria për njëri-tjetrin a përbën një kusht për të qenë pjesëtar i kishës suaj? Si do të silleshit ju ndaj një personi të dashur dhe të afrueshëm?

3. Ky kapitull përmban dy lista rreth dashurisë. Shkruajeni secilën listë në një copë letër të veçantë. Po të ndodheni në grup, ndajini secilit pjesëtar nga një fletë. Tani, të dy këto lista së bashku me listën e tipareve të Jezusit, të cilën e keni të përgatitur lexojini me zë të lartë- njëzëri po të jeni në grup- dhe ndani mes jush mendimet që ju vijnë ndërsa i lexoni ato. Si mund t’ju ndihmonte njëra listë për të plotësuar tjetrën?

4. Do të ishte diçka frymëzuese dhe e mrekullueshme sikur t’i merrnit të trija këto lista dhe t’i përdornit si udhëzime për të shkruar një material besimi apo besimesh teologjike, sikur ju vetë të ishit “Themeluesi” i një institucioni shpirtëror.

## Një për shumë

1. Ky kapitull është ndërtuar mbi lutjen e madhe kryepiftërore të Jezusit tek Gjoni 17. Disa pjesë të kësaj lutjeje të shquar na shqetësojnë tek shohim situatën aktuale të kishës, veçanërisht lidhur me kërkesën për të qenë “një trup i vetëm”. Ku e shihni ju të përmbushur këtë lutje dhe ku e shihni atë të paralizuar? Ndaluni dhe lutuni për ato aspekte të papërmbushura.

2. Në po ato kapituj, ku Jezusi foli për dashurinë (Gjoni 13-17), foli edhe për frytet. Në qoftë se dashuria dhe të mirat që burojnë prej saj janë frytet tona, atëherë cilat fryte të jetës sonë do t’u bien më shumë në sy të afërmve dhe fqinjëve tanë, motrave dhe vëllezërve tanë besimtarë?

3. Jezusi përcakton si kusht kryesor për ungjillizimin e suksesshëm unitetin dhe dashurinë mes njëri-tjetrit. Nëpër takime kërkoni që

secili nga pjesëtarët e grupit të pyesë dhjetë besimtarë të tjerë se si u bënë të krishterë. Duke krahasuar shënimet dalloni se sa prej tyre ishin bindur për besimin, dhe sa të tjerë e kishin fituar besimin ngaqë dikush i kishte dashur me gjithë zemër. Shkruani në fletore ose tregojini grupit tuaj se si vendosët të ecnit në rrugën e Jezusit.

4. Tani që keni tre lista të tipareve të dashurisë dhe fryteve që sjell ajo, përpiloni një listë të katërt ku mund të radhisni disa nga dobësitë që keni dhe që doni t'i përmirësoni. Kërkojini dikujt të lutet së bashku me ju për këtë.

## Ai nuk është i paarritshëm

1. Ky kapitull na sjell ndër mend kapitullin e quajtur “*Njohja me Jezusin*”. Duke qenë se lista e tipareve të Jezusit nuk mund të jetë plotësisht e njëjtë me listën tonë personale, përpiquni të ndani me të tjerët detaje të nxjera nga jeta juaj - ato cilësi që ju kanë afruar me të tjerët dhe ju kanë bërë të prekshëm e të brishtë.

2. Shkrimet e Shenjta të këtij kapitulli na paraqesin listën e tipareve të Jezusit, të cilën e keni përdorur që në fillim të librit. Lexojini ato me zë të lartë ose të gjithë njëzëri duke mbajtur parasysh fillin e përbashkët që i përshkon.

3. Kjo që pason është lista e tipareve të Jezusit. Në libër këto tipare shfaqen si pjesëza të veçanta shumë domethënëse e të rëndësishme, pavarësisht se nuk paraqiten si një njësi e vetme. Kopjojini në fletoren tuaj dhe mbajini mend, pasi ata do t'ju shërbejnë shumë. Do t'ju duhen gjithashtu për një sërë çështjesh të tjera. Tetë tiparet e para janë nxjerë nga Ungjijtë dhe gjashtë të fundit nga libri i Filipianëve. Këto gjashtë të fundit do të diskutohen më vonë, por lista e mëposhtme është e plotë dhe mund ta përdorni.

Shërbëtor

Nuk sundoi mbi të tjerët

Shembull  
 I përlurur  
 Si një fëmijë  
 Si më i vogli i shtëpisë  
 Si i parëndësishëm  
 Si i fundit  
 Nuk përdori forcën mbi të tjerët  
 Nuk u tërhoq nga ambicie të verbra  
 Nuk kërkoi famë  
 Qe plotësisht njerëzor  
 I bindur  
 Sakrifikoi jetën e tij

4. Tek mësimet e Gjonit 13-17, Jezusi kishte shumë për të thënë për rolin që luajti Fryma e Shenjtë në dëshmitë mbi Jezusin. Çfarë përvoja keni pasur ju me Frymën e Shenjtë dhe si ka ndikuar kjo në njohjet dhe pikëpamjet tuaja mbi Jezusin?

## Në shërbimin tuaj

1. Ky kapitull përbën thelbin e librit dhe përcakton një tipar të rëndësishëm të natyrës së Jezusit - të shërbyerit, ose siç mund ta quajmë ndryshe vetmohim. Çfarë ju sjell në mendje fjala “shërbëtor”?

2. Cilët janë ato njerëz që ua bëjnë jetën më të këndshme? Po ju vetë, kujt ia bëni jetën më të lumtur?

3. Po qe se do t’i arrinit plotësisht ambiciet tuaja, si do të reagonit ndaj thirrjes për t’u shërbyer të tjerëve?

4. Shkrimtari thekson se të shërbyerit s’është një veprim i detyruar por një zgjedhje e lirë që bëjmë ne vetë. Më pas, pothuajse në tërë kapitullin ai përqëndrohet tek ato probleme që lindin nga manipulimi, pasi ekziston rreziku i vazhdueshëm, që personi vetmohues të bierë në grackën e manipulimit. Sillni ndër mend rastet kur keni ndier se të tjerët ju kanë shfrytëzuar dhe kanë përfituar nga ju. Si ndiheni dhe si reagoni në të tilla raste?

5. Duhet ta keni vënë re se zakonisht ju përpiqeni t'u shmangeni njerëzve që orvaten t'ju manipulojnë, dhe kur dikush arrin t'ju shfrytëzojë për qëllimet e veta, humbisni respektin për të dhe zemëroheni me veten që jeni treguar naiv e keni rënë në kurthin e manipuluesit. Më poshtë vijojnë disa përcaktime që do t'ju ndihmojnë t'i shmangeni manipulimit.

“S’e mendoj si të drejtë zgjedhjen që duhet të bëj, ndaj në këtë rast do të vendos të them JO”

“Në të tilla kushte do ta kem të vështirë të bëj zgjedhjen e drejtë, prandaj më mirë është të them JO”

“Vendosa të veproj kështu sepse edhe kështu bëj një zgjedhje. Mendoj se kjo është zgjidhja më e drejtë dhe më e mirë”

6. Kërkojini një shoku apo pjesëtari të grupit tuaj të imitojë me ju një situatë manipulimi dhe mundohuni t'i përdorni përcaktimet e mësipërme, derisa t'ju bëhen të natyrshme.

7. Të shërbyerit dhe skllavëria janë dy gjëra krejt të ndryshme. Të shërbyerit është një zgjedhje e lirë, e vullnetshme, ndërsa skllavëria është e detyruar. Duke përdorur dy fjalët “të shërbyerit” dhe “skllavëria” si tituj të dy kolonave, analizoni paragrafët e mëposhtëm dhe plotësojini të dy kolonat me fjalët që i përshtaten secilit titull, Gjoni 10:17,18. 1 Korintasve 9:19. Mateu 5:38-42.

8. Cilat janë nevojat dhe forcat që në të vërtetë ju nxisin në jetë? Diskutojini me dikë dhe shpjegoni si i përdorni ato në vendimet që merrni.

## **Piramida e Pushtetit**

1. Ky kapitull shtjellon një tjetër tipar të Jezusit - mos sundimin mbi të tjerët. Një nga veprimet njerëzore që spikat më fuqishëm në jetën e njerëzve është prirja për të sunduar mbi të tjerët. Fakte të

kësaj veçorie shpesh mbushin faqet e gazetave. Mjafton të merrni kopjen e fundit të gazetës suaj lokale dhe të numëroni artikujt e shkruar nga individë apo grupe njerëzish që rreken të ushtrojnë pushtet mbi të tjerët.

2. Ky kapitull na mëson se ata njerëz që mundohen të ushtrojnë pushtet mbi të tjerët rrezikojnë të humbasin besimin dhe ndershmërinë e vartësve të tyre. Për ta vërtetuar më mirë këtë, radhitni në një listë emrat e disa biznesmenëve, politikanëve apo udhëheqësve fetarë që njihni. Sillni ndër mend ç'është thënë për ta, pas krahëve. Po ju vetë a mund t'ua thonit të vërtetën në sy? Lutuni që ju të silleni ndershmërisht me ta.

3. Si ka ndikuar në lartësimin tuaj shpirtëror përlësia ndaj udhëheqësve shpirtërorë? Në ç'aspekte të jetës suaj keni parë të abuzohet me autoritetin shpirtëror?

4. Ky kapitull përqëndrohet kryesisht në faktin se si mund të ndikojë natyra e Jezusit në marrëdhëniet tona bashkëshortore dhe familjare. Duke i konsideruar fëmijët tuaj si fëmijë të Perëndisë për të cilët ju kujdeseni, ç'doni t'u mësoni rreth Perëndisë, Atit të tyre, si dhe rreth përgjegjësive tuaja? Si do t'ua shpjegonit fëmijëve tuaj fjalën “përsosje” të marrë nga Efesianët 4:12? Bëni një listë të gjërave apo veprimeve të rëndësishme që do të donit t'i kishin apo t'i bënin fëmijët tuaj.

5. Po qe se jeni i martuar, me listën e cilësive të Jezusit në dorë shkruani në fletore se si duhen zbatuar këto cilësi “për ta dashur bashkëshorten tuaj siç e desh Jezusi kishën”. Si bashkëshorte, shpjegoni me shkrim si nënshtroheni para Zotit dhe vëreni se si mund ta zbatoni këtë në marrëdhëniet bashkëshortore.

6. Cilat janë ato gjëra që nxitin përlësinë reciproke ndaj njërit-tjetrit në jetën tuaj bashkëshortore? Cili është raporti mes veprimeve tuaja si njësi dhe përpjekjeve për të shprehur individualitetin tuaj?

7. Çfarë sistemesh të autoritetit të fortë keni vënë re përreth jush?

8. Kush janë ata njerëz që i dëgjoni më shumë dhe si mund ta përshkruani autoritetin që ushtrojnë ata mbi ju?

9. Po qe se do t'ju ngarkonin një detyrë, a do të ishit në gjendje të përshkruanit se si do ta kryenit?

## **Unë do doja të shihja një shërbesë**

1. Ky kapitull trajton tiparin e tretë të natyrës së Jezusit - shembullin. Përpiqu të sjellësh ndërmend vitet e fëmijërisë dhe kujto ata njerëz që ju kanë mësuar gjëra të reja. Shpjegoni si e keni ndier veten më pas. Po ju vetë, kujt i mësoni gjëra të reja duke dhënë më parë shembullin tuaj?

2. Më kujtohet predikimi i një pastori mbi “disa gjëra që i kishin ardhur në majë të hundës”. Arsyetimi i tij qe i tillë: “Më ka ardhur në majë të hundës pretendimi që ju të luteni, ndërkohë që unë vetë s’jam lutur. Më ka ardhur në majë të hundës pretendimi që ju të jepni për të tjerët, ndërkohë që unë vetë s’kam dhënë gjë. Më ka ardhur në majë të hundës pretendimi që ju të jepni dëshmi për besimin tuaj, ndërkohë që unë vetë s’kam dëshmuar para të tjerëve.” A nuk do ishte inkurajuese për ju një deklaratë e tillë e sinqertë? Çfarë aftësish shpirtërore zotëroni dhe kush jua ka mësuar ato? Çfarë aftësish shpirtërore do të donit të mësonit nga të tjerët?

3. Ky kapitull bën disa përcaktime të fuqishme mbi edukimin dhe sistemet arsimore. Nga njohuritë që keni, çfarë mendoni për edukimin? Pa dyshim, nxënësi është pasqyrë e mësuesit të tij. Mbi ç’kriteret e zgjidhni mësuesin për fëmijët tuaj? A dini ndonjë vënd ku përzgjedhja e mësuesve bëhet duke u nisur kryesisht nga fakti se jeta e tyre është një shembull i mirë? Sikur të ishit vetë mësues, a do t’ju pëlqente që nxënësit ta njihnin jetën tuaj?

4. Tek Ligji i Përtërirë 6:6,7 Perëndia i këshillon Izraelitët t’u mësojnë fëmijëve të tyre urdhëresat të cilat Ai na i jep edhe neve sot. Çfarë ju thotë Perëndia juve sot? A janë në dijeni njerëz të

tjerë, e sidomos fëmijët tuaj, për një gjë të tillë? Shkruajini në fletoren tuaj ose ndani me shokët e grupit ato gjëra që Perëndia po ju thotë sot.

5. Duke mbajtur para vetes suaj listën e tipareve të Jezusit, mundohuni të ndërtoni një sistem arsimor që do t'i përngjante shumë Jezusit dhe do të përgatiste nxënës që do pasqyronin natyrën e Jezusit në jetën e tyre.

6. Përmendni disa veprimtari që mendoni se mund të mësohen vetëm me të parë.

7. Ç'gjëra keni mësuar vetëm me të lexuar apo të dëgjuar?

8. Sa keni përparuar shpirtërisht duke parë shembuj që s'keni dashur t'i ndiqni, dhe sa keni mësuar duke parë shembujt e duhur?

9. Cila do ishte ajo fushë e rritjes suaj shpirtërore ku keni dobësi, dhe mendoni se do t'ju nevojitet një shembull i mirë?

10. Cilët janë ata njerëz që, në jetën e tyre, mund të ndikohen nga shembulli juaj?

11. Në ç'fushë të jetës mendoni se mund të ishte më efikas mësimi përmes dhënies së shembullit personal?

## **As më shumë, as më pak**

1. Ky kapitull shpalos cilësinë e katërt të natyrës së Jezusit-përrulësinë. Ç'ju sjell në mendje fjala "i përrulur"?

2. Përrulësinë, me fjalë të tjera mund ta përshkruajmë si parimi i ndershmërisë dhe i sinqeritetit. Do të ishte e vështirë t'i mësojmë të tjerët përmes shembullit personal (siç thamë më sipër), pa

përlësinë dhe dëshirën e mirë për t'u dukur të ndershëm në sytë e të tjerëve. Si përpiqeni ta paraqisni veten para të tjerëve? Ç'rrugë ndiqni për ta ruajtur këtë paraqitje? Sa kohë dhe energji ju duhet të shpenzoni për këtë qëllim? Deri në çfarë mase arrini ta realizoni këtë?

3. E drejta e fshehtësisë së jetës private është e garantuar me kushtetutë në Shtetet e Bashkuara. Kjo është një arritje për shoqërinë e sotme, por brenda Trupit të Krishtit është shumë e dëmshme. Cilat anë të karakterit tuaj do t'ju pëlqente t'i mbanit të fshehta para vëllezërve tuaj të krishterë? Kaloni një kohë në heshtje pastaj rrefejani ato Perëndisë, ose ndajini me një shok të ngushtë, që pastaj ky i fundit të mund të lutet për ju.

4. Letra e dytë e Korintasve 3:17,18 përmban një parim që nuk bie në sy por që ka forcë të madhe. Aty thuhet se duhet të zbulohemi para Perëndisë, që Ai të hedhë mbi ne shkëlqimin e lavdisë së Tij dhe të na shndërrojë në shëmbëlltysinë e vet. Shkruani në fletore dhe ndani me grupin tuaj ato gjëra për të cilat i jeni rrëfyer Perëndisë më parë dhe që kanë ndryshuar për të mirë jetën tuaj.

5. Sikur ndjenjat tuaja (jo mendimet), të mund të pasqyroheshin në një ekran, sa do t'i çudisnit njerëzit? Sipas jush cila nga ndjenjat tuaja mendoni se do t'i çudiste ata më tepër?

6. Sidomos gjatë kohës që ndodhni në kishë, a mendoni se ndjenjat tuaja ndryshojnë nga ndjenjat e të tjerëve? Çfarë do të ndienit po të zbulonit një ndryshim të tillë?

7. Çfarëdo frike që ju shkakton vetëndrydhja kini guxim ta shprehni para Perëndisë, që përmes hirit të Tij Ai të mund t'ua largojë.

## **Fëmija është..**

1. Ky kapitull trajton cilësinë e pestë të Jezusit- të qenit si fëmijë. Sillni ndër mend për pak çaste fëmijërinë tuaj, kujtoni lojërat, shokët



e fëmijërisë, festat dhe shakatë që keni bërë. Si është zhvilluar besimi juaj gjatë fëmijërisë? Argëtohuni duke luajtur me grupin tuaj një lojë të vjetër të fëmijërisë - syllambyllazi, topa lufte apo ndonjë lojë tjetër që ju kujtohet. Vëzhgoni ndjenjat tuaja dhe të qeshurat e grupit.

2. Kaloni një pjesë të kohës me fëmijët, pasi ata ju ndihmojnë në lartësimin tuaj për t'ju afruar natyrës së Jezusit. Po t'ju jepet mundësia, mos ngurroni të uleni në shesh me ta. Lërinë ata të sillen lirisht, pasi vetëm ashtu do t'u largohet frika dhe do të ndihen të qetë pranë jush. Kur të shihni ndonjë fëmijë në krahët e nënës së vet, mos ngurroni t'i tërhiqni vëmendjen me ndonjë veprim tuajin që mund ta bëjë të qeshë.

3. Të mos kërcënoh tjetrin është kundër natyrës sonë njerëzore. Ne na pëlqen më tepër të shfaqemi si të fuqishëm duke mos i lejuar askujt të na marrë nëpër këmbë. Si është pushteti politik që zotëron kisha në Shtetet e Bashkuara në krahasim me atë të disa vendeve të tjera? Sipas jush cilat do të ishin më të frytshme, rritja shpirtërore dhe angazhimi i tyre apo i yni? A do t'u përgjigjeshit ndryshe (ndoshta më sinqerisht) njerëzve që nuk u druheni? Përpiquni të sillni ndër mend disa nga personat që mund t'ju kenë kërcënuar dhe tregoni se si jeni mbrojtur prej tyre.

4. Fëmija përshkruhet si një krijesë që nuk është në gjendje të mashtrrojë të tjerët. Si e ndieni veten kur gjendeni mes njerëzish që ju fshehin diçka? Çfarë do të ndodhte, sipas mendimit tuaj, në një kishë ku nuk mund të fshihni asgjë?

5. Kur lexoni tek Zanafilla historinë e Adamit dhe të Evës vini re se menjëherë pasi mëkatuan, ata vendosën të fshiheshin. Ndërsa Jezusi, Adami ynë i ri na quan “një qytet mbi kodër, që s'mund të fshihet” dhe “dritë e botës”. Shpjegoni me gojë ose me shkrim se si i kuptoni këto përcaktime që na bën Jezusi.

6. Cilat cilësi të fëmijëve i konsideroni pozitive dhe cilat negative?

7. Kujtoni disa nga urdhrat që ju japin zakonisht të rriturit? A do t'ju tingëllonin njësoj këto urdhra sikur t'i dëgjonit nga goja e një fëmije?

8. Kush përpigjet të kthejë tek ju cilësitë feminare dhe lojcake dhe si arrijnë ta bëjnë këtë?

## I dorës së dytë

1. Ky kapitull sjell para nesh tiparin e gjashtë të natyrës së Jezusit - më i vogli i familjes. Fjala më e goditur që mund ta shpjegonte pozicionin e “më të voglit në familje”, ashtu siç e kuptonte Jezusi, do të ishte “shtegtar”. Shtegtari është një kalimtar, i pastrehë në botë. Lexoni me zë të lartë Hebrenjve 11:8-10 dhe Hebrenjve 11:13-15 dhe përpiloni në fletorën tuaj dy lista; një listë të atyre gjërave që një shtegtar do bënte ose dhe nuk do bënte, dhe një tjetër të atyre gjërave që një njeri me vendbanim të caktuar do bënte ose jo. Tani, shtrohet një pyetje e vështirë: “ Nga pikëpamja shpirtërore, nga cili krah anoj më tepër?”. Diskutojeni këtë me grupin tuaj dhe përpiloni një listë të atyre gjërave nga të cilat do të donit që Perëndia t'ju çlironte.

2. I sati i fëmijëve jeni në familjen tuaj (i pari, i dyti, i treti...), dhe si ka ndikuar kjo tek ju?

3. Nga cilat privilegje do ta kishit më tepër të vështirë të hiqnit dorë?

4. Si ndiheni kur dëgjoni grupe të ndryshme njerëzish që protestojnë për të drejtat e tyre? Po ju vetë a do të protestonit për të mbrojtur të drejtat tuaja? Po për të mbrojtur të drejtat e vëllezërve tuaj të krishterë? A keni dijeni për liritë që gëzojnë të krishterët e vendeve të tjera? Diskutoni për këtë me grupin tuaj.

5. A ju ka ndodhur që gjatë një udhëtimit të ngarkoheni me shumë roba dhe gjatë transportimit të pendoheshit për gjithë atë ngarkesë? Për të jetuar si të krishterë, cilat nga gjërat që zotëroni janë tepër të pakta? Shkruani në fletore të gjitha ato gjëra që e dini se mungonin në Kishën e Hershme, por të cilat ne sot i lidhim me kishën.

## I fundit në radhë

1. Ky kapitull na njeh me tiparin e shtatë të natyrës së Jezusit - i fundit në radhë. Ne s' do na pëlqente aspak të mbeteshim të fundit. Meqenëse pozicioni në fund nuk flet për ndonjë meritë tonën, atëherë si e kuptoni ju këtë? Ç' mënyra për ta përmbushur këtë kërkesë të Jezusit mund të sillni në mendje? Zakonisht në ç' raste përpiqeni të dilni të parët?

2. A ju ka ndodhur t'ua lini radhën të tjerëve e të rrini vetë në fund për t' i ndihmuar ata?

3. Ky kapitull e konsideron konkurrencën brenda Trupit të Krishtit plotësisht të papranueshme. Po ju si mendoni? Në çfarë gare keni marrë pjesë dhe si është përcaktuar fituesi? A mbani mend se sa veta e humbën garën? Po ju vetë a e quani veten të humbur apo fitues? Në qoftë se e quani veten fitues, ç' mendoni për konkurrencën? Po në të kundërtën?

4. Thjesht për t'u argëtuar, përpiquni të ndërtoni një garë në të cilën do të ndeshen cilësitë më të larta si dashuria, besnikëria dhe të shërbyerit.

5. Shkrimtari thekson se konkurrenca mund të bëhet pozitive përmes disa mënyrave të veçanta. Përpiquni të shpikni një lojë që do ta bëjë konkurimin të dobishëm.

6. Geil Erwin ka shkruar një moto kredo për atletët dhe ekipet sportive të krishtera. Analizojeni atë së bashku me grupin tuaj ose me shkrim në fletore. Mendoni se sa do ndryshonin ligat atletike të kishave sikur t' i qëndronin besnik kësaj kredoje.

### Kredoja e atletit

Para çdo anëtarësie tjetër, jam anëtar i trupit të Krishtit pasi jam pasues i Tij.

Në të gjitha aktivitetet do të luftoj për të ndërtuar dhe forcuar Trupin e Krishtit.

Do përpiqem që kohën e lirë ta shfrytëzoj për lindjen e forcimin e shoqërisë së mirë.

Do përpiqem të ndjek parimet e Mbretërisë në të gjitha aktivitetet sportive dhe do t'i vlerësoj të tjerët më tepër se veten.

Do t'i drejtoj aktivitetet e kohës së lirë në mënyrë të tillë që të gjithë vëllezërit të dalin të fituar, pavarësisht nga rezultati.

Do të luaj njëlloj, sikur Jezusi të ishte partneri apo kundërshtari im.

7. Kur bëhet fjalë për të rrezikuar, i pari mund të dalë i fundit. A mund të përmendni ndonjë rast kur për të mirën e të tjerëve keni marrë ju guximin të dilni të parët?

## Ka vend në grazhd

1. Cilësia e tetë e natyrës së Jezusit - më i parëndësishmi është trajtuar në këtë kapitull. Rendja për të siguruar nderime, mirënjohje dhe lavdërime brenda kishës e shtyn shkrimtarin të përdorë terma të tillë ofendues si “pafytyrësi” dhe “paturpësisht të kompromentuar”. Çfarë mendoni për sistemin e stimujve brenda kishës? Çfarë mendoni kur dëgjoni se një pjesëtar i kishës i është dhënë një titull nderi?

2. Shkrimtari e thekson se të tregohesh i parëndësishëm është një zgjedhje e lirë dhe nuk është një pozicion të cilin e meriton dembeli dhe i pa afti. A jeni përpjekur të stimuloni daljen në vend të parë të një njeriu të dashur dhe a mendoni se kjo u ka vlejtur pozitivisht? Mendoni qetësisht, në vetmi, se ç’duhet të bëni për të bekuar e nderuar të tjerët pa rënë në sy?

3. Lexoni me zë të lartë këngën me të cilën Maria i përgjigjet engjëllit që i sjell lajmin e lindjes së Jezusit (Luka 1:46-55). Duke kuptuar botëkuptimin e saj, a mund t’i përfytyroni gjërat që i mësoi ajo Jezusit?

## Lamtumirë taktika të forcës

1. Vëmendja zhvendoset nga Ungjijtë tek letra që Pali u drejton Filipianëve dhe tek kënga madhështore “Urtësia e Krishtit tek kap. 2:5-11. Fillojeni leximin e këtyre pjesëve me zë të lartë. Ky kapitull i shton listës së natyrës së Jezusit edhe tiparin e nëntë dhe të dhjetë - ai nuk përdori forcën mbi të tjerët dhe nuk u udhëhoq nga ambicie të verbra.

2. A keni dashur ndonjëherë që Jezusi të ndërhynte me gjithë forcën e tij për të penguar krimin dhe veprimet e tjera negative? Si e ndieni veten kur ju detyrojnë të veproni në kundërshtim me dëshirat tuaja? Jezusi zgjodhi të mos përdorte forcën kundër askujt. Zakonisht, kur njerëzit ndihen të detyruar për të vepruar në kundërshtim me dëshirat e tyre, ata mundohen ta sabotojnë situatën në të cilën gjenden. Diskutoni për ato raste kur jeni përpjekur të kundërshtoni një situatë të imponuar nga të tjerët.

3. A mund të sillni ndër mend një situatë, ku keni pasur liri të plotë për të marrë një vendim, pa u kushtëzuar nga faktorë të jashtëm? Përshkruajeni atë.

4. A ju ka rënë rasti të shihni dikë të shfrytëzuar rëndë? Si jeni ndier në atë rast? A ju ka shtyrë kjo gjë të ndërhyti?

5. Ungjillizimi paraqitet si një veprimtari shpesh e nxitur nga ambicie të errëta. Shpesh, të interesuar për statistika të bujshme përdorim të gjitha mjetet që zotërojmë, hyjnore apo njerëzore qofshin këto, për “të shpëtuar të humburit”, kjo do të thotë të arrijmë një fund “të suksesshëm” duke përdorur mjete të dyshimta. Përpiquni të përmendni disa mënyra dhe mjete të ndershme që mund t’i përdorim efektivisht për të provuar besimin tonë. Shkruani ose thoni se sa prej tyre mund të përdorni?

6. Çfarë metodash të tjera të dyshimta keni vënë re të përdoren për të arritur atë që mund të quhet një “shërbesë e suksesshme”? A mund të thoni se çfarë i shtyn nganjëherë njerëzit e drejtë të përdorin

mjete të dyshimta? A ju ka ndodhur që dikush t'ju shfrytëzojë edhe pse synon të përmbushë një qëllim të mirë?

7. Satani e vuri në provë Jezusin duke i ofruar atij gjithë botën, që ai të braktiste Perëndinë, por Jezusi nuk u tundua, përkundrazi, qëndroi besnik. Cilat janë objektivat që doni të arrini në jetë? Si po punoni për t'i realizuar ato? A ju ka shkuar ndër mend të përdorni rrugë jo të drejta për realizimin e tyre?

## Mirëdita, Unë jam Reverend...

1. Tipari i njëmbëdhjetë i natyrës së Jezusit është si një shuplakë për ne - ai e zhveshi veten nga fama, u shfaq si të ishte askushi. Përkundrazi, mua më pëlqen të shoqërohem me njerëz të njohur që ma shtojnë rëndësinë. E pranoj, jam një fodull i pashërueshëm. Jezusi e ndiente veten keq kur dikush nuk sillej siç duhet, po kështu kush sillej keq, zihej ngushtë para Jezusit. Jezusi shoqërohej me njerëz të shtresave më të ulëta, pa përjashtuar këtu edhe të burgosurit dhe të demonizuarit. Cilët janë disa nga njerëzit me emër apo me pushtet, me të cilët jeni takuar apo keni pasur lidhje? A e keni ndier veten keq në prani të tyre? Si mund të shmangej ndjenja e ndrojtjes?

2. Cilët janë ata njerëz, në praninë e të cilëve nuk ndieheni plotësisht të qetë për shkak të pozitës apo famës që kanë?

3. Cilët janë ata njerëz në qytetin tuaj që mund t'i konsideroni si "më të parëndësishmit"? A mendoni se ata do të ndiheshin mirë në praninë tuaj? A ju shkon në mendje ndonjë mënyrë që do t'i ndihmonte të ndiheshin më të qetë në praninë tuaj?

4. A dini se ç' mendojnë njerëzit për ju? Ç' përpjekje bëni për t'i shtyrë ata që të mendojnë kështu për ju? Çfarë titulli apo prone zotëroni, që mendoni se mund të nxisë zilinë e të tjerëve?

5. Jezusi, gjithashtu u varfërua që ne të pasuroheshim. Si ndiheni në praninë e njerëzve të pasur? A ndiheni njëlloj siç ndiheshit me

njerëzit e famshëm? Po të jeni të pasur, nga do ta kuptonin njerëzit këtë? Po të jeni të pasur, ç' do të bëni që të varfërit të ndihen mirë në praninë tuaj?

6. Sa kohë kaloni duke u kujdesur për gjërat që zotëroni? A ju ka shkuar ndonjëherë nëpër mend të hiqni dorë nga këto përkujdesje të pavlera? Pse ndiheni kështu ndonjëherë? Si i shpenzoni paratë e tepërta që mund të keni në momente të caktuara?

7. A mendoni se spikatja e pasurisë së një kishe (të marrim një ndërtesë luksoze p.sh) nuk bie ndesh me natyrën e Jezusit?

## Poshtë në Tokë

1. E kemi me të vërtetë të vështirë ta mendojmë Jezusin plotësisht njerëzor. Na duket si fyese ta ulim atë në rangun tonë. Por s'ka dyshim që ai qe njeri dhe kjo përbën edhe tiparin e dymbëdhjetë të natyrës së tij. Cilat janë ato veprime plotësisht njerëzore që s'ua ka marrë kurrë mendja se do t'i bënte Jezusi? A ju ka shkuar ndonjëherë në mendje se atij i duhej t'i lante vetë rrobat e tij?

2. Mendoni disa nga gjërat që ju tundojnë më shumë. A mund ta përfytyroni Jezusin të tunduar nga të njëjtat gjëra?

3. A mendoni se Jezusi ndryshonte shumë nga ju? Ç'ju shtyn të mendoni kështu?

4. Çfarë kuptoni me fjalët “plotësisht njerëzor”?

5. Në këtë kapitull, të titulluar “Të çlirohesh nga çdo barrë” shkrintari flet për faljen. Përse, sipash jush, ai ka shkruar për faljen pikërisht këtu? Ç' do të thotë për ju ta identifikosh veten me të tjerët? A mendoni se njohja e natyrës sonë njerëzore na ndihmon për ta pasur më të lehtë t'i falim të tjerët?

6. Për forcën e të prekurit janë bërë studime interesante e frymëzuese. Përmes Biblës kemi mësuar se Jezusi u end nëpër botë “duke prekur” njerëzit, madje edhe të paprekshmit. Ç’kuptoni me “prekje” dhe si lidhet ky veprim me natyrën njerëzore të Jezusit? Po ta ndieni të nevojshme, përpiloni një listë tjetër duke nxjerë nga Dhiata e Re emrat e gjithë njerëzve që pat prekur Jezusi.

## Bëmë baba të të ngjaj

1. Përmes tiparit të trembëdhjetë mësojmë se Jezusi ishte i bindur. Jezusi na tregon se ai thoshte vetëm ç’thoshte Ati dhe vepronte siç vepronte Ati i tij. Prandaj, lista e tipareve të Jezusit përkruan gjithashtu natyrën e Atit. Jezusi iu bind kësaj natyre. Lexoni me zë të lartë Mateun 16:24,25 dhe diskutoni me gojë ose shkruani në fletore se si i kuptoni këta paragrafë tani që keni para vetes ose në mendje listën e tipareve të natyrës së Jezuit. Si e kuptoni thirrjen e Jezuit “ejani pas meje”?

2. Ç’mendoni se do të ndodhë në jetën tuaj sikur të ndieni se jeni “vajosur” nga Fryma e Shenjtë? Tek Luka 4:18, Vajosja e Frymës, siç thotë vetë Jezusi i dha forcë atij për t’iu bindur Atit. Krahasoni listën e të mirave që sjell vajosja me listën e tipareve të Jezusit.

3. Në njërën faqe të fletores suaj shkruani listën e veprimeve që burojnë nga vajosja. Anash secilit veprim vendosni numrat nga zero tek dhjeta për të shqyrtuar veprimet tuaja kundrejt të tjerëve. Po të doni ta zgjeroni listën tuaj lexoni tek Isaia 61 (shikoni listën e mëposhtme).

### VAJOSJA

Jepuni lajmin e mirë të varfërve 0-10

Shërojeni plagët zemërlënduarve

Shpalluni lirinë të burgosurve

Kthejuni dritën të verbërve

Çlironi të shtypurit

Kthejuni lirinë robërve

Shpallni vitin e mëshirës së Zotit



4. Si do t'ia shpjegoni dikujt vitin e mëshirës së Zotit? Sipas mendimit tuaj, përse Jezusi nuk tha se vajosja e kishte sjellë të shprehte zemërimin e Perëndisë?

## **Bariu i mirë nuk e braktis kopënë**

1. Jezusi e pagoi të shërbyerit me çmimin më të lartë - me jetën e tij. Kjo përbën edhe tiparin e katërbëdhjetë dhe të fundit të natyrës së tij- vdekjen. Nga kjo ide burojnë disa pyetje: Nga ç'motive shtyhem unë në të vërtetë? Për kë jam i gatshëm të jap jetën?

2. Shumë njerëz në të shkuarën kanë sakrifikuar jetën e tyre për të na siguruar disa privilegje që gëzojmë sot. A mund të sillni ndër mend disa nga emrat e atyre njerëzve, vdekja e të cilëve ju ngjall mirënjohje?

3. Cilat ëndrra u janë shuar dhe rizgjuar sërish?

4. Vdekja e Jezusit s'që thjesht një vdekje natyrore, por një akt i vënies së vetes në shërbim të të tjerëve. Shkruani ose bisedoni disa çaste mbi atë subjekt tabu, siç mund ta quajmë - vdekjen tuaj fizike dhe përgatitjen për ta pranuar atë. Njëkohësisht, shkruani ose tregojuni të tjerëve arsyen përse jetoni.

## **Një e papritur e këndshme**

1. Do të ishte e arsyeshme të mendonim se me vdekjen e Jezusit gjithçka mori fund, por kënga e hareshme tek letra e Filipianëve 2:9-11 na entuziazmon. Lexojeni atë me zë të lartë.

2. Me sa duket, suksesi i të shërbyerit mund të arrihet vetëm nëpërmjet Perëndisë. Kërkoni për njëfarë kohe në Shkrimet e Shenjta ato pjesë ku përlësia dhe të shërbyerit shpërblehen.

3. Tek lexojmë këtë fragment na ngjallen ndjenjat e adhurimit. Bëni një tjetër studim të pjesëve mbi adhurimin, ku duket se shpërthen gëzimi dhe hareja. Përqëndrohuni veçanërisht tek Zbulesa, libri i fundit i Dhiatës së Re.

4. Kur jua shpërblen Perëndia, kur punoni nën rrogëz e thurni prapaskena, apo kur shërbeni me gjithë zemër?

## I plotfuqishmi

1. Jezusi dha vetë i pari shembullin e larjes së këmbëve për të na dhënë neve tre mësimë shumë të rëndësishme:

- A. Se si të tregojmë krejt dashurinë tonë
- B. Se si do veprojmë pasi të kemi njohur vetveten
- C. Se si ta përdorim pushtetin që ai të mos na zvetënojë.

Meqenëse larja e këmbëve konsiderohej si puna më e ulët në familje, mësimi i parë shtron para nesh një pyetje të natyrshme: “Kujt do t’ia bëja me dëshirë një shërbim kaq “të ulët”? Po në shtëpinë tuaj, kë konsideroni si punën më të ulët? Kush e bën atë?

Mësimi i dytë na vë para pyetjes: Sikur dikush t’ju pyesë se kush jeni, si do t’i përgjigjesht? Përse keni një konsideratë të tillë për veten tuaj? Sipas jush çfarë mund t’ju poshtërojë? A mendoni se dishepujt kujtuan se Jezusi po poshtërohej duke u larë këmbët atyre? Në qoftë se jo, tregoni arsytet.

Besoj se e keni dëgjuar thënien: Pushteti të prish, madje pushteti absolut të prish plotësisht. Për t’iu përgjigjur mësimit të tretë përmendni ato fusha në të cilat keni pushtet. Mbani parasysh se paratë, ngjyra e lëkurës dhe pasaporta janë simbole të pushtetit. Në ç’mënyra po i përdorni këto mjete të pushtetit në shërbim të “larjes së këmbëve”? Diskutojeni këtë thënie: E vetmja mënyrë për ta përdorur pushtetin pa u prishur vetë dhe pa dëmtuar të tjerët është t’u shërbesh të tjerëve me vetmohim e me gjithë zemër.

2. Ulja në tryezë e pjesëmarrësve në Darkën e Fundit u bë sipas pozitës dhe rëndësisë (gjë kjo, për të cilën apostujt vazhdimisht diskutonin e grindeshin). Çfarë përvoje të “uljes sipas pozitës dhe rëndësisë” keni ju sot dhe a mund të shpjegoni se si ndikon kjo tek ju? A ju jepet ndonjëherë rasti të uleni “në krye të tryezës”? A ju ka rastisur ndonjëherë të pyesni nëse ata që ulen “në krye të tryezës” e meritojnë me të vërtetë këtë vend?

3. Diskutoni ose shkruani në fletore disa nga ambiciet tuaja të kohëve të fundit?

## **E Ëmbla dhe e Hidhura**

1. Si ju është dukur deri tani ky studim mbi Natyrën e Jezus Krishtit? Pyetjet që ju drejtohen janë të lehta apo të vështira?

2. A nuk ju duket se mesazhi na ngazëllen të gjithëve, por është vështirë ta zbatosh në jetë? Në cilat fusha të jetës suaj ndieni vështirësi më të mëdha?

3. A mendoni se një jetesë e tillë është e pamundur? Jepni arsyet për secilën përgjigje.

## **Trupi është një**

1. Shkrimtari ka bindjen e plotë se Trupi i Krishtit jeton vetëm atëherë, kur secila pjesë e tij vihet në shërbim të pjesëve të tjera të trupit. Në cilat fusha të jetës suaj mendoni se mund të funksionojë ose jo ky koncept? Bazohuni në përvojën e jetës suaj.

2. Në këtë kapitull janë përdorur një sërë ilustrimesh humoristike për të treguar se sa qesharake mund të dukeshin disa veprimtari të veçanta të kishave, në qoftë se pjesët e trupit të njeriut do të funksiononin në të njëjtën mënyrë. Përpiquni të sillni ilustrime të tjera në lidhje me të njëjtën çështje.

3. Duke ditur se kanceri është një qelizë që i shërben vetëm vetes dhe zhvillohet në kurriz të trupit, a mund ta përdorni këtë shembull për të kuptuar mirë veprimet në Trupin e Krishtit? A jeni në gjendje tani të dalloni se cilat veprime të sferës të veprimtarisë suaj mund të bëhen kanceroze?

4. Sa kohë kalon trupi juaj për vetëkujdesje? Po trupi i kishës suaj sa kohë shpenzon për t'i shërbyer vetes?

## Të burgosurit e historisë

1. Ky është një nga kapitujt më kontradiktorë të librit, pasi në të shkrimtari deklaroi se, nga vetë natyra e tyre, sektet dhe institucionet e tjera fetare kanë prirje të dhunojnë tiparet e natyrës së Jezusit. Ai e kupton se lëvizjet e reja në fillim organizohen për qëllime bamirëse, por më pas kthehen në shfaqje të vetëpropagandimit dhe vetizolimit. Çfarë mendoni për këtë dilemë të autorit? Sipas mendimit tuaj, ç'rol luajnë sektet sot? Si ka ndikuar sekti juaj për t'ju afruar me disa sekte e për t'ju larguar nga disa të tjerë?

2. A mendoni se sekti juaj vepron i shtyrë nga dashuria? Si keni ndihmuar ju në rritjen e tiparit të të shërbyerit? A ka dhënë rezultate ndihma juaj? Në qoftë se po, sa kohë ka zgjatur kjo?

3. Shkrimtari hedh idenë absurde se të gjitha organizatat e reja pas një veprimtarie 25-50 vjeçare duhet të shpërbëhen dhe t'ua shpërndajnë pasuritë e tyre të varfërve. Meqenëse një gjë e tillë nuk ndodh, ç'mund të bëhet për të ruajtur entuziazmin e fillimit apo për të gjallëruar një lëvizje që pas 25-50 vjetësh aktivitet e ka humbur forcën?

4. A ju ka ndodhur të tregoheni më besnik ndaj një organizate, sesa ndaj Jezusit ose Trupit të Krishtit? Si mund të pajtoni "ndrydhjen në vetvete" me natyrën e Jezusit?

## Lidhja që na bashkon

1. Ju po lexoni një libër asnjans jo të zakonshëm, pavarësisht nga çka zbuloni në kapitullin e fundit. Po të niseni nga pikëpamja e organizatave apo sekteve do ta keni të vështirë të përcaktoni se anën e kujt mban shkrimtari. Këto studime e kanë përqëndruar vëmendjen tonë më tepër te Jezusi dhe te reagimi ynë ndaj natyrës së tij. Kjo është dhe arsyeja që ky studim është përdorur gjerësisht nga grupe të ndryshme. Tani që e keni kaluar këtë provë, në qoftë se dëshironi të keni një përvojë shpirtërore me të vërtetë krijuese, përpiquni të mblidhni tetë deri në dymbëdhjetë njerëz të sekteve dhe filloni studimin edhe një herë nga e para.

2. Bëni listën e të gjitha kishave të bashkësisë suaj dhe lutuni çdo ditë për secilën prej tyre.

3. Një nga paradokset e pakëndshme të kishave të çfarëdo emërtimi është se shumë prej tyre kanë konflikte të brendshme. Me grupin tuaj ose nga sa mbani mend vetë përpiloni një listë tjetër të atyre kishave që vuajnë nga një konflikt i tillë. Me listën e tipareve të natyrës së Jezusit para syve lutuni në veçanti për unitetin dhe shërimin e këtyre bashkësive.

4. Shqyrtoni disa anë të besimit tuaj, me qëllim që të gjeni ato pika takimi me njerëz që më parë nuk shoqëroheshit. A kanë të bëjnë me vetë Jezusin këto pika takimi? Tani, mundohuni të shihni, nëse mungojnë në listën tuaj ato qëndrime që pengojnë shoqërimin tuaj me ata njerëz që mendojnë ndryshe? A ka të bëjë ky “besim i papranueshëm” me Jezusin? Po ta ndieni të nevojshme, diskutojini përgjigjet e këtyre pyetjeve, por në veçanti lutuni për qëndrimin tuaj.

5. Mblidhni disa anëtarë dhe pastorë të bashkësive të ndryshme dhe shprehuni atyre vlerësimin për punën që bëjnë në shërbim të Perëndisë. Tregojuni se po luteni që Perëndia të jetë kudo me ta dhe ta rrisë shërbesën e tyre.

6. Kujtoni disa nga subjektet fetare që kanë nxitur diskutime të zjarra në jetën tuaj. Mos vallë këto diskutime flisnin më tepër për gjëra të tjera, sesa për vetë Jezusin? Herë tjetër, po u gjende në një diskutim të tillë, bëj propozimin: “Le të diskutojmë për Jezusin”. Njihni më pas grupin tuaj me rezultatet e bisedës.

7. Kur ecni përmes bllokut të pallateve, lutuni për secilën familje që banon në të.

## Në shtëpi me trupin

1. Sikur deklarata e Jezusit për ta dashur njëri-tjetrin, e shkruar tek Gjoni 13:34,35 do të merrej më seriozisht, marrëdhëniet me njerëzit do të përbënin gurin themeltar të Krishtëritimit. Në ç’ mënyrë përpigëni t’i ndërtoni marrëdhëniet tuaja? Si veproni kur merrni vesh se një fqinj i juaji, sapo është bërë besimtar i krishterë?

2. Në këtë kapitull shkrimtari shtron çështjen e organizimit në grupe të vogla për studim të Biblës dhe çështjen e shoqërisë midis njerëzve. Çfarë përvoja keni pasur në grupe të vogla?

3. Në këtë kapitull shkrimtari huazon nga metoda e Liman Kolemanit mbi zhvillimin e ndërtimit të marrëdhënieve. Këta hapa të njëpasnjëshëm fillojnë me zbulimin para njëri-tjetrit (duke treguar historinë e jetës), më pas vijojnë me mbështetjen që i japim njëri-tjetrit deri në zotimin tonë për të ndihmuar të tjerët. Kush e di historinë e jetës suaj? Kushtojini pak kohë dikujt që do t’ju tregojë historinë e jetës së tij dhe tregojini atij historinë tuaj. Për këtë do t’ju duhen ca orë, prandaj kushtojini kohë të mjaftueshme. Në qoftë se e nisni punën në një grup të vogël, shpenzoni rreth një orë në çdo takim për të dëgjuar historinë e një anëtarit. Mos harroni që, pasi ta keni dëgjuar historinë, t’i tregoni personit se si keni parë tek ai veprimin e Jezusit.

4. Faza e tretë e marrëdhënieve - zotimi - na lejon të jemi më të hapur dhe t’i rrëfëhemi njeri-tjetrit. Në qoftë se e keni arritur këtë fazë do të shihni se lutja ka më tepër forcë dhe është më e sinqertë.

Shkruani ose thoni emrat e atyre personave që i njohin nevojat tuaja dhe janë duke u lutur për ju. Njëkohësisht, radhisni emrat e personave, për nevojat e të cilëve jeni në dijeni dhe jeni duke u lutur.

5. Eksperimentoni një studim Biblik të zbatueshëm, duke u bazuar tek Mateu 20:1-16. Përgjigjuni me zgjuarsi pyetjeve të radhitura më poshtë individualisht ose në grup: 1. Ç'më zbulon mbi Perëndinë ky kapitull? 2. Çfarë më zbulon mbi vetveten ky kapitull? Ç'urdhëresa duhet të ndjek? Marrëdhëniet tuaja me grupin do të përcaktojnë shkallën e thellësisë që mund të arrini në këtë studim.

6. Kur luteni në vetmi, mësohuni t'ia zbuloni veten Perëndisë, siç tregohet edhe tek Letra e dytë e Korintasve 3:18. Rrëfejani Perëndisë çdo ndjenjë dhe dëshirë tuajën aktuale. Në qoftë se e ndieni se nuk merrni përgjigje për lutjet tuaja, rrëfejani edhe këtë Perëndisë. Tregojini Atij në qoftë se ndiheni të pafuqishëm për të përballuar probleme të caktuara. Mos lini asgjë pa ia zbuluar Atij.

## Ndarja e dhimbjes

1. Të jetosh për të tjerët s'është e lehtë. Kjo mund t'jua shtojë dhimbjen. Ju tani filloni t'i vini re më shumë se më parë shqetësimet dhe plagët e të tjerëve dhe e gjithë kjo ju ndërgjegjëson më tepër për agoninë e përditshme të botës. Në qoftë se ju keni arritur tashmë ta ndieni këtë mundohuni ta shpjegoni para pjesëtarëve të grupit ose në ditarin tuaj.

2. Si kanë ndikuar vuajtjet në jetën tuaj?

3. Në ç'mënyrë e keni ndier se keni vuajtur për Krishtin? Lutuni për ata që tani po vuajnë për të.

4. Në një histori tregohet se ditën e Krishtlindjeve, William Buth digjej nga dëshira për t'u bërë përsëndetjen e inkurajimit të gjitha

kështjellave të Ushtisë së Shpëtimit në mbarë botën. Ata po kalonin një situatë prove, sidomos në fushën financiare. Prandaj, më parë ai vendosi të këshillohej me ndihmësin e tij.

Ndihmësi u kthye pas pak dhe i tha se ai mund të dërgonte një telegram në secilën nga kështjellat, në mbarë botën, por mesazhi i tij duhej të ishte një fjalë e vetme. Gjenerali shkoi të lutej. Qëndroi gjatë duke iu lutur Perëndisë dhe u kthye me fjalën e vetme që duhej të kumtonte: Të tjerët!

Bëni edhe një afishe tjetër për veten tuaj. Në qendër shkruani fjalën “Të Tjerët” dhe vendoseni në një vend të dukshëm, që mund ta shihni vazhdimisht.

## Fjalët ndjekin njëra-tjetrën

1. Lista e tipareve të natyrës së Jezuit është si ajo lentja, përmes së cilës mund t’i hedhim një vështrim gjithë gjërave të jetës duke përfshirë këtu edhe Shkrimet. Provoni një tjetër studim Biblik të zbatueshëm, Mateu 18:21-35 dhe mos harroni të bëni tri pyetje: A. Çfarë më mëson mbi Perëndinë ky pasazh? Çfarë më zbulon për veten time? Çfarë më mëson të bëj? Tani, merrni listën e tipareve të natyrës së Jezusit dhe shikoni nëse ndonjëra nga përgjigjet tuaja nuk u përshtatet atyre. Mos harroni se Fjala e shkruar nuk duhet të dhunojë Fjalën e gjallë. Në qoftë se gjatë leximit të Biblës ndeshni gjëra që ju duket se e dhunojnë figurën e Jezusit mos harroni se Fjala e shkruar nuk e humbet vlerën. Kjo mospërputhje që vihet re na shtyn të studiojmë më shumë, më thellë që të arrijmë të kuptojmë sesi një fragment i veçantë e plotëson natyrën e tij.

2. Studioni një copë herë fragmentet që i referohen Jezusit në Dhiatën e Vjetër. Sipas jush çfarë u tha Jezusi dy nxënësve të vet që ndeshi rrugës për në Emaus tek Luka 24:13-27?

3. Gjени sa herë i referohet Jezusi Dhiatës së Vjetër?

4. Tani që jeni njohur me tiparet e natyrës së Jezusit nënvizoni tiparet që janë dhënë në secilin paragraf të Dhiatës së Re.



## Një stil për të gjitha kohët

1. Tani që kemi arritur tek kapitulli i fundit përshkruani sesi ka ndikuar studimi i këtij libri në ndryshimin e mendimeve dhe të sjelljes suaj.


2. Si ndiheni tani që i shihni gjërat në lidhje me listën e tipareve të Jezusit? A ju duket vetja shumë i fuqishëm?

3. Në ç'aspekte e shikoni rolin e Frymës së Shenjtë në jetën tuaj pas një studimi të tillë intensiv?

4. Çfarë shërbesash keni në plan? Çfarë rrugësh të reja për të sakrifikuar veten keni në mendje?

5. Lexoni me zë të lartë dy faqet e fundit të librit, duke filluar nga paragrafët e Biblës, marrë nga Filipianëve dhe Efesianëve. Ç'shpresa ju ngjallin ata?

6. Lexoni me zë të lartë nga Juda 24 dhe 25 dhe kremtoni “prehjen” që gjeni te Jezusi.



Më vjen ta marr forcën e Tij gjëmuese  
e ta ngjesh brenda trupit të Tij njerëzor,  
që dora jote të mund ta prekë  
dhe po qe se mendja do të mund t'i rezistojë  
[pasi e di që shpirti mundet],  
t'ju bëj të njohur se prekja  
dhe ngrohtësia që ndieni  
vjen nga Perëndia vetë.

Gayle Erwin ka shërbyer për më shumë  
se 40 vjet si pastor, mësues universiteti,  
shkrimtar, redaktor e botues revistash.  
Tani, ai i kushton vullnetarisht kohën e tij  
mësimi për Natyrën e Jezusit dhe  
shkrimi të librave.